



**SRP**  
Albanian Engineering

**PROJEKT - ZBATIM: NDËRTIM I RRJETIT  
TË KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE  
DERI NË HYRJE TË RADHIMËS.**

**REF-90945-03-24-2021**  
**AUTORITETI KONTRAKTOR:**  
**UJËSJELLES KANALIZIME sh.a VLORE**

***SPECIFIKIME TEKNIKE PROJEKT ZBATIM***

BOE "I T M" shpk  
dhe "SRP Albanian Engineering" shpk  
Rruga Mbikalimi i Kamzës,  
Pallati Mëhillaj, Kati 0 Lagja Mëzez,  
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 69 70 521 35  
Email: laboratoritm@hotmail.com



2.2 SPECIFIKIMET PER PUNIMET CIVILE

**Tabela e Përmbajtjes**

<b>1</b>	<b>Informacione të Përgjithshme .....</b>	<b>1</b>
1.1	Të përgjithshme .....	1
1.2	Klima .....	1
<b>2</b>	<b>Punime në Tokë.....</b>	<b>2</b>
2.1	Të përgjithshme .....	2
2.2	Investigimet për Nën-Tokën.....	2
2.3	Pastrimi i Kantierit dhe Puna Përgatitore .....	2
2.3.1	Pastrimi i Kantierit .....	2
2.3.2	Prerja e pemëve.....	2
2.3.3	Përgatitja e Zonës së Punimeve .....	2
2.3.4	Punimet në Tokë me bimësi .....	3
2.4	Gërmimet .....	3
2.4.1	Standartet.....	3
2.4.2	Klasifikimi i Gërmimeve.....	4
2.4.3	E drejta e Rrugës (zonës) .....	5
2.4.4	Vendndodhja dhe Mbrojtja e Shërbimeve Nëntokësore .....	6
2.4.5	Eksplzivët dhe Shpërthimet .....	6
2.4.6	Gërmimet e Përgjithshme dhe ato Parësore .....	7
2.4.7	Përgatitja për Themelet (foundation) .....	7
2.4.8	Largimi i Materialit të Gërryer.....	8
2.4.9	Gërmimi i Tubave për Llogoret .....	8
2.4.10	Mbushja e Fundit të Llogoreve.....	10
2.4.11	Limitet e Gjatësisë së Hapjes së Llogoreve.....	10
2.4.12	Shërbime Ekzistuese .....	11
2.4.13	Gërmimet që duhet të Mbahen të Thata (pa ujë).....	11
2.4.14	Matja e Gërmimeve.....	11
2.4.15	Formimi i Shpateve, Argjinaturave dhe Prerjeve .....	12
2.4.16	Problematikat (punët e bëra keq).....	12
2.4.17	Shkëmb i Fortë.....	12
2.4.18	Vrimat e Provës.....	12
2.5	Rimbushja .....	12
2.5.1	Të Përgjithshme .....	12
2.5.2	Materiali i Rimbushjes.....	12
2.6	Shtrati i Tubacioneve dhe Rimbushja e Llogoreve .....	13
2.6.1	Të Përgjithshme .....	13
2.6.2	Pjesa Fundore e Llogoreve .....	13
2.6.3	Gjeotekstile (filtra pëlhure) .....	13



**“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE  
DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

2.6.4	Materialet e Shtratit .....	14
2.6.5	Procedura e Ndërtimit për Shtratin e Betonit .....	14
2.6.6	Procedura e Ndërtimit - Shtrati i Kokrrizuar dhe Mbulesa .....	15
2.6.7	Ri-mbushja e Llogoreve para Testeve - Foletë e Tubave.....	15
2.6.8	Ri-mbushja e Llogoreve pas Testeve - Foletë e Tubave .....	15
2.6.9	Ri-mbushja e Bashkimeve dhe Pusetave para Testit- Foletë e Tubave.....	16
2.6.10	Ri-mbushja e Llogoreve të Tubave - Tubat e Salduar .....	16
2.6.11	Rimbushja rreth Pusetave.....	17
2.6.12	Material Mbushës i Importuar .....	17
2.6.13	Largimi i Materialeve të Tepërta .....	17
2.7	Restaurimi dhe Pastrimi.....	17
2.7.1	Kërkesat e Përgjithshme .....	17
2.7.2	Restaurimi i Sipërfaqeve përvec Rrugëve Publike dhe Shtigjeve .....	17
2.7.3	Rikthimi në gjendjen e mëparshme të Rrugëve .....	18
2.7.4	Shtigjet - Rivendosja .....	19
2.7.5	Dherat .....	19
2.7.6	Krijimi i Kantierit .....	20
2.8	Testimi i Punimeve në Tokë.....	20
2.8.1	Të Përgjithshme .....	20
2.8.2	Testet Kryesore dhe Standartet .....	20
2.8.3	Testet e Kompaktësisë .....	20
<b>3</b>	<b>Punime Kanalizimesh .....</b>	<b>21</b>
3.1	Qëllimi .....	21
3.2	Materiale dhe Standarde.....	21
3.3	Deklara e Metodës për Punimet e Kanalizimeve.....	21
3.3.1	Kërkesat e Përgjithshme .....	21
3.4	Furnizimi I Materialeve .....	22
3.4.1	Të përgjithshme .....	22
3.4.2	Dorëzimi I Materialeve të Tepërta .....	22
3.5	Inspektimi nga Inxhinieri .....	22
3.6	Tubat dhe Rakorderitë .....	22
3.6.1	Kërkesa të Përgjithshme .....	22
3.6.2	Tuba Polivinil Kloride (PVC) dhe Rakorderi.....	22
3.6.3	Tubat e Betonit.....	23
3.6.4	Tubat e Gizës.....	23
3.6.5	Tuba të Përforcuar me Fibër Qelqi .....	23
3.6.6	Tubat PVC dhe Rakorderitë .....	23
3.6.7	Tubat me Polietilen me Densitet të Lartë (HDPE) dhe Rakorderitë .....	24
3.7	Testimi në vendin e prodhimit.....	25
3.8	Kontrolli i Palës së Tretë .....	25
3.9	Magazinimi dhe Testimi në Kantier.....	26

**“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE  
DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

3.10	Trajtimi i tubacioneve dhe materialeve .....	26
3.10.1	Trajtimi dhe Transporti .....	26
3.10.2	Grumbullimi i Tubave .....	27
3.10.3	Shpërndarja në Kantier .....	27
3.10.4	Inspektimi para Instalimit .....	27
3.10.5	Prerja e Tubave.....	27
3.10.6	Ulja në Llogore .....	27
3.11	Vendosja e Tubave .....	27
3.11.1	Shtrirja e Linjës së Tubave .....	27
3.11.2	Kërkesat për Shtrirjen e Tubave .....	28
3.11.3	Shtrirja e Tubave HDPE dhe të Betonit .....	28
3.11.4	Lidhjet me Tubat Ekzistues .....	28
3.11.5	Fleksibiliteti I Tubave.....	29
3.11.6	Bashkimet dhe Lidhjet e Kullimeve .....	29
3.11.7	Mbërthimi Lidhës I Tubave HDPE dhe Rakorderive .....	29
3.11.8	Veshja me Beton e Tubave.....	29
3.11.9	Rripi i Sigurisë/Paralajmërues.....	29
3.12	Pusetat dhe Pusetat e Kontrollit.....	30
3.12.1	Pusetat .....	30
3.12.2	Kapakët e Pusetave .....	30
3.12.3	Shkallët (Këmbëza hekuri) .....	30
3.12.4	Ndërtimi I Pusetave dhe Pusetave të Kontrollit .....	30
3.12.5	Seksionet e Betonit Para-Fabrikat .....	31
3.12.6	Cimento .....	31
3.12.7	Llaci .....	31
3.12.8	Betoni .....	31
3.12.9	Mjeshtëria.....	31
3.12.10	Lidhjet Familjare .....	32
3.13	Testimi I Kanalizimeve .....	32
3.13.1	Shtrirja e Testimit .....	32
3.13.2	Testime për Fortësinë dhe Bllokimet .....	33
3.13.3	Kontrollet e Infiltrimit.....	33
3.13.4	Testet për Izolimim e Ujit .....	33
3.13.5	Riparimi dhe Përmirësimi I Defekteve.....	33
3.13.6	Testimi I Pusetave.....	33
3.14	Inspektimi CCTV .....	34
3.14.1	Përshkrimi I Përgjithshëm I Punimeve. ....	34
3.14.2	Puna e Siguruar nga Kontraktori.....	34
3.14.3	Inspektimi i Kanalizimeve dhe Pajisjet .....	34
3.14.4	Inspektimi me TV .....	34
3.14.5	Sistemi i Kamerës .....	35

**“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE  
DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

3.14.6	Vëzhgime .....	36
3.14.7	Video .....	36
3.14.8	Fotografitë .....	37
3.14.9	Procedurat Shtesë të Inspektimit .....	38
3.14.10	Dorëzimet dhe Dërgimet dhe Shqyrtimi .....	38
3.14.11	Përgjegjësitë Shtesë të Kontraktorit.....	39
<b>4</b>	<b>Punimet në Rrugë .....</b>	<b>40</b>
4.1	Nënshtresa .....	40
4.2	Shtresa Bazë.....	40
4.3	Shtresa e Sipërfaqes Bituminoze.....	41
4.3.1	Mbulesa bituminoze .....	41
4.3.2	Shtresa e Sipërfaqes Bituminoze.....	42
4.3.3	Mbushësi .....	42
4.3.4	Metodat e Ndërtimit.....	43
4.3.5	Përgatitja e Materialit Agregat.....	43
4.3.6	Përgatitja e Përzjerjes Bituminoze .....	43
4.3.7	Transportimi dhe Dorëzimi i Përzjerjes .....	44
4.3.8	Përhapja dhe Shtrimi.....	44
4.3.9	Përhapja e Imët.....	44
4.3.10	Ngjeshja e Përzjerjes .....	44
<b>5</b>	<b>Punime Betoni .....</b>	<b>45</b>
5.1	Të Përgjithshme .....	45
5.2	Kategoritë e Betonit.....	45
5.3	Materialet për Beton.....	46
5.3.1	Cimento .....	46
5.3.2	Uji për Betonim.....	46
5.3.3	Agregatët për Betonim .....	47
5.3.4	Shtesa dhe Aditivë .....	47
5.4	Përzjerja e betonit .....	48
5.4.1	Kualiteti i Betonit .....	48
5.4.2	Dizenjimi i Përzjerjeve të Betonit .....	48
5.4.3	Betoni Ujë-Mbajtës.....	49
5.4.4	Betoni I Parafabrikat.....	49
5.4.5	Beton me Rezistencë të Lartë ndaj Sulmit Kimik.....	50
5.4.6	Beton në Kontakt me Ujërat e Kanalizimeve .....	50
5.4.7	Grupimi Sipas Peshave .....	50
5.4.8	Përzjera e betonit.....	50
5.5	Transporti i Betonit .....	51
5.6	Vendosja e Betonit.....	51
5.6.1	Të Përgjithshme .....	51
5.6.2	Kompaktimi i Betonit .....	52

**“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE  
DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

5.6.3	Kurimi dhe Mbrojtja .....	52
5.6.4	Vendosja e Instalimeve Metalike .....	53
5.6.5	Pastrimi dhe Vajosja e Formave .....	53
5.6.6	Heqja e Formave.....	53
5.6.7	Kategoritë dhe Format e Betonit të Përfunduar .....	54
5.6.8	Rifillimi I Punës në Nyje .....	54
5.7	Testimi i Betonit.....	55
5.7.1	Të Përgjithshme .....	55
5.7.2	Pajtueshmëria me Kërkesat Specifike .....	55
5.7.3	Mos-Respektimi i Kërkesave Specifike.....	55
5.7.4	Testimi i Betonit të Freskët .....	56
5.7.5	Testimi I Betonit të Ngurtësuar .....	56
5.7.6	Prerja dhe Testimi i Mostrave të Bërthamës.....	57
5.8	Matja dhe Pagesa për Beton .....	57
5.9	Armatura për Beton.....	57
5.10	Tolerancat e Konstruksionit të Betonit .....	58
5.11	Riparimi i Betonit .....	58
5.12	Përfundimi i Sipërfaqes dhe Trajtimi .....	59
5.12.1	Të Përgjithshme .....	59
5.12.2	Sipërfaqja e Armaturës .....	59
5.12.3	Sipërfaqe që Nuk Kërkojnë Armaturë .....	59
5.12.4	Trajtimi me Ngurtësues Kimik .....	60
5.13	Nyje në Beton.....	60
5.13.1	Të Përgjithshme .....	60
5.13.2	Nyjet e Ndërtimit.....	61
5.13.3	Nyjet lëvizëse (Tkurrje-Zgjerim) .....	61
5.14	Izolimi I Nyjeve .....	61
5.14.1	Të Përgjithshme .....	61
5.14.2	Materialet e Nyjeve .....	61
5.14.3	Materiali i Nyjeve Lidhëse Izoluese Sintetike.....	62
5.14.4	Mjeshtëria për Nyjet Lidhëse .....	62
5.14.5	Ndalesat e Ujit (Shufrat e Ujit) .....	62
5.14.6	Punimi për Shufrat e Ujit .....	63
5.15	Llaçi i Çimentos dhe Fino.....	63
5.15.1	Të Përgjithshme .....	63
5.15.2	Forca .....	63
5.15.3	Përzjerja .....	64
5.15.4	Mjeshtëria për Përdorimin e Finos .....	64
5.15.5	Strukturat e Përkohshme dhe Format.....	64
5.15.6	Të Përgjithshme .....	64
5.15.7	Dizenjimi i Strukturave të Përkohshme dhe Formave.....	65

**“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE  
DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

5.15.8	Kërkesë për Ndërtimin e Formave .....	65
5.15.9	Heqja e Strukturave të përkohshme dhe Format .....	65
5.16	Përforcimi .....	66
5.16.1	Çertifikatat e Përforcimit.....	66
5.16.2	Materiali.....	66
5.16.3	Kërkesat e Ndërtimit.....	66
5.16.4	Magazinimi dhe Mbrojtja .....	66
5.16.5	Lakimi.....	66
5.16.6	Ndarja.....	66
5.16.7	Miratimi i Përforcimit.....	67
5.16.8	Mbulesa e Betonit .....	67
<b>6</b>	<b>Strukturat mbajtëse(parandaluese) të Ujit .....</b>	<b>67</b>
6.1	Të përgjithshme .....	67
6.2	Mjeshtëria.....	67
6.2.1	Vendosja e Tubave .....	67
6.2.2	Vendosja e Pajisjeve.....	67
6.2.3	Ngritja e tubave dhe valvulave .....	68
6.2.4	Ventilimi i Detyruar i Depove të Mbuluara .....	68
6.2.5	Ndricimi, Depot dhe Sterat.....	68
6.2.6	Pastrimi i Rezervuarëve, Depove dhe Sterave .....	68
6.2.7	Prova .....	69
6.2.8	Prova e Çatisë.....	69
6.3	Nyjet e Ndërtimit.....	69
6.4	Nyjet lëvizëse .....	70
6.5	Ndalesat e Ujit.....	70
<b>7</b>	<b>Lyerja, Veshja dhe Mbrojtja nga Korrozioni .....</b>	<b>71</b>
7.1	Të Përgjithshme .....	71
7.1.1	Specifikime Dorëzimi.....	72
7.1.2	Kualifikimet për Furnitorët dhe Aplikuesit .....	73
7.1.3	Dërgesat, Magazinimi (Ruajtja) dhe Trajtimi.....	74
7.1.4	Kërkesat e Mjedisit.....	74
7.1.5	Shëndeti dhe Siguria.....	74
7.2	Produktet.....	74
7.2.1	Veshje alifatike izocianate - uretani .....	74
7.2.2	Bojëra Emulsioni .....	74
7.2.3	Praimera të Pasuruar me Zink .....	75
7.3	Ekzekutimi.....	75
7.4	Veshje Epoxy në Sipërfaqet e Betonit .....	75
7.5	Sigurimi i Cilësisë.....	76
7.5.1	Shënime .....	76
7.5.2	Celiku Inox .....	77

**“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE  
DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

7.5.3	Poliester e Trajtuar me të Nxehtë/ Veshje Epoxy Pluhur për Aluminin .....	78
7.5.4	Bojra Emulsioni .....	78
<b>8</b>	<b>Punë me Blloqe, Suvatim dhe Pllakat e Dyshemesë dhe Mureve.....</b>	<b>84</b>
8.1	Blloqe Betoni .....	84
8.2	Blloqet Ranore .....	84
8.3	Puna me Blloqet.....	85
8.3.1	Dimensionet .....	85
8.3.2	Trajtimi i Blloqeve.....	85
8.3.3	Lagia e Blloqeve.....	85
8.3.4	Shtrimi Llacit.....	85
8.3.5	Uniformiteti .....	85
8.3.6	Bashkimi dhe Spërkatja .....	86
8.4	Llaci.....	86
8.4.1	Përzjerësit .....	86
8.4.2	Përzjerja .....	86
8.4.3	Aditivët - Llaçi Stukues.....	87
8.4.4	Pigmente për Ngjyrosje të Llacit .....	87
8.5	Suvatimi .....	87
8.5.1	Përgatitja për Suvatim.....	87
8.5.2	Fiksimi i pllakave të gipsit .....	87
8.5.3	Suvatimi .....	87
8.6	Izolim Kundër Lagështirës (DPC) .....	88
8.7	Pllaka dyshemeje qeramike dhe Pllakëza Muri .....	88
8.7.1	Të përgjithshme .....	88
8.7.2	Materialet .....	88
8.7.3	Mjeshtëria.....	89
8.7.4	Pastrimi dhe Mbrojtja .....	90
<b>9</b>	<b>Instalimet e Furnizimit me Ujë dhe Shkarkimit të Ujërave të Ndotura në Ndërtesa ....</b>	<b>90</b>
9.1	Të përgjithshme .....	90
9.2	Pajisjet Sanitare .....	90
9.3	Rakorderitë e Tubave.....	90
9.4	Pritat .....	90
9.5	Tubat e çatave dhe ulluqet.....	91
<b>10</b>	<b>Xhamat dhe Pllakat .....</b>	<b>91</b>
10.1	Materialet .....	91
10.1.1	Xhamat.....	91
10.1.2	Pllakat .....	91
10.2	Mjeshtëria.....	91
10.2.1	Xhamat.....	91
10.2.2	Pllakat .....	91
10.3	Muratura prej Qelqi (Puna me Qelq).....	92



**“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE  
DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

<b>11</b>	<b>Punimet me Metal.....</b>	<b>92</b>
11.1	Të Përgjithshme .....	92
11.2	Materialet .....	93
11.2.1	Punime Celiku .....	93
11.2.2	Seksionet Standarte.....	93
11.3	Saldimi .....	93
11.4	Galvanizimi.....	94
11.5	Dadot dhe Bullonat.....	94
11.6	Kallëpi i Hekurit .....	94
11.7	Montimi dhe Ndërtimi në Brendi.....	95
11.8	Lyerja .....	95
11.9	Shkallë, Shkallare dhe Parmakë.....	96
11.9.1	Shkallët dhe Shkallaret .....	96
11.9.2	Parmakët dhe Kangjellat .....	97
11.10	Dyert dhe Dritaret.....	98
11.10.1	Materiali.....	98
11.10.2	Dritaret .....	98
11.10.3	Instalimi I Dyerve dhe Dritareve .....	98
11.11	Catia .....	99
11.12	Dysheme me Rrjete të Hapur .....	99
11.13	Mbulimi për Rezervuar .....	99
11.14	Fiksimi dhe instalimi i Metaleve në Beton .....	100
<b>12</b>	<b>Karpenteri dhe bashkuesit.....</b>	<b>100</b>
12.1	Lënda drusore .....	100
12.2	Ruajtja e Lëndës Drusore .....	101
12.3	Karpenteria.....	101
12.4	Bashkimet .....	102
12.5	Dyert dhe Dritaret e Drurit .....	102
12.6	Lyerja e punimeve me dru .....	102
12.7	Testimi I Mbrojtjes së Bashkuesve .....	102
<b>13</b>	<b>Catia .....</b>	<b>103</b>
13.1	Mbulimet dhe lamierat metalike .....	103
13.1.1	Mjeshtëria.....	103
13.1.2	Kontakti i metaleve jo të ngjashëm .....	103
13.2	Veshja e Çatisë me Katrama (Shtresë Bitumi) .....	103
13.2.1	Materialet .....	103
13.2.2	Mjeshtëria.....	104
13.3	Catia me Emulsion Bituminoz .....	105
13.3.1	Materialet .....	105
13.3.2	Mjeshtëria.....	106
13.4	Lamierat e catisë dhe mbulimi. ....	107

**“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE  
DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

13.4.1	Materialet .....	107
13.4.2	Mjeshtëria.....	107
13.5	Fletët e profilizuara me grimca të kompresuara .....	108
13.5.1	Materialet .....	108
13.5.2	Mjeshtëria.....	108
13.6	Sistemi I Mbulimit të Catisë I regjistruar.....	108
13.6.1	Materialet .....	108
13.6.2	Mjeshtëria.....	109

## **Lista e Tabelave**

Tabela 2.1: Gërmimi në Shkëmb–Klasifikimi i Tokës dhe Shkëmbit sipas DIN 18 300, Klauzola 2 .....	4
Tabela 4.1: Diametri dhe Trashësia e Mureve të Tubave uPVC.....	23
Tabela 4.2: Dimensionet e Tubave HDPE sipas DIN 19537-1 .....	25
Table 5.1: Klasifikimi i shtresës bazë .....	41
Tabela 5.2: Gradimi, Agregrati Mineral dhe Asfalti.....	43
Tabela 6.1: Klasifikimi i Betonit.....	45
Tabela 6.2: Kurba e gradimit p.sh. për një madhësi maksimale të kokrrës prej 31.5 mm .....	47
Tabela 6.3: Betoni – Klasat e forcës shtypëse .....	48
Tabela 6.4: Kohët e Heqjes së Formave.....	54
Tabela 6.5: Faktorët e konvertimit për kub 7-ditor në 28-ditë .....	57
Tabela 8.1: Përgatitja dhe Aplikimi i Veshjes për Sipërfaqet e Metalit.....	79
Tabela 8.2: Përgatitja dhe Aplikacioni i Veshjes për Sipërfaqet e Betonit .....	80
Tabela 8.3: Ngjyrat .....	81
Tabela 8.4: Përgatitja e sipërfaqes.....	82
Tabela 8.5: Ekspozimi i Sipërfaqes (Metal dhe Beton) .....	83
Tabela 8.6: Përgatitja dhe Lyerja për Sipërfaqe të Ndryshme përvec Metalit.....	83
Tabela 9.1: Vlerësimi i Rërës për Blloqet .....	85
Tabela 9.2: Përzjerjet e Ilacit .....	86
Tabela 12.1: Instalimi i punimeve metalike dhe betonit .....	100
Tabela 13.1: Vlerat karakteristike për S10/MS10.....	101

## **1 Informacione të Përgjithshme**

### **1.1 Të përgjithshme**

Të gjitha standartet e përmendura këtu do të konsiderohen pjesë e Kontratës. Të gjitha referencat e këtij Standarti do të jenë të versionit të fundit, përveç se kur thuhet ndryshe. Kontraktori duhet të aplikojë të gjithë standartet, ligjet dhe rregulloret teknike etj, të përfshira në këtë dokument tenderi.

Punimet Civile duhet të përmbushin minimalisht standartet ISO, EN or DIN të emëruara si “I.S”, me Kodet e Praktikës respektive dhe Standartet e njohura gjerësisht për furnizimin me ujë, sistemet e ujërave të ndotura dhe impiantet e trajtimit në “shtetet e huaja”, të adoptuara në kushtet lokale, do të përdoren si subjekte alternative por me aprovimin me shkrim nga Inxhinieri.

Kur nuk kemi Standarte të specifikuara në seksionin present apo në ndonjë seksion tjetër të Kontratës, do të aplikohet EN dhe DIN e përmendur më sipër.

Aty ku ka konflikt midis Specifikimeve të Përgjithshme dhe DIN relevante, Specifikimet e Përgjithshme prevalojnë. Në qoftë se nuk është specifikisht e shkruar, urdhërat që vijojnë do të aplikohen në këtë rend përparësie: 1.) EC 2.) DIN 3.) UK 4) Shqiperi

Materialet dhe puna e performuar duhet të jenë minimumi në përputhje me këto Standarte dhe rregullore. Në qoftë se prodhuesi ofron material të Standarteve të tjetëra, Standartet do të duhet të jenë të barabarta ose më të larta se ato të specifikuara, dhe lista e plote me ndryshimet do të duhet ti dorëzohet Inxhinierit nqs kërkohet.

*\* ISO -Organizata Internacionale e Standartizimit; EN – Normat Evropiane; DIN – Standarti Gjerman*

### **1.2 Klima**

Kontraktori konsiderohet të ketë marrë parasysh të gjithë kushtet klimatike kur përgatitet për Tenderin dhe Programin e tij të Punimeve, dhe ai nuk do të marrë pagesa shtesë për sa i përket fenomeneve meteorologjike edhe pse mund ti jepet shtyrje në kohë për shkak të kushteve jo normale klimatike brenda Nën-Klauzolës përkatëse të Kushteve të Kontratës.

Kontraktori duhet të bëjë marrëveshje për të mbrojtur Punimet, punimet e përkohshme, kompleksin e ndërtimit, mjete dhe materialet e ruajtura në vend, kundrejt cdo efekti klimatik. Kontraktori nuk duhet të performojë atëherë kur në opinion e Inxhinierit, cilësia e punës mund të prekej nga kushtet klimatike.

## **2 Punime në Tokë**

### **2.1 Të përgjithshme**

Punimet tokësore nën këtë seksion do të përfshijnë gërmimet për diga dhe rezervuare, mbushjet argjinature, gërmimet e llogoreve dhe mbushje të tokës atje ku tubacionet janë vendosur poshtë tokës dhe gërmimet për strukturat si psh pusetat e valvulave, blloqet e betonit, suportet e tubave, themelet për armaturat e betonit për rezervuaret dhe depozitat e ngritura të ujit si dhe formatimi i kantierit etj. Cdo gjë e cila gjendet në Specifikime për sa i përket zbatimit të gërmimeve, asgjësimit të materialeve të gërmuara, etc. do të zbatohet në mënyrë të barabartë për llojet e ndryshme të tokës përvec rasteve kur thuhet ndryshe.

### **2.2 Investigimet për Nën-Tokën**

Atëherë kur specifikohet apo në raste të vecanta mund të ndodhë, që Inxhinieri urdhëron Kontraktorin të investigojë dhe të marrë mostra të materialeve dhe ujit, në dhe rreth punimeve tokësorë dhe strukturave. Investigimet do të bëhen vetëm nëpërmjet gropave të eksperimentit. Vendi i saktë dhe metoda që do të përdoret për investigimin dhe marrjen e mostrave do të tregohet nga Inxhinieri në cdo rast. Kontraktori do të punësojë staf me eksperiencë për të kryer punën në kantier.

Investigimet duhet të kryhen në përputhje me DIN 4420 dhe tu korespondojnë kodeve dhe Standarteve të tjera të pranuar.

### **2.3 Pastrimi i Kantierit dhe Puna Përgatitore**

#### **2.3.1 Pastrimi i Kantierit**

Kontraktori do të duhet të heqë djerrinat apo bimësitë, pemë të rëna, të presë shkurret dhe ferrat dhe të shkulë rrënjët ashtu si instruktohet nga Inxhinieri. Asnjë material apo pemë nuk do të hiqet në qoftë se nuk është marrë konfirmimi nga Inxhinieri. Të gjitha mbeturinat dhe materialet e papërshtatshme për ripërdorim do të hiqen nga kantieri për tu cuar në një vend tjetër shkarkimi të miratuar, që sigurohet dhe paguhet nga Kontraktori dhe do të rregullohet cdo punim që është dëmtuar.

#### **2.3.2 Prerja e pemëve**

Kur udhëzohet nga Inxhinieri, pemët me trung më të madh se 0.15 m në dimetër do të hiqen bashkë me rrënjët dhe gropat do të mbushen me materiale të aprovuara dhe ngjeshen mirë.

#### **2.3.3 Përgatitja e Zonës së Punimeve**

Kontraktori duhet të përgatisë zonën e punimeve në mënyrë të tillë që puna të vazhdojë pa probleme apo ndërpreje prej kalimtarëve apo trafikut të makinave.

Zona e punës njihet si zona e nevojshme për të kryer të gjithë punën e kërkuar për instalimet.

Gjerësia e zonës së punimeve do të varet nga tipi dhe diametri i tubave që do të tregohen në vizatimet përkatëse. Në qoftë se zona e punimeve nuk është specifikuar në detaj, gjerësia e zonës së punës do të përgatitet sipas kërkesës së inxhinierit.

Kontraktori do të kontrollojë nëse për zonën e punimeve janë në dispozicion lejet e nevojshme për ndërtim.

Para së të fillohet puna, Kontraktori do të vendosë të drejtën e rrugës. Punëdhënësi do të lidhë kontratat e nevojshme me pronarët e tokave për të arritur marrëveshjet e nevojshme për aksesin në zonën e punimeve.

Kontraktori do të kontrollojë me autoritetet lokale në qoftë se zona mund të ketë materiale eksplozive përgjatë linjës së tubacionit. Kontraktori do të jetë përgjegjës për ti gjetur dhe hequr ato. Kontraktori duhet të informojë Inxhinierin në qoftë se gjendet eksploziv.

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

Kontraktori do të kontrollojë në qoftë se kablllo apo tuba kalojnë në zonën e punës. Cdo kalim i paraqitur në vizatim është vetëm tregues dhe nuk jep pozicionin e saktë. Cdo kalim duhet të markohet gjatë gjithë kohës së ndërtimit. Në qoftë se është e nevojshme që të hiqen tubat apo kabllot kalues, Kontraktori dhe do t'i rivenoë sërish apo instalojë dhe po të jetë e nevojshme do të instalohet një lidhje provizore e kabllove dhe tubave gjatë ndërtimit.

Kontraktori do të duhet të kujdeset për pikat eurvejimit. Në qoftë se pikat eurvejimit do të hiqen, kontraktori duhet të rivendosë këto pika në pozicionin fillestar.

Në qoftë se zona e punës kalon në pyll, Kontraktori duhet të heqë nga zonat që do të specifikohet nga Inxhinieri drunjtë e përdorshëm ose jo.

Kontraktori do duhet të heqë dhe magazinojë dheun sipërfaqësor dhe humusin jashtë zonës së punimeve. Për të përfunduar punën, kjo do të mbushet me materialet e tepruara në qoftë se është e nevojshme.

Kontraktori duhet të përgatisë sipërfaqen e zonës së punimeve në mënyrë të tillë që ++të manovrohen pajisjet e përdorura për ndërtim. Nëse toka gjendet në kushte të rënda mund të jetë i nevojshëm stabilizimi I tokës me gjeotekstil dhe/ose zhavorr ose materiale të përshtatshme.

Pasi është kryer me sukses testi I presionit do të bëhet ri-kultivimi I zonës së punimeve.

### **2.3.4 Punimet në Tokë me bimësi**

Kur linjat kalojnë përmes një toke me bimësi, Kontraktori duhet të pastrojë drejtimin e linjës në një rrip prej 3 m nga të dyja anët.

Punimet nën këtë zë përfshijnë pastrimin dhe heqjen e materialeve që pengojnë ose prishen si pemët, rrënjët, ferrat, shkurret, mbeturinat si dhe materiale të tjera organike mbi sipërfaqen e tokës.

Të gjithë pemët dhe trungjet do të hiqen në 30 cm poshtë kuotës së përfunduar të tubacionit, apo të priten në një shirit prej 2 m nga cdo anë e tubacionit. Aty ku tubacionet do të vendosen mbi tokë, Inxhinieri mund të urdhërojë që pemët të cilat mund të mendohet se bien dhe shkaktojnë dëme të tubacioneve, të shkulen.

Kontraktori duhet të bëjë kujdes gjatë heqjes së tyre. Para së të hiqen këto zëra, Kontraktori duhet t'i numërojë dhe ti raportojë me shkrim Inxhinierit.

## **2.4 Gërmimet**

### **2.4.1 Standartet**

Kontraktori duhet të ekzaminojë Kantierin e punës dhe të famjarizohet me natyrën dhe tokën, metodat e gërmimit që duhet të përdoren si dhe pengesat fizike dhe kushtet që mund të ndikojnë në punën e tij por edhe në cmime. Normat e tij duhet të mbulojnë të gjitha punët dhe koston e hasur gjatë kryerjes së Punimeve sipas Kontratës. Pretendime të cilat vijnë si pasojë e mos njohjes së vendit të punës, nuk do të merren parasysh.

Kontraktori nuk do të ekzekutojë asnjë punë në tokë apo gërmim pa patur aprovimin paraprak të Inxhinierit të cilin ai propozon ta punësojë. Ai nuk duhet t'i modifikojë më vonë këto metoda pa patur pranimin e Inxhinierit.

Para fillimit të çdo pune në tokë, gërmime ose prerje asfalti, Kontraktori duhet të regjistrojë gjendjen aktuale të sipërfaqes së kantierit të punës, strukturave dhe ndërtesave ngjitur. Regjistri do të përbëhet nga një përshkrim me shkrim dhe regjistrimet fotografike dhe do t'i dërgohet Inxhinierit 14 ditë para fillimit të punimeve të ndërtimit. Regjistrimet e tilla do të nënshkruhen si regjistrime të vërteta nga Kontraktori dhe Inxhinieri në mënyrë që të shmanget çdo mospërputhje/diferencë në një fazë të mëvonshme d.m.th. gjatë ekzekutimit të punimeve të rivendosjes (kthimit në gjendje të mëparshme).

Kontraktori do të kryejë punimet e përshkruara në këto Specifikime sipas Standarteve EN dhe DIN. Standartet kryesore, por jo të limituara në, janë:

EN 1610                      Ndërtimi dhe testimi I kanalizimeve dhe kullimeve



**“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

DIN 4124	Gërmimet dhe llogoret, shpatet, gjerësitë e hapësirave të punës, dërrasat e përforcimet
DIN 18300	Kodi i përgjithshëm Teknik për punimet tokësore
DIN 18303	Kodi i përgjithshëm Teknik për linjat e gërmimit
DIN 18305	Menaxhimi i ujërave nën-tokësorë

Kontraktori mund të kryejë punimet ose të sigurojë materiale në përputhje me Standardet vendore ose të tjera ndërkombëtare, me kusht që kërkesat e tyre të jenë superiore ose ekuivalente me cilësinë e përshkruar nga Standardet e cituara në Specifikime. I takon Kontraktorit të dëshmojë epërsi/ekuivalencë të Standardeve të tjera.

**2.4.2 Klasifikimi i Gërmimeve**

“Gërmimi”, për qëllim të kësaj Kontrate, do ti referohet gërmimeve të të gjithë materialeve çfarëdo lloj formimi gjeologjik, sasive, vazhdimësie apo përshkrimi ashtu si klasifikohet tek DIN 18300, klauzola 2.

Gërmimet do të kryhen në përputhshmëri absolute të linjave dhe niveleve që janë specifikuar tek Vizatimet, apo sipas udhëzimeve të dhëna nga Inxhinieri.

Gërmimet e tepërta përtej linjave dhe niveleve të përcaktuara do të kufizohen në një minimum absolut duke krijuar hapësirën për punën në përgjithësi dhe për Punimet e Përkohshme të nevojshme.

Kontraktori duhet të ndërmarrë të gjitha masat e mundshme për të parandaluar shkarjet në gërmime apo argjinatura dhe për të mbrojtur strukturat, të cilat mund të rrezikohen.

Cdo gërmim i tepërt, thyerje apo rrëshqitje përtej limiteve të specifikuara në gërmime, do të hiqet dhe do të ngarkohet si shpenzim i Kontraktorit.

Gërmimet do të bëhen me dore në qoftë se ato mekanike nuk konsiderohet të përshtatshme apo praktike, ose mund të dëmtojnë strukturën apo pronën.

Material i gërryer, në qoftë se Inxhinieri mendon që është i ri-përdorshëm për punimet në Kantier, do të grumbullohet, dhe do të kthehet për mbushje; ose në qoftë se do të jetë e mundur të kthehet menjëherë, dhe nëse nuk përshtatet apo nevojitet, do zhvendoset nga Kantieri.

Gërmimet në shkëmb (duhet aplikuar për shkëmbinj të klasifikuar DIN 18300, kategoria 6 dhe 7);

Fjala “shkëmb”, kudo që do të përdoret në lidhje me materialet e gërmimit, do të nënkuptojë vetëm gurë ose copa betoni ose armature që kalojnë 0.5 m<sup>3</sup> në volum, ose copa të ngurta, guri ose muraturë, të cilat, sipas mendimit të Inxhinierit, për tu hequr kërkojnë shpim dhe shpërthim, pykë, ose prishjen me një mjet që punon me energji. Tabela 2.1

**Tabela 2.1: Gërmimi në Shkëmb–Klasifikimi i Tokës dhe Shkëmbit sipas DIN 18 300, Klauzola 2**

Klasa	Identifikimi	Përshkrimi
1	Bonit i Larte (dherat e sipërm)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Boniti i lartë është shtresa e sipërme e formimit të tokës, e cila përmban përveç lëndës inorganike (zhavor, rërë, silt, argjilë e dobët) gjithashtu humus dhe mikroorganizma</li> </ul>
2	Tokë e Lundrueshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tokë e përbërë nga një miks i dheut me ujë</li> </ul>
3	Tokë lehtësisht e shkëputshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tokë e lidhur ose jo si rërë, grimca rëre / përzierje e rërës me peshë deri në 15% të peshës së pastës / argjilës (shkallëzimi granulometrik prej &lt;0,06 mm) dhe me gurë të max. 30% nga pesha nga &gt; 63 mm madhësia e grurit deri në 0,01 m<sup>3</sup> vëllim **)</li> <li>Tokë organike me përmbajtje të ulët uji (torfe e fortë, për shembull turf)</li> </ul>
4	Tokë mesatarisht e vështirë për tu shkëputur	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përzierje e rërës apo zallit të imët, pastës dhe argjilës me më shumë se 15% të peshës së madhësisë së grurit &lt;0,06 mm</li> <li>Llojet e lidhjes së tokës me plasticitet mesatar dhe të rëndë, të cilat janë të buta dhe të forta në varësi të përmbajtjes së ujit me max. 30% nga pesha e gurëve me madhësi &gt; 63 mm deri në 0.01 m<sup>3</sup> vëllim **)</li> </ul>

**“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

Klasa	Identifikimi	Përshkrimi
5	Tokë e vështirë për tu shkëputur	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lloji i tokës sipas kategorisë 3 dhe 4, por me më shumë se 30% ndaj peshës së gurëve me madhësi kokërr &gt; 63 mm deri në vëllim 0.01 m<sup>3</sup> vëllim **)</li> <li>Lloji i tokës lidhëz dhe jo-lidhës me maksimumin 30% ndaj peshës së gurëve &gt; 0.01 m<sup>3</sup> deri 0.1 m<sup>3</sup> volum **)</li> <li>Pllakë e dallueshme plasticiteti e cila mund të jetë e vështirë për tu zbutur në varësi të përmbajtjes së ujit</li> </ul>
6	Shkëmbinj lehtësisht të shkëputshëm apo Dhera të ngjashëm	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lloji i shkëmbinjve me lidhje minerale të brendshme, por të plasaritura shumë dhe në gjendje të brishtë, të thërrmueshëm, të kripur, shkëmbinj të dekompozuar si dhe dhera kompakte të ngjashëm lidhës dhe jo-lidhës</li> <li>Dhera të llojit lidhëz dhe jo-lidhës me jo më shumë se 30% ndaj peshës së gurëve mbi 0.01 m<sup>3</sup> deri 0.1 m<sup>3</sup> volum **)</li> </ul>
7	Shkëmbinj shumë të vështirë për tu shkëputur	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lloji i shkëmbit me mineral te brendshëm lidhës të fortë me një gradë të lartë qëndrueshmërie të strukturës dhe me çarje të vogla apo vetëm dekompozim.</li> <li>Pllakë balte kompakte jo e dekompozuar, shtresa konglomerati, skorje apo deponim të çimentos nga uzinat metalurgjike ose të ngjashme</li> <li>Gurë me masë &gt; 0.1 m<sup>3</sup> volum **)</li> </ul>

**SHËNIM:**

\*) sa më sipër është përkthyer nga Gjermanishtja në Anglisht dhe në rast të ndonjë diskutimi, versioni Gjerman do të prevalojë

\*\*) 0.01 m<sup>3</sup> volum është e njëjtë me një sferë me  $\approx 0.30$  m diametër

0.10 m<sup>3</sup> volum është e njëjtë me një sferë  $\approx 0.60$  m diametër

\*\*\*) Gjitahshtu shiko

DIN 18 196 Klasifikimi i Tokës për Qëllimet e Inxhinierisë Civile

DIN 4022, pjesa e 1 e Klasifikimit dhe Përshkrimit të Tokës dhe Shkëmbit

Shkëmbi i kategorisë 6, kurdo që të përdoret do të nënkuptojë materialin që gërryhet në formë guri, grimca shkëmbore, detritit apo copëza betoni dhe armaturë apo material tjetër që tejkalon 0.30 metër kub në volum, ose material parzmor solid, i cili sipas Inxhinierit për tu zhvendosur, kërkon shpim dhe shpërthim, pykë ose prishjen me një mjet që punon me energji.

Shkëmbi i kategorisë 7, kurdo që do të përdoret do të nënkuptojë materialin që gërryhet në formën e materialeve solidë të themeleve, të cilat në opinion e Inxhinierit, kërkojnë shpim special, shpërthim, prerje, pykë apo thyerje me mjete me fuqi të madhe (rënda).

Asnjë material i butë ose i shpërbërë që mund të hiqet me dorë ose ekskavator me energji elektrike, ose lopatë, asnjë material i hedhur ose i shpërthyer më parë, ose gurë të thyer në mbushjet e materialit ose gjetkë, dhe asnjë material i jashtëm në kufijtë maksimal të matjes të lejuar, që mund të bijnë gjatë gërmimit, nuk do të matet ose lejohet si "material shkëmbor".

Gërmimet e tepërta të shkëmbit: Në qoftë se shkëmbi është gërryer përtej limiteve të caktuara në vizatime, të specifikuara apo të autorizuara me shkrim nga Inxhinieri, gërmimi i tepërt, qoftë edhe i krijuar nga thyerjet apo shkaqe të tjera, do të rimbushet nga dhe me shpenzimet e Kontraktorit.

**2.4.3 E drejta e Rrugës (zonës)**

E Drejta e Rrugës do të jetë zona (t) e caktuara për Kontraktorin që të mundësojë zbatimin e Punimeve sipas Kontratës. Për shkak të kushteve fizike, ligjore ose kushteve të tjera të veçanta, gjerësia e të Drejtës së Rrugës mund të kufizohet (përfshirë qasjen e kufizuar në vendet e punës). Kontraktori

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

konsiderohet se ka përfshirë në Kontratën e Cmimeve të gjitha kostot e menduara për përmbushjen e kufizimeve të tilla.

Në përgjithësi, gjerësia maksimale e punimeve (E Drejta e Rrugës) për çdo seksion punimesh me llogore në tokë bujqësore, kopsht, etj. duhet të jetë jo më shumë se 10 metra. Për hyrjen në kantierin e Punimeve, gjerësia e punës nuk duhet të jetë më shumë se 6 metra. Për vendet e izoluara kompakte, do të lejohet një gjerësi gjithëpërfshirëse prej 12 m përtej madhësive neto të njësive, përveç se kur zona përcaktohet ndryshe nga Inxhinieri.

Nëse Kontraktori kërkon zona jashtë të drejtës së caktuar të rrugës, ai me marrëveshjen paraprake të Inxhinierit mund të negociojë këto në emër të vet dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha kostot e përfshira dhe për rikthimin pas përfundimit të Punimeve të Përhershme.

Para fillimit të Punimeve, Kontraktori me anë të vizatimeve do regjistrojë vendndodhjen dhe dimensionin e kanaleve të ujitjes, strukturave, mureve, gardheve etj., të shtrira brenda një sipërfaqe prej 20 metrash të matur nga linja qendrore e tubave ose nga skaji i jashtëm i strukturave. Këto vizatime së bashku me një përshkrim të shkruar të gjendjes së këtyre strukturave do t'i paraqiten Inxhinierit në dublikatë, 14 ditë para fillimit të punimeve të ndërtimit (gërmimet).

Kontraktori do të jetë përgjegjës për të mbajtur rrjedhën e ujit në kanalet e ujitjes dhe rrjedhën natyrale gjatë gjithë periudhës së ndërtimit. Cmimi i Kontratës përfshin kostot për rivendosjen e kanaleve të ujitjes dhe rrjedhave natyrore të ujit pas përfundimit të punimeve të vendosura jashtë zonave të zëna nga punimet e përhershme.

Para fillimit të ndërtimit, Kontraktori do të zhveshë me kujdes të gjithë sipërfaqen e tokës nga çdo tokë bujqësore, kopsht dhe të ngjashme, në thellësinë e udhëzuar nga Inxhinieri dhe përreth gjithë gjerësisë së punimeve. Sipërfaqja e tokës do depozitohet veçmas nga materiali tjetër i gërmuar për ripërdorim. Pas përfundimit të punimeve dhe para vendosjes së shtresës së sipërme, e gjithë zona e prekur nga aktivitetet e Kontraktorit do të shkrifërohet (pastrohet) në një thellësi prej 450mm dhe do të rindërtohet në nivelin e kërkuar për të marrë shtresën e sipërme.

Të gjitha gardhet, muret, strukturat, ndërtesat, etj. të prekura nga puna e Kontraktorit do të rikthehen sipas udhëzimeve të pronarit dhe Inxhinierit.

Pemët brenda të Drejtës së Rrugës mund të priten vetëm pasi të jetë marrë leja nga pronarët dhe Inxhinieri. Cdo dëmtim i pemëve, qoftë aksidentale ose ndryshe, do t'i raportohet Inxhinierit.

Certifikata e Përfundimit, siç përshkruhet në Kushtet e Kontratës, për çdo seksion të punimeve do të lëshohet vetëm nëse Kontraktori paraqet, së bashku me aplikimin e tij dhe, kur është e zbatueshme, një deklaratë me shkrim nga pronari që konfirmon rivendosjen e tokës, kopshtit, etj. dhe që është kryer sipas kërkesës (pëlqimit) të pronarit.

### **2.4.4 Vendndodhja dhe Mbrojtja e Shërbimeve Nëntokësore**

Kontraktori do të jetë përgjegjës për vendndodhjen dhe mbrojtjen e të gjitha strukturave nëntokësore dhe shërbimeve duke përfshirë kontaktimin/koordinimin me organizatat/Autoritet përgjegjëse. Ai duhet të kryejë me kujdes gjitha gërmimet në mënyrë që vendodhja ekzakte e strukturës nën-tokësore apo shërbimeve, të ditura ose jo, të identifikohen dhe ai do të jetë përgjegjës dhe do të paguajë për rregullimin e tyre, pa kosto shtesë të këtyre strukturave kur u thyen apo u dëmtuan nga puna e pakujdesshme.

Kur zhvendosja, rivendosja apo rikonstruktimi i cdo kablllo, tubi, apo cdo servisi tjetër i nevojshëm për përmbushjen e Kontratës, Kontraktori duhet të njoftojë Inxhinierin me shkrim. Përvec rastit kur është e cituar në FS, cdo punë e bërë e lidhur me zhvendosjen apo rikthimin e tyre apo cdo shërbimi tjetër, do të bëhet nga Kontraktori nën mbikqyrjen e Inxhinierit apo autoritetve të kontraktuara.

### **2.4.5 Eksplozivët dhe Shpërthimet**

Kontraktori do të sigurojë një depo të veçantë për eksplozivët në përputhje me rregulloret ekzistuese. Transporti dhe ruajtja e eksplozivëve dhe shpërthimet gjithashtu duhet të jenë në përputhje me Ligjet që rregullojnë përdorimin e tyre.

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

Kontraktori i lejohet të përdorë eksplozivë vetëm me lejen e Inxhinierit. Pasi të jetë marrë leja në fjalë, të gjitha shpërthimet do të bëhen vetëm nga punëtorë të trajnuar dhe të kualifikuar nën mbikëqyrjen e një punonjësi me përvojë, i cili do të ketë një certifikatë të vlefshme zyrtare dhe të vërtetuar mbi shpërthimet. Kujdesi më i madh do të tregohet gjatë shpërthimeve për të mbrojtur personat, veprat dhe çdo pronë tjetër. Asnjë shpërthim nuk duhet të bëhet brenda 10m nga ndonjë strukturë ekzistuese.

15 cm e fundit e shkëmbit mbi nivelin e themelit do të hiqen me përdorimin e mjeteve me energji elektrike ose me dorë.

Shkalla e gërmimeve në shkëmb do të përfshijë furnizimin, transportimin dhe ruajtjen e eksplozivëve, vrimat e shpimit, dhe materialet e kërkuara për shpërthime, përfshirë edhe çdo punë tjetër të nevojshme.

### **2.4.6 Gërmimet e Përgjithshme dhe ato Parësore**

Cdo gjë që përmbahet në këtë klauzolë në lidhje me ekzekutimin e gërmimeve, largimin e materialit të gërmuar etj do të zbatohet për të gjithë materialin, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

Të gjitha gërmimet do të kryhen në linjat dhe kufijtë e treguar në planin e gërmimit dhe vizatimeve, ose të përcaktuara në Specifikim. Vijat dhe kufijtë e përmendur mund të ndryshohen nga Inxhinieri për t'iu përshtatur tokës dhe kushteve të tjera të hasura gjatë gërmimit aktual dhe inspektimit në terren. Kur gërmohet në ndonjë material tjetër përveç shkëmbit, për nivelet e formimit nën çdo strukturë, 15 cm e fundit të gërmimit do të largohen jo më shumë se 24 orë para vendosjes së themeleve ose mbushjes. Fundet e gërmimeve duhet të rrafshohen dhe shkurtohen në gjerësi të plotë me linjat dhe nivelet e kërkuara dhe duhet të lagen mirë ato themele para vendosjes së betonit.

Kontraktori do të kujdeset dhe të ruajë faqet dhe skajet e të gjitha llogoreve dhe gërmimeve dhe kur është e nevojshme duke përdorur lëndë druri (trungje) të fortë dhe marrë masa për të të parandaluar çdo rënie ose dalje të tokës ose rërës nga ndonjë pjesë jashtë llogores ose gërmimit. Nëse, megjithë masat paraprake, ose për shkak të neglizhencës së tyre, pjesë e anëve ose fundeve të gërmimeve të llogoreve do të jepen ose do të gërmohet pa udhëzime nga Inxhinieri, Kontraktori me shpenzimet e tij do të gërmojë dhe heqë të gjithë tokën e punuar si brenda dhe jashtë kufijve të llogoreve apo të gërmimeve.

Nëse Kontraktori tejkalon në thellësi ose zgjeron gërmimet e formacioneve ose urdhërohet të bëjë gërmime ekstra për arsyet e dhëna më lart, nuk do të paguhet për këto gërmime ekstra, dhe nëse urdhërohet nga Inxhinieri ai do ta ribëjë atë me mbushje të mirë ose me cilësinë e betonit të urdhëruar nga Inxhinieri me shpenzimet e veta.

Nëse gjatë gërmimit zbulohen nëntokë ekzistuese apo kullime fushore, Kontraktori do t'i zëvendësojë ato me kujdes kur të bëhet kthimi ose, nëse kjo është e pamundur, ai do t'i drejtojë ato tek kullat ose kanalet e reja, përndryshe do të rivendosen sipas udhëzimit të Inxhinierit. Para se të fillojnë punimet për tubacionet, ndërtime apo punime-mbushje të tokës, të gjitha materialet e copëtuara dhe të mbetura do të hiqen me dorë dhe gërmimet do të kryhen sipas udhëzimit të Inxhinierit, i cili duhet të drejtojë në mënyrë që të sigurojë që puna të vendoset në një themel absolutisht të fortë dhe të pastër ose të ngjitet fort me tokën e ngurtë. Në asnjë rast tubat, nuk do të vendosen betoni ose mbushja e tokës derisa sipërfaqja mbi të cilën do të vendosen tubat, betoni dhe mbushja e tokës të jetë aprovuar nga Inxhinieri.

### **2.4.7 Përgatitja për Themelet (foundation)**

Kontraktori do të përgatisë zonat e gërmimeve ku do të vendoset betoni ose mbi të cilat do të vendosen tubat, në një mënyrë të përshtatshme për formimin e një themeli. Themelet në tokë mbi të cilat do të vendoset betoni duhet të përfundojnë me saktësi sipas dimensioneve të paraqitura në Vizatime ose të përshkruara nga Inxhinieri, të kenë përmbajtje të duhur lagështie duke u spërkatur siç kërkohet, dhe të kompaktësohen plotësisht me anë të pajisjeve të përshtatshme. Asnjë gurë shkëmbinsh nuk duhet të lihet brenda vijave minimale të gërmimeve të paraqitura në Vizatim.

Themelet e betonit në shtrat do të sigurohen në linjat e përcaktuara, pastrohen plotësisht nga balta dhe mbeturinat, dhe do të lagen (spërkaten) përpara vendosjes së betonit. Të gjitha sipërfaqet e themelit

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

duhet të jenë të lira nga pellgjet me ujë në kohën e vendosjes së betonit. Kudo që ndonjë gjurmim në tokë është bërë nën kuotën përkatëse, pa udhëzimet e Inxhinierit, do të rimbushet siç përcaktohet në Klauzolën 2.5, me shpenzimet e Kontraktorit.

### **2.4.8 Largimi i Materialit të Gërryer**

Materiali i gërmuar i cili nuk është i nevojshëm ose i papërshtatshëm për ripërdorim në Punime do të largohet ashtu siç drejtohet nga Inxhinieri. Kontraktori do të njoftojë Inxhinierin për largimin. Materiali i urdhëruar për tu larguar do të mbetet pronë e punëdhënësit dhe do të depozitohet në vendet e përcaktuara nga Autoritetet përkatëse.

Në varësi të ndonjë kërkesë specifike të Kontratës, largimi i materialit të gërmuar brenda Kantierit do të jetë në zgjedhjen e Kontraktorit, por do të rregullohet në mënyrë që të jetë i pranueshëm për Inxhinierin dhe të përshtatet me kërkesat e përgjithshme për ndërtimin e Punimeve. Kontraktori do të sigurojë që asnjë material i gërmuar i përshtatshëm për të dhe që është i nevojshëm për ripërdorim në Punime nuk është shkarkuar jashtë kantierit.

Shprehja "gërmim" do të konsiderohet se përfshin hedhjen e materialit të gërmuar në ndonjë nga mënyrat e mëposhtme:

- mbushja e gërmimeve dhe strukturave të përfunduara dhe gjurmimet e llogoreve duke përdorur materiale të përshtatshme gjurmimi dhe duke përfshirë vendosjen e grumbullimeve të përkohshme dhe çdo trajtim të dyfishtë të kërkuar (grumbullimi në vendndodhje të veçantë);
- transportimi i materialit të përzgjedhur të gërmuar brenda kantierit ku do të ndërtohen argjinaturat ose ku mbushja e strukturave specifikohet të ndërtohet si argjinaturë, duke përfshirë mjetet gati për përhapje dhe kompaktim;
- largimi i materialit të gërmuar të tepërt jashtë kantierit;
- dherat sipërfaqësore të tokës dhe materiali i gërmuar i përshtatshëm për kullota do të depozitohet përkohësisht në grumbuj brenda Kantierit;
- materiali i papërshtatshëm do të largohet me miratim nga Inxhinieri.

### **2.4.9 Gërmimi i Tubave për Llogoret**

Gërmimet e llogoreve do të kryhen në përputhje me EN 1610, DIN 4124 (Tetor 2002) dhe DIN 18303.

Nëse udhëzohet nga Inxhinieri, për gërmime në rast të tokës me cilësi të dobët ose ngarkesave të rënda pranë llogores, Kontraktori duhet t'i paraqesë për miratim Inxhinierit projektin strukturor, duke përfshirë llogaritjet përkatëse të projektimit të sistemit.

Pjerrësia e mureve anësore të llogores do të rregullohet në kushtet e tokës nëse anët më të thella se 1.25 m nuk mbrohen nga mbulesat në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare.

Atëherë kur është e nevojshme, toka duhet të jetë e veshur dhe e përforcuar (mbërthyer) në mënyrë të duhur. Kur përdoren veshje dhe përforcime, gjerësia neto e llogoreve pas mbulimit nuk duhet të jetë më e vogël se ajo e specifikuar në vizatimet përkatëse. Ndërsa vendoset mbushja dhe nëse mbulimet do të tërhiqen, kjo do të ndodhë në ngritje jo më shumë se 30 cm dhe boshllëku i lënë nga mbulimet e tërhequra do të plotësohet dhe kompaktësohet. Nëse, megjithë masat e tilla paraprake, ose për shkak të neglizhencës së tyre, çdo pjesë e fundeve, anëve ose skajeve do të hiqet ose do të gërmohet pa udhëzime nga Inxhinieri, Kontraktori me shpenzimet e tij do të gërmojë dhe largojë të gjithë dheun dhe do rregullojë, me mbushje kompakte ose me beton ashtu si do të kërkohej nga Inxhinieri.

Nëse është e aplikueshme, gjatë procedurës së instalimit të tubave llogoret duhet të ketë anë vertikale, por aty ku është aprovuar nga Inxhinieri me shkrim, Kontraktori mund të gërmojë llogore që kanë anë vertikale poshtë dhe anët e pjerrëta sipër majës së tubit. Kostoja e anëve të pjerrëta do të përballohet nga Kontraktori. Gërmimet në anët e pjerrëta nuk janë të lejueshme në rrugë apo zona të shtruara.

Para gërmimit do të përcaktohet boshti i rrugës së tubit.

## “NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”

Asnjë tub nuk duhet të vendoset në një llogore derisa pjesa në të cilën do të vendoset tubi të jetë aprovuar nga Inxhinieri. Llogoret e tubit do të gjërmohen në linjat dhe nivelet e paraqitura në vizatime ose siç udhëzohet nga Inxhinieri, por normalisht nuk do të shtrihen me mbulesë më të vogël se 100 cm nga maja e tubit në nivelin e tokës.

Fundi i llogores do të sigurojë një themel të rregullt për tubat.

Gjerësia e llogoreve do të jetë e mjaftueshme për të lejuar që tubat të shtrihen dhe bashkohen ashtu siç duhet, dhe të vendosin dhe kompaktësojnë mbushjet siç përcaktohet. Gjërimitet e llogoreve për tubat dhe ndërlidhjet duhet të jenë llogore me prerje të hapur me gjerësi minimale siç përcaktohet në EN 1610 nëse nuk specifikohet ndryshe në specifikimet ose vizatimet.

Gjerësia minimale absolute e një llogoreje tubi duhet të jetë 50 cm.

Kur tubat janë ngjitur jashtë llogores, gjerësia më e vogël e tij duhet të jetë 60 cm më e madhe se diametri i tubit. Për tubat me gota llogorja duhet të ketë këto dimensione:

DN 200 to DN 700:	DN + 0.6m
DN 700 to DN 1400:	DN + 0.8m
Mbi DN 1400:	DN + 1.1m

Inxhinieri mund të aprovojë përdorimin e një llogoreje më të gjerë në rrethana të veçanta.

Thellësia minimale e gjërimitit është vendosur duke marrë parasysh thellësitë minimale të lejuar të mbulesës.

Binarët anësorë duhet të fiksohen dhe mirëmbahen në çdo ndryshim të gradientit dhe në aq pika të ndërmjetme sa të jetë e nevojshme. Në shina duhet të shënohet linja qendrore dhe niveli në të cilin do të vendoset tubi, këta binarë nuk duhet të jenë më larg se 35m larg. Pajisjet e tjera si dhe instrumentet LASER mund të përdoren. Kjo pajisje duhet të ketë miratimin e inxhinierit.

Të gjitha pajisjet matëse duhet të kontrollohen nga një institut ose prodhues i aprovuar jo më pak se 1 vit para përdorimit në kontratë.

Fundi i llogores duhet të jetë i barabartë dhe lëmuar në mënyrë që të sigurojë mbështetjen e duhur për tubin në të gjithë gjatësinë e tij, dhe të jetë i lirë nga gurë, gunga, rrënjë dhe objekte të tjera të forta që mund të dëmtojnë tubin ose veshjen. Vrimat duhet të gjërmohen në pjesën e poshtme të llogoreve për të vendosur bashkimet, në mënyrë që të sigurojnë kontakt të vazhdueshëm midis fundit të llogores dhe tubit nëpërmjet vrimave të bashkimit.

Kur pjesa e poshtme e llogores ka një natyrë ku sipas mendimit të Inxhinierit të shkaktojë dëme në tub ose veshje, ose të haset një material i papërshtatshëm i cili nuk mund të mbështesë tubin, Kontraktori do të gjërmojë llogoren nën thellësinë e kërkuar dhe më pas do e rimbushë në nivelin e kërkuar me material të përshtatshëm.

Kur tubat do të shtrihen në kthesa me rreze të madhe, llogorja duhet të zgjerohet në mënyrë që të sigurojë që asnjë pjesë e tubit të mos jetë më afër anëve të llogores sesa kërkohet.

Kontraktori do të sigurojë ura mbi llogoret e tubave kur është e nevojshme, ose ku udhëzohet nga Inxhinieri.

Kur është e nevojshme (kalimi i kablove, tubave, etj.) gjërimitet duhet të bëhen me dorë.

Kur materiali i gjërmuar do të përdoret për rimbushje në tokë, Inxhinieri mund të udhëzojë ruajtjen e tij në depozita të veçanta (mund të jetë në një vend të veçantë); Dherat e tokës dhe humusi gjithmonë duhet të ruhen veçmas nga materiali tjetër.

Për bashkimin e lidhjeve të seksioneve të tubave, gjërimi duhet të zgjerohet në mënyrë që të lejojë saldimit, kontrollin e saldimit dhe izolimin e saldimit pa ndonjë rrezik për punëtorët. Distanca minimale nga tubi deri në fund dhe në muret e llogores duhet të jetë 60 cm.

Gurët e mëdhenj në llogore do të hiqen ose shkatërrohen nga Kontraktori.

- spostimi shumë i madh (10% e trashësisë së murit të tubave tolerohet).

## “NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”

Rakorderitë nëse nuk specifikohen ndryshe do të pajisen me një tip bashkuesi të përshtatshëm me sistemin e tubit. Cdo adaptor i nevojshëm për bashkimin e tubave ose rakorderitë ndërmjet tubave, qofshin me material të ndryshëm, do të sigurohen nga Kontraktori pa kosto ekstra. Lidhjet dhe rakorderitë do të dizajnohen për një presion pune nominal prej 6 bar dhe një temperaturë prej 40°C dhe do i përshtaten tubave HDPE në këtë kontratë.

Të gjitha rakorderitë (lidhjet, bërrylat, ti-të, reduktorët) dhe adaptorët do të do të konsiderohen se përfshihen në njësitë e tubave HDPE nëse nuk përcaktohet ndryshe në BoQ. Kostot e bashkimeve me saldim do të konsiderohen sit ë përfshira në njësitë e tubave HDPE.

Diametrat nominalë dhe të jashtëm dhe trashësia e murit të tubave HDPE tregohet në tabelën Tabela 3.2::

**Tabela 3.2: Dimensionet e Tubave HDPE sipas DIN 19537-1**

Diametri Nominal (DN) [mm]	Diametri I Jashtëm [mm] PN 6	Trashësia e Murit [mm] PN10	Diametri I Brendshëm [mm] PN6
100	125,0	7,1	110,8
125	140,0	8,0	124,0
150	180,0	10,2	159,6
200	225,0	12,8	199,4
250	280,0	15,9	248,2
300	355,0	20,1	314,8
400	450,0	25,5	399,0
500	560,0	31,7	496,6

### 3.7 Testimi në vendin e prodhimit

Furnizuesi, në vendin e prodhimit, do të testojë të gjitha tubat, rakorderitë dhe pajisjet e tubacionit të listuara në Preventiv, përfshirë të gjitha materialet bashkuese dhe do i shenjojë. E njëjta gjë vlen për Kontraktorin për pjesën e tij të furnizimeve, siç është e zbatueshme. Kontraktori do të paraqesë një certifikatë nga prodhuesi që vërteton se të gjithë zërat janë testuar në fabrikë dhe se ata kanë kaluar me sukses testet përkatëse të përshkruara nga Specifikimet Standarde përkatëse.

Çdo ose të gjitha materialet dhe artikujt e prodhuar të furnizuar nga Kontraktori, nëse kërkohet nga Inxhinieri, do të testohen paraprakisht me shpenzimet e Kontraktorit në përputhje me testet e specifikuara në standardet përkatëse Gjermane ose të tjera ekuivalente të aprovuara.

Kontraktori do të rregullojë përdorimin e një laboratorit të certifikuar testimi për testimin e kërkuar (kontrolli i palës së tretë). Testimi me mulli i tubave të kanalizimeve duhet të përfshijë një mostër prej 3 tubash për çdo 500 m.

Nëse kryhet një provë me ujë ose me ajër, sipas kërkesave të DIN EN 1610, i lihet gjykimit të Inxhinierit. Një provë e suksesshme me ujë në linjën nën shqyrtim do të konsiderohet si provë e vlefshme, edhe nëse një provë me ajër nuk arrin të sjellë një rezultat pozitiv.

### 3.8 Kontrolli i Palës së Tretë

Kontraktori do të sigurojë me shpenzimet e tij një kontroll të vlefshëm, të pavarur të palës së tretë për të siguruar që tubat, rakorderitë dhe pajisjet e tjera të jenë prodhuar në përputhje me standardet e tyre përkatëse dhe që, përveç detyrave dhe detyrimeve të tjera, do të vërtetojë se i kanë dëshmuar të gjitha

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

testet e mullirit të përshkruara nga standardet relative dhe që materiali i prodhuar përmbush në çdo aspekt kërkesat e Kontratës dhe do të kontrollojnë materialet në lidhje me paketimin e duhur dhe do të vërtetojnë Preventivin e Ngarkimit.

Para nënshkrimit të Kontratës, Kontraktori do të informojë Inxhinierin për emrin e palës së kontrollit që ai synon të angazhojë, dhe të marrë aprovimin e Inxhinierit.

### **3.9 Magazinimi dhe Testimi në Kantier**

Të gjitha materialet e siguruar nga Kontraktori do të ruhen në një zonë të duhur magazinimi, në varësi të aprovimit të Inxhinierit. Kontraktori do të ndërtojë një zonë të rrethuar me gardh dhe me kyç në të cilin do të dorëzohen të gjithë tubat, rakorderitë, valvulat dhe pajisjet e tjera të tubave, dhe gjithashtu të mirëmbajë streha (kapanon) me madhësi dhe kapacitet të mjaftueshëm për të ruajtur materialet dhe për t'i mbrojtur ato nga efektet e motit. Kontraktori do të jetë përgjegjës për pastrimin, nivelimin dhe mbylljen e vendit të magazinimit dhe do të sigurojë të gjithë sigurinë e nevojshme.

Kontraktori, me shpenzimet e tij, do të kryejë të gjitha testet që ai i konsideron të nevojshme për të siguruar që të gjithë tubat, rakorderitë, valvulat dhe pajisjet e tjera janë në përputhje me Kontratën, nën përgjegjësinë e tij. Inxhinieri mund të jetë dëshmitar i testeve të tilla pa marrë përsipër ndonjë përgjegjësi për materialet.

Kontraktori do të lejojë në çdo kohë të arsyeshme hyrjen e lirë të Inxhinierit në çdo vend për inspektim dhe testim. Në të gjitha rastet, Kontraktori do të sigurojë nën pëlqimin e Inxhinierit që i gjithë impianti është dorëzuar në gjendje të mirë dhe të pastër, dhe se shenjat identifikuese janë të qarta dhe se rezervimi është në një mënyrë të aprovuar.

Kontraktori do të mbajë shënime të hollësishme në një formë që do të aprovohet nga Inxhinieri për të gjitha tubat, rakorderitë dhe pajisjet e tjera të tubave, duke treguar sasi të e secilit lloj dhe klasë, të cilat kanë qenë:

- marrë nga Kontraktori gjatë punimeve;
- deklaruar gjatë dorëzimit si me defekt, i dëmtuar ose i mangët,
- të prishura, të dëmtuara ose të humbura gjatë punimeve;
- rezultuar si tepriçë ndaj kërkesave dhe mbahet nga Kontraktuesi.

Regjistrime të tilla do të përditësohen dhe do të dorëzohen Inxhinierit çdo muaj nga Kontraktori.

Kontraktori do të plotësojë sipas instruksioneve të Inxhinierit largimin, riparimin ose zëvendësimin e çdo tubi, rakorderie ose valvule që vërehet me difekt, e dëmtuar ose që mungon.

### **3.10 Trajtimi i tubacioneve dhe materialeve**

#### **3.10.1 Trajtimi dhe Transporti**

Marrëveshjet e Kontraktorit për trajtimin, ngritjen dhe transportimin e tubave, rakorderive, pjesëve të betonit para-fabrikat, mbulesave etj. duhet të sigurojnë që këto sende të sillen në vendin e tyre përfundimtar në kantier, të padëmtuar dhe në gjendje të mirë.

Tubat dhe pjesët e betonit para-fabrikat do të trajtohen me kujdesin më të madh dhe Kontraktori do të sigurojë vinça dhe pajisje të tjera të aprovuara nga Inxhinieri kudo që është e nevojshme për të ngritur ose ulur tuba ose pajisje të tjera të veçanta.

Për trajtimin e tubave do të përdoren rripa kanavacë, rrip gome ose rakorderi speciale të formuara për t'iu përshtatur skajeve të tubave. Grepat nuk duhet të ngrenë tuba dhe as nuk duhet të ulin ose të tërheqin.

Lartësia e ngarkesës për artikujt e ndryshëm do të përcaktohet siç rekomandohet nga prodhuesi dhe aprovohet nga Inxhinieri. Litarët ose rregullimet e tjera të lidhjes duhet të sigurojnë secilën ngarkesë në

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

mënyrë që tubat të mos lëvizin ose të gërvishen dhe duhet të përdoret mbushja e përshtatshme për të siguruar që tubi të mos dëmtohet nga këto bashkime. Specialet e tubave duhet të mbështeten nga thasë me rërë ose mbushje të tjera dhe të shtrihen siç përshkruhet më sipër në mënyrë që ato të mos dëmtohen gjatë transportit.

### **3.10.2 Grumbullimi i Tubave**

Kur tubat do të dorëzohen dhe grumbullohen në vendet e caktuara përgjatë gjurmës së linjës së tubave, zonat ku tubat duhet të grumbullohen, nëse drejtohet nga Inxhinieri, do të gradohen të sheshta nga Kontraktori me shpenzimet e tij për të siguruar një sipërfaqe të qëndrueshme.

### **3.10.3 Shpërndarja në Kantier**

Gjatë shpërndarjes së materialit në vendin e punimeve, secila pjesë do të shkarkohet ngjitur ose afër vendit ku do të shtrihet. Unazat e gomës për nyjet e tubave duhet të ruhen dhe mbrohen në një mënyrë të përshtatshme për të parandaluar prishjen.

Kontraktori do të mbajë tubin dhe pajisjet e pastra gjatë mbarëvajtjes së punës. Papastërtia, mbeturinat ose material tjetër i huaj duhet të hiqen nga pjesa e brendshme e tubit dhe nyjeve përpara instalimit.

### **3.10.4 Inspektimi para Instalimit**

Të gjithë tubat dhe materialet duhet të kontrollohen me kujdes dhe të ekzaminohen për çarje dhe prishje të tjera ndërsa janë pezull mbi llogore menjëherë para instalimit në pozicionin përfundimtar.

Materiali i konstatuar se është i dëmtuar ose me defekt do të refuzohet dhe hiqet nga vendi. Fashaturat dhe foletë e skajeve e të tubave duhet të shqyrtohen me kujdes të veçantë. Tubat e dëmtuar do të lihen mënjanë për inspektim nga Inxhinieri i cili porositi riparime korrigjuese ose refuzon artikujt e dëmtuar. Çdo material, që është me defekt ose dëmtohet, duhet të zëvendësohet me materiale të reja ose të riparuar siç vendoset nga Inxhinieri dhe pa kosto për Punëdhënësin.

### **3.10.5 Prerja e Tubave**

Tubi do të pritët bazuar në matjet e marra në vend dhe do të pritët në mënyrë të rregullt, pa dëmtuar tubin. Prerjet duhet të jenë të lëmuara, të drejta dhe në kënde të drejta me boshtin e tubit. E gjithë prerja e tubave duhet të bëhet me një sharrë hekuri të dhëmbëzuar mirë, ose një sharrë portative me korend me një teh çeliku ose disqe gërryese. Skajet e prera duhet të jenë të pjerrëta duke përdorur një mjet plastik për prerjen pjerrët të tubave, i cili shkurton automatikisht konin e saktë. Metodat për prerjen dhe prerjen e pjerrët të tubit do të jenë të pranueshme për Inxhinierin.

### **3.10.6 Ulja në Llogore**

Tubi do të trajtohet me pajisje të miratuara të dizenuara për të parandaluar dëmtimin e tubit dhe veshjes së jashtme. Kabllot, zinxhirët, grepat ose shufrat metalike të zhveshura nuk do të lejohen të vijnë në kontakt as me veshjen e jashtme dhe as me paretin e brendshëm.

Nëse ndodh dëmtimi i tubacioneve, rakorderive ose aksesorëve të tubave gjatë trajtimit, dëmi do të paraqitet menjëherë për dijeni të Inxhinierit. Inxhinieri përshkruan riparimet korrigjuese ose refuzon artikujt e dëmtuar. Kontraktori do të përballojë shpenzimet e riparimit dhe të zëvendësimit.

## **3.11 Vendosja e Tubave**

### **3.11.1 Shtrirja e Linjës së Tubave**

Inxhinieri do të përcaktojë rrugën e tubit. Inxhinieri rezervon të drejtën për të ndryshuar ose braktisur ndonjë pjesë ose pjesë të gjurmës së tubacioneve të treguar në vizatime dhe Kontraktori do të shtrojë tubat në përputhje me çdo ndryshim që Inxhinieri mund të lëshojë. Vizatimet e Kontratës tregojnë linjat

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

dhe nivelet e përafërta në të cilat do të ndërtohet tubacioni dhe mund t'i nënshtrohen ndryshimeve nga Inxhinieri në vend. Para se të përcaktojë ndonjë pjesë të tubacionit, Kontraktori ose përfaqësuesi i tij do të bëjë një inspektim në vend shoqëruar me Inxhinierin dhe do të marrë prej tij udhëzime në këtë drejtim.

### **3.11.2 Kërkesat për Shtrirjen e Tubave**

Sa më shumë që të jetë e mundur, tubacionet duhet të vendosen në llogoret e gërmuara dhe më pas të rimbushen me mbulesën e përshkruar dhe gjerësinë minimale siç specifikohet në Specifikimin e Punëve të Tokës.

Të gjithë tubat duhet të vendosen në përputhje me rreshtimin, nivelet dhe gradientët siç autorizohen përfundimisht nga Inxhinieri. Tubacioni i përfunduar do të kalojë drejtpërdrejt midis pusëve dhe / ose pusëve kryesore të inspektimit.

Të gjithë tubat do të vendosen nga poshtë lart, duke filluar nga një pusët apo pusët inspektimi, përveç nëse drejtohet ndryshe nga Inxhinieri.

Fundi i llogoreve duhet të gradohet dhe përgatitet për të siguruar një mbajtës të fortë dhe uniform në të gjithë gjatësinë e tubave dhe zgjerimet. Kontraktori do të informojë Inxhinierin paraprakisht kur nivelet e formimit të llogoreve do të jenë gati për inspektim. Asnjë shtrirje e tubave nuk do të lejohet derisa pjesa e poshtme e llogoreve të jetë inspektuar dhe aprovuar nga Inxhinieri.

Tubi do të pozicionohet dhe do të shtrihet në llogore në formën e aprovuar dhe në linjën e duhur. Para se të pozicionohet, secili tub duhet të shqyrtohet plotësisht për të siguruar që nuk ka defekte dhe që janë hequr të gjitha papastërtitë brenda tij. Kontraktori do të vendosë tubin në përputhje me praktikën profesionale dhe do të instalojë të gjitha rakorderitë e pajisjet e veçanta që mund të jenë të nevojshme për kryerjen e duhur të punëve. Kontraktori do të bashkojë tubat në përputhje me specifikimet dhe me pëlqimin e inxhinierit.

### **3.11.3 Shtrirja e Tubave HDPE dhe të Betonit**

Tubat duhet të vendosen me saktësi në vijë dhe nivel dhe të bashkohen në mënyrën e aprovuar. Tubat duhet të vendosen në shtratin e rimbushur, të graduar dhe të përfunduar të llogores dhe duhet të sigurohen vrima speciale të bashkimit. Fashaturat dhe foletë e tubave duhet të vendosen normalisht me fole në skajin më të lartë.

E gjithë zona brenda dhe jashtë që formon bashkimin e tubave dhe rakorderive duhet të pastrohet plotësisht para shtrimit. Do të kryhet çdo masë paraprake për të parandaluar hyrjen e materialeve të huaja në tuba. Gjatë punimeve të shtrirjes asnjë mbetje, mjete, rroba ose material tjetër nuk duhet të vendosen në tub. Tullat ose materiali tjetër i fortë nuk duhet të vendosen nën tuba për mbështetje të përkohshme, përveç kur duhet të sigurohet një shtrat betoni.

Pas vendosjes së një gjatësie të tubit në llogore, skaji I fashaturës do të centrohet në fole (ose atë korresponduese) dhe tubi do të sforcohet dhe do të silltet në vijën dhe gradën e saktë. Tubi duhet të sigurohet në vend me materialin e aprovuar për rimbushje (betoni i preferuar B 5-10 me rërë të hollë) të shtypur nën të, përveç në nyje. Tubat duhet të vendosen në mënyrë të tillë që i gjithë trupi i tubit të jetë në kontakt me shtratin. Duhet të merren masa paraprake për të parandaluar hyrjen e papastërtisë në hapësirën e bashkuesve.

Tubacioni i përfunduar do të vazhdojë drejt midis bërryleve dhe kthesave dhe do të mbahet saktësisht një gradient uniform ndërmjet ndryshimeve të gradientit të treguar në Vizatime ose të autorizuar nga Inxhinieri. Të gjithë tubacionet duhet të inspektohen dhe aprovohen nga Inxhinieri para se të testohen dhe të mbulohen përfundimisht.

### **3.11.4 Lidhjet me Tubat Ekzistues**

Lidhjet midis punës së re dhe tubave ekzistues do të kryhet duke përdorur rakorderi të përshtatshme për kushtet e hasura. Cdo lidhje me tubin ekzistues do të kryhet në kohën dhe nën kushtet të cilat më së paku

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

do të ndërhyjnë në shërbimin ndaj përdoruesve. Do të sigurohen lehtësira për heqjen si duhet të ujit dhe për largimin e të gjithë ujit të hequr nga vijat dhe gërmimet pa dëmtuar pronën ngjitur.

### **3.11.5 Fleksibiliteti I Tubave**

Në qoftë se nuk shënohet ndryshe në Vizatime tubat që dalin ose hynë në puseta, dhe nën ose prej nën strukturave, do të kenë bashkimin e tyre të parë fleksibël në një pozicion jo më të madh se një diametër tubi nga puseta ose linjë vertikale përmes faqes së strukturës mbivendosëse.

### **3.11.6 Bashkimet dhe Lidhjet e Kullimeve**

Të gjitha bashkimet duhet të jenë të zhdrejta dhe vetëm nëse lidhja duhet të vendoset në kohën kur vendoset bashkimi, duhet të pajisen me tapa të përshtatshme të marra nga prodhuesi i tubit.

Asnjë mbështetës nuk do të përdoret përveç se me miratimin paraprak të Inxhinierit i cili do të jepet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Nëse Kontraktuesi harron të vendosë një bashkim siç udhëzohet, atëherë Inxhinieri mund të kërkojë që tubi ose tubat e nevojshëm të nxirren dhe të vendosen me bashkimin e duhur, të gjitha me shpenzimet e Kontraktorit.

### **3.11.7 Mbërthimi Lidhës I Tubave HDPE dhe Rakorderive**

Të gjithë tubat dhe rakorderitë uPVC që kalojnë përmes ose në beton duhet të lidhen me kapje në mënyrë që të arrihet një lidhje e kënaqshme me betonin. Kjo arrihet duke lyer sipërfaqen me çimento tretëse dhe, ndërsa është akoma e lagur, duke e spërkatur me rërë të thatë të trashë ose zhavor. Pasi sipërfaqja të jetë tharë, ajo është gati të lidhet drejtpërdrejt me betonin.

### **3.11.8 Veshja me Beton e Tubave**

Veshja prej betoni e tubave do të sigurohet aty ku tregohet në Vizatime ose siç udhëzohet nga Inxhinieri. Dimensionet e mbështjelljes duhet të jenë siç tregohet në vizatime. Për kalimet e lumenjve tubat do të futen në beton dhe përveç kësaj do të mbrohen nga dyshekët gabion. Aty ku tubat futen në beton, ato do të mbështillen me shtrese PE.

### **3.11.9 Rripi i Sigurisë/Paralajmërues**

Rripat e Sigurisë apo shiritat paralajmërues, me një udhëzues alumini, do të shtrihen mbi gjithë tubacionin e kanalizimeve. Rripi/shiriti do të vendoset 200 mm mbi mbushjen e rërës, dhe shtrihet me linjën qendrore të tubit.

Shiriti do jetë me ngjyrë të kuqe dhe gjerësi 200mm dhe do përmbajë një rrip alumini përgjatë gjatësisë së tij me gjerësi minimumi 50 mm. Fjalët “Kujdes kanalizime poshtë” për tubat e ujërave të ndotur përgjatë seksionit të sipërm të shiritit dhe “Autoriteti I Ujit” përgjatë seksionin të poshtëm të shiritit do të shkruhen në Shqip.

Kontraktori do i dorëzojë Inxhinierit për aprovim një shembull të rripit të Sigurisë/Paralajmërues, me informacionin e prodhuesit dhe specifikimet, para blerjes së rripit të sigurisë.



### **3.12 Pusetat dhe Pusetat e Kontrollit**

#### **3.12.1 Pusetat**

Kur përdoret shprehja Pusetë, ajo do të zbatohet në mënyrë të njëlojtë për ndërtimin e pusetave, pusetave shkarkuese, pusetave të inspektimit dhe të ngjashme. Pusetat do të vendosen siç tregohet në Vizatime ose drejtohen nga Inxhinieri.

Pusetat e betonit në vend dhe pusetat e inspektimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në fuqi për Punimet e Tokës dhe Punimet e Betonit. Pusetat tipike dhe pusetat e inspektimit të vendosura në rrjetin e kanalizimeve duhet të bëhen prej unazave para-fabrikat rrethore të pusetave të ose prej betoni të hedhur në vend sipas madhësisë dhe diametrave treguar në vizatime. Do të zbatohet çimento rezistente ndaj sulfatit. Përveç nëse specifikohet ndryshe, pusetat tipike dhe pusetat e inspektimit të vendosura në rrjetin e kanalizimit duhet të bëhen siç tregohet në vizatime dhe në përputhje me kërkesat e DIN 4034 ose BS 5911.

Të gjitha pusetat dhe pusetat e inspektimit duhet të vendosen në drejtime të ndryshme, qoftë horizontalisht ose vertikalisht, dhe të lidhura me linjat e kanalizimeve. Ato do të ndërtohen me tuba hyrëse dhe dalje të betonuar mjeshtërisht dhe sic duhet, të kompletuar me baza, këmbëza prej hekuri të veshura me polietilen dhe kapakë pusetash siç specifikohet këtu dhe tregohet në Vizatime.

#### **3.12.2 Kapakët e Pusetave**

Kapakët dhe kornizat e gizës do të jenë në përputhje me DIN 4271 ose BS 497 për materialet dhe mjeshtërinë e punës dhe do t'ndërtohen aprovimit të Inxhinierit. Të gjitha pusetat nuk do të jenë të ajrosura vetëm nëse nuk specifikohet ndryshe dhe do të shënohen në sipërfaqe me fjalën “Kanalizime”.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe, të gjithë kapakët duhet të pajisen me mekanizëm bllokues rezistent ndaj korrozionit dhe dispozita për ngritjen. Vrimat e parashikuara në kapakë për ngritjen duhet të jenë me xhepa në formën e duhur dhe nuk do të ketë projeksione mbi nivelin e kapakut.

Kapakët dhe kornizat Rezistente ndaj Peshës Rëndë do të instalohen në të gjitha udhët, rrugët dhe autostradat me gjerësi që tejkalon 3 m. Përveç nëse drejtohet ndryshe, kapakët prej gize duhet të kenë aftësinë mbajtëse të mëposhtme: klasa D të përballojë një ngarkesë prej 400 kN sipas DIN EN 124. Ato duhet të kenë një gjerësi të brendshme  $d = 610$  mm, gjerësi të jashtme  $d_1 = 785$  mm dhe lartësi  $h = 160$  mm.

Kapakët dhe kornizat Rezistente ndaj Peshës së Mesme izoluar me mbulesë të sipërme solide teke prej gize të prodhuar në EN124 Klasa B125 duhet të përdoren në pusetat e inspektimit të instaluar në vendkalime ose zona të tjera për këmbësorë ku ka mundësi të hyrjes së automjeteve.

Kova me baltë në mbulesat e pusetave nuk kërkohen.

#### **3.12.3 Shkallët (Këmbëza hekuri)**

Të gjitha pusetat do të pajisen me këmbëza të veshura me polietilen, sic tregohet në vizatime ose sipas udhëzimit të Inxhinierit. Ato do të merren nga një prodhues i aprovuar, në përputhje me DIN 19555 dhe do të ndërtohen në beton sipas procesimit të punës në hapësirat vertikale dhe horizontale sic detajohet në vizatime. Këmbëzat do të kenë gjerësi 325 mm dhe gjatësi 150 mm, dhe do të vendosen në 300 mm nga qendra në qendër, vertikalisht direkt mbi njëra tjetrën, vetëm në rast se tregohet ndryshe në vizatime. Këmbëzat do të jenë të futura mirë.

#### **3.12.4 Ndërtimi i Pusetave dhe Pusetave të Kontrollit**

Kontraktori do të ndërtojë pusetat në nivelet, dimensionet dhe format e treguara në Vizatime ose siç drejtohet nga Inxhinieri.

Ndërtimi i pusetave duhet të jetë siç tregohet në Vizatimet Standarde dhe përfshin:

## “NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”

---

- shtresë mbulimi e ngjeshur mirë, beton C12 / 15, trashësi 100 mm;
- pjesa e poshtme e pusetave, qoftë e hedhur në vend ose në beton para-fabrikat, sipas gjykimit të Kontraktorit;
- kulmet e kornizave të pusetave (unazave) dhe kapakëve në kuotat siç tregohet në vizatime, përveç nëse drejtohet ndryshe;
- ndërtimi në vend dhe zhytja e skajeve të tubit të kanalizimeve (ndërtim i papërshkueshëm nga uji) dhe skajet e tubit të lidhjeve familjare, këmbëzat prej hekuri (300 mm në qendrat) dhe rakorderitë e shkarkimit (të derdhura në beton C25 / 30);
- Do të përdoret çimento rezistente ndaj sulfatit.
- Baza e pusetave (betoni i thjeshtë C25 / 30, i ngjeshur, i formuar mirë dhe i lëmuar me mistri);
- vendosja e kapakëve të pusetave prej gize, përfshirë kornizat;
- pjesa e brendshme e pusetave dhe pusetave të inspektimit duhet të lyhen me një shtresë epoksi në përputhje me Specifikimet; dhe
- ato pjesë të jashtme të pusetave dhe pusetave të inspektimit që bien në kontakt me tokën ose dherat rimbushës, duhet të lyhen me një shtresë epoksi në përputhje me Specifikimet.

### 3.12.5 Seksionet e Betonit Para-Fabrikat

Aty ku janë ndërtuar pusetat para-fabrikat, të gjitha seksionet e betonit para-fabrikat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e DIN 4034. (Përmasat, specifikimet teknike për shpërndarjen e seksioneve të betonit para-fabrikat)

Të gjitha unazat e pusetës, konët, pllakat e kapakut dhe të pusetës duhet të rirforcohen (të armuar).

Vendi (Sytë) ngritës duhet të sigurohen në pllakat e mbulesës së dhomës dhe në të gjitha konët dhe seksionet e pusetës.

Para ngritjes(ndërtimit), të gjitha unazat e pusetës para-fabrikat, konët, pllakat dhe kapakët duhet të lyhen brenda dhe jashtë me një shtresë epoksi në përputhje me Specifikimet. Pas përfundimit, nyjet në seksionet para-fabrikat duhet të shpëlahen me llaç çimentoje dhe të vishen me të njëjtin material mbrojtës në një distancë minimale prej 150 mm secila anë e bashkimit.

### 3.12.6 Cimento

Çimentoja Portland rezistente ndaj sulfateve të larta do të përdoret për të gjithë betonin dhe llaçin që ka kontakt me dhera që përmbajnë sulfat dhe / ose klorur ose që i nënshtrohen kontaktit me ujërat e ndotura ose gazin e kanalizimeve.

### 3.12.7 Llaçi

Llaçi duhet të jetë llaç çimentoje 600 kg çimento / m<sup>3</sup> rërë siç përshkruhet në Seksionin 6.

### 3.12.8 Betoni

Betoni i armuar për unazat e pusetës para-fabrikat, pllakat e kapakut dhe pusetat e derdhura në vend duhet të jetë i Klasës C30 / 37.

### 3.12.9 Mjeshtëria

Komponentët e nevojshëm të betonit para-fabrikat për ndërtimin e pusetës, kur është e zbatueshme, duhet të sigurohen dhe ndërtohen në diametër, thellësi dhe lloje të paraqitura në Vizatime ose siç thuhet në Preventiv.

## “NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”

I gjithë betoni i klasit C30 / 37 dhe C12 / 15 i përdorur në ndërtimin e pusetave duhet të vibrohet.

Këmbëzat do të ndërtohen në qendra siç tregohet në Vizatime, nëse nuk tregohet hapësirë, ato duhet të vendosen në 300 mm nga qendra në qendër.

Korniza dhe kapaku prej gize duhet të derdhen në pllakën e betonit.

Kur kërkohen vrimat në unazat e pusetës para-fabrikat, këto duhet të formohen në kohën e prodhimit të unazës.

### 3.12.10 Lidhjet Familjare

Fusha e punimeve sipas kësaj kontrate përfshin furnizimin e të gjitha materialeve dhe pajisjeve, së bashku me instalimin e mëposhtme:

- pusetat e inspektimit siç specifikohet
- tubat e lidhjes familjare midis pusetave të inspektimit dhe rrjetit të ujërave të ndotura duke përfshirë të gjitha rakorderitë e kërkuara dhe siç specifikohet

Përgjegjësia për lidhjen përfundimtare nga njësia familjare në pusetën e inspektimit është e punëdhënësit dhe / ose pronarit të shtëpisë dhe nuk do të jetë pjesë e fushës së kontratës.

Lidhjet familjare do të ndërtohen duke përdorur tuba dhe rakorderi HDPE të brinjëzuara të cilat duhet të jenë në përputhje me DIN 8074 dhe DIN 19537 ose standardet ekuivalente të zbatuara në vend. Tubat HDPE duhet të jenë në përputhje me DIN 8074, DIN 8075 ose ISO / 161 në lidhje me DIN 19533 ose ekuivalentin e tij. Tubat duhet të projektohen për një ngurtësi unaze të SN8 dhe një forcë minimale të nevojshme (MRS) prej 10.0 N / mm<sup>2</sup>. Klasa nominale e presionit të punës do të jetë PN 6.

Diametri minimal për lidhjet familjare do të jetë DN 200. Lidhjet e kanalizimeve duhet të vendosen në mënyrë që të jenë sa më të shkurtër të jetë e mundur.

Pusetat e inspektimit do të instalohen në anë të rrugës (preferohet në vendkalim) të kufirit të pronës. Këto do të jenë në pronësi, inspektim dhe mirëmbajtje nga Punëdhënësi. Kjo pusete inspektimi do të jetë prej betoni para-fabrikat sipas seksionit **Error! Reference source not found.**

Në zonat ku instalimi i një pusete inspektimi nuk është i mundur (p.sh. rrugët e ngushta), tubi i lidhjes familjare do të lidhet me pusetën tjetër të kanalizimit kryesor. Sasia dhe pozicioni i pusetave duhet të rregullohet në përputhje me kërkesat e lidhjeve familjare.

Në të gjitha rastet duhet të respektohet pjerrësia maksimale prej 3% për tubin e lidhjes familjare.

### 3.13 Testimi I Kanalizimeve

#### 3.13.1 Shtrirja e Testimit

Testimi I kanalizimeve do të përfshijë (1) testime për fortësinë dhe bllokimet, (2) kontrollet e infiltrimit dhe (3) testimet e izolimit. Kontraktori do të sigurojë, me shpenzimet e tij, të gjitha pajisjet, punën, materialet dhe ujin e nevojshëm për të kryer testimin e përshkruar.

Në kryerjen e kontrollove vizuale, Kontraktori do të sigurojë që nuk do të përdoren dritat e pambrojtura në kanalet dhe pusetat ekzistuese ose në ndonjë kanalizim apo tubacion të ri në të cilat rreziku i plasjes mund të jetë evident gjatë prezencës së gazrave.

Testimet për fortësi dhe bllokimet dhe kontrollet e infiltrimit do të kryhen në 100% të kanalizimeve dhe pusetave. Testimet për izolime do të përfshijnë testimin e:

- 100% e gjatësive totale të tubacioneve përpara mbulimit të tubave;
- Minimumin e 5% të pusetave përpara bërjes së bazave dhe përpara rimbushjes dhe pas instalimit të hekurave ngjitës; dhe
- Maksimumin e 5% të linjave përfshirë lidhjet pasi rimbushja është kompletuar.

### **3.13.2 Testime për Fortësinë dhe Bllokimet**

Testet vizuale për linearitetin dhe lirinë nga pengesat (bllokimet) do të kryhen pas përfundimit të punimeve dhe do të kryhen me anë të llambës dhe pasqyrës. Nivelet e brendshme të kanalizimeve dhe puseta të inspektimit do të testohen dhe verifikohen me instrumente nivelimi.

### **3.13.3 Kontrollat e Infiltrimit**

Kontrollet e infiltrimit do të kryhen kur të përfundohen rimbushjet dhe të gjitha hyrjet përgjatë gjatësisë së kanalizimeve nën testim është izoluar si duhet. Për kanalizimet, nuk duhet të kalojë 500 mm diametër nominal, norma e infiltrimit duhet të jetë poshtë 0.05 l/h për 100 metër linear dhe për mm të vrimës nominale.

Pusetat dhe pusetat e inspektimit do inspektohen vizualisht për izolimin e ujit ndaj infiltrimit pasi rimbushja është përfunduar dhe tabani i ujërave nëntokësorë është në nivelin e tij më të lartë. Në këto kushte nuk do të pranohet infiltrim i dukshëm.

### **3.13.4 Testet për Izolimin e Ujit**

Të gjithat gjatësitë e kanalizimeve do të testohen për izolimin e ujit me mjete të testimit hidrostatik. Testimi hidrostatik do të aplikohet pas rimbushjes pjesore duke lënë bashkueset të ekspozuara. Testimi do të kryhet nga puseta në puseta. Degë të shkurtra anësore të lidhura me kanalizimet mund të testohen si një sistem me kanalizimet. Degët e gjata dhe pusetat do të testohen vecmas.

Testimi hidrostatik do të kryhet në përputhje me DIN EN 1610/DWA 139.

### **3.13.5 Riparimi dhe Përmirësimi i Defekteve**

Riparimi dhe përmirësimi i defekteve të vërejtura gjatë testimit përfshin, sic udhëzohet nga Inxhinieri, korrigjimi i shtrirjeve dhe niveleve dhe fiksimi i duhur i dy tubave.

Furcimi (pastrimi me furce), gërmimi, cementimi ose betonizimi i tubave nuk do të lejohet, as para dhe as pas ekzekutimit të testeve. Të gjitha riparimet e nevojshme, ri-testimi dhe zëvendësimi i urdhëruar nga Inxhinieri do të jetë me shpenzimet e Kontraktorit.

Nëse vijëzimi (lineariteti) i linjës së kanalizimeve midis dy pusetave nuk arrihet, Inxhinieri mund të urdhërojë Kontraktorin të cmontojë dhe rishtrijë tubin ose të rregullojë një puseta shtesë në pikën ku ndodh përkulja, duke siguruar në këtë mënyrë linearitetin midis dy pusetave fqinje.

Nëse humbjet në ndonjë linjë të testuar tejkalojnë rrjedhjet e lejuara me më shumë se 5%, Kontraktori duhet që pas riparimit dhe përmirësimit të cdo rrjedhje, të kryejë teste të mëtejshme për të siguruar prova të normës së rrjedhjes së lejueshme. Nëse, gjatë përsëritjes së testimit norma e humbjes dështon me më shumë se 5% e rrjedhjes e lejuar, linja do të cmontohet dhe rindërtohet me tuba të rinj me shpenzimet e Kontraktorit.

Procedura e mësipërme do të aplikohet edhe për linjat dhe lidhjet familjare, të cilat do të testohen pas rimbushjes, përmes së cilës do të lejohet një tolerancë prej 15% nga norma e lejueshme e rrjedhjes.

### **3.13.6 Testimi i Pusetave**

Pusetat do të mbushen me ujë deri në kon. Tubat e kanalizimeve dhe lidhjet familjare të lidhura me puseta do të izolohen në një pozicion sic udhëzohet nga inxhinieri. Niveli i ujit nuk mund të ndryshojë brenda 2 orësh përveç përthithjes së ujit nga materiali.

### **3.14 Inspektimi CCTV**

#### **3.14.1 Përshkrimi I Përgjithshëm I Punimeve.**

Inspektimi CCTV I punimeve duhet të plotësohet me certifikatë trajnimi të operatorit (-ëve) duke shfrytëzuar kodet dhe observimet e përcaktuara.

#### **3.14.2 Puna e Siguruar nga Kontraktori**

Kontraktori do të sigurojë kontrollin e nevojshëm të trafikut, përfshirë dritat dhe konet e trafikut, të nevojshme apo të kërkuara në përputhje me Manualin e Vëzhgimit, si edhe me planin e nevojshëm të trafikut të qytetit.

Kontraktori do të sigurojë të gjitha lejet e nevojshme nga juridiksionet vendore.

Kanalizimet do të jenë të pastra nga rërat, mbetjet e ngurta, graso dhe cdo lloj mbeturine të pranishme.

Pastrimi do kryhet nga Kontraktori brenda 72 orësh dhe jo më pas se një orë para inspektimit për të reduktuar impaktin e prurjes natyrale brenda linjës së tubacionit gjatë inspektimit.

Kontraktori do të bllokojë të gjitha mbeturinat në fundin e pusëtës, ti largojë dhe tërheqë mënjane ndërsa pastron segmentet e tubave.

#### **3.14.3 Inspektimi i Kanalizimeve dhe Pajisjet**

Personeli përgjegjës për përcaktimin e statusit aktual duhet të ketë njohuri inxhinierike ndërtimore, operacionale dhe materiale mbi kanalizimet, njohuri të specializuara të inspektimit të kanalizimeve dhe të paktën një vit praktikë inspektimi.

Në thelb, mund të regjistrohen dhe vlerësohen në mënyrë cilësore përmes Inspektimit të drejtpërdrejtë (optik) si më poshtë:

- Degët, pjesët lidhëse, hyrjet,
- Pengesat (bllokimet)
- Devijimet pozicionale,
- Veshjet mekanike, korrozioni,
- Korrozioni i brendshëm,
- Deformimet, alterimet,
- Çarje, thyerje,
- Rrjedhjet,
- Infiltrimi.

Për inspektim direkt, inspektimi visual me ecje ose me makinë përgjatë kanalizimit (Kryqëzim -mbikalim > DN 800), ndihmat dhe pajisjet e nevojshme për inspektim dhe dokumentacioni i tij duhet të mbahen shtesë tek pajisjet e përcaktuara mbrojtëse personale.

#### **3.14.4 Inspektimi me TV**

Tek pajisjet bëjnë pjesë:

- sistemi i kamerës (kamera, ndriçimi, pajisjet e transportit dhe kontrollit, si dhe kabullo me rrotulla devijimi dhe mjet matës linear)
- pika e vëzhgimit dhe kontrollit,
- monitor për riprodhim piktorik,
- regjistruar video për regjistrim vizual,
- printer video,
- pajisje elektronike për ndërthurjen e të dhënave,

## “NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”

---

- kompjuter me printer dhe ploter për prodhimin e menjëhershëm të protokollit të inspektimit.
- pajisje për regjistrim vizual dixhital,
- pajisje për arkivimin e të dhënave, p.sh. CD ROM, MOD, DVD,
- regjistruer për video me kodin e kohës,
- CD-ROM, MOD, DVD,
- pajisje shtesë matëse për përcaktimin e kushteve në kanalizim.

Pajisjet duhet të instalohet në një mjet të përshtatshëm.

Sistemi i plotë duhet të korrespondojë me rregulloret në përputhje me VDE (Shoqata e Inxhinierëve Elektrikë Gjermanë) dhe DIN ((Specifikimet Standarde Industriale Gjermane) si dhe me Rregulloret e Parandalimit të Aksidenteve UVV dhe të jetë i aftë të punojë me temperatura të ambientit nga - 15°C deri + 45°C. Në DIN VDE 0100 [13], me përdorimin e sigurisë së tensionit alternativ, si masë sigurie lejohet vetëm tensioni i fiksimit ose shkëputja e siguresës.

### 3.14.5 Sistemi i Kamerës

Sistemi i TV duhet të jetë në përputhje me specifikimet standarde PAL (televizion me ngjyra). Rezolucioni i fotos së kamerës duhet të jetë të paktën 350 752 x 582 me zmadhim dixhital 4x dhe 10x. Rekomandohet një rezolucion më i lartë i figurës. Para hetimit duhet të kontrollohet nga inspektimi i riprodhimit të mbushë ekranin përmes optikës së kamerës (aplikimi në përputhje me DIN 25435, Pjesa 4).

Stabiliteti i ngjyrave të riprodhimit piktorial duhet të verifikohet nëpërmjet ekzaminimit të një modeli të shiritave me ngjyra. Modeli duhet të ndriçohet nga pajisjet e ndriçimit të përdorura për inspektim pa dritë të jashtme (p.sh. drita e ditës).

Përveç pamjes së qartë, duhet të ekzistojë mundësia e inspektimit radial të detajeve të tilla si bashkimet ose lidhjet. Për këto kamera me drejtim shikimi të rregullueshëm në infinit, duhet të përdoren të ashtuquajturat kamera rrotulluese ose me lëvizje horizontale. (> DN 200).

Lentja e kamerës së përdorur duhet të ketë kthjelltësi të mjaftueshme të fokusit ose të ketë fokusim në distancë. Me kamera vëzhgimi aksiale jo rrotulluese, këndi i shikimit duhet të jetë së paku 90 ° (e matur në mënyrë diagonale në ekran).

Pajisjet e ndriçimit duhet të garantojnë një ndriçim të barabartë të fushës së shikimit me të gjitha materialet e tubave dhe nuk mund të shkaktojnë reflektime në lentet e kamerës.

Një mjet elektrik me rrota ose shina me kamerën duhet të përdoret për lëvizjen e kamerës në tub. Ky duhet të jetë i aftë të drejtohet përpara ose prapa dhe, nëse kërkohet, të ndalet. Norma e udhëtimit duhet të jetë e ndryshueshme. Suspensionin e mjetit dhe montimin e kamerës duhet të sigurojnë një pozicion të qëndrueshëm të kamerës në boshtin e tubit gjatë udhëtimit. Në raste individuale, kamera mund të tërhiqet përmes tubit duke përdorur kablllo dhe çikrik ose duke lundruar në platformë.

Kapaciteti i ngarkimit të kabllit, përfshirë lidhjen me prizën e kablllos, duhet të jetë së paku 2,000 N në mënyrë që të mundësojë një rikuperim manual të kamerës.

Pajisja matëse lineare duhet të jetë në gjendje të masë gjatësinë e shtrirjes së drejtuar në një saktësi prej 0.5% (maksimumi 25 cm).

Në lidhje me mbrojtjen nga shpërthimi, sistemi i kamerës duhet të projektohet në përputhje me DIN 57165 / VDE 0165 dhe Standardin Europian DIN EN 50014- 50020. Klasifikimi i zonës që do të shqyrtohet në zonën e kërkuar duhet të kryhet në përputhje me Direktivën për Mbrojtjen nga Shpërthimi (Gjermane) (EX-RL), botimi i fundit. Për angazhimin e pajisjeve elektrike duhet të respektohet Urdhëresa "(Gjermane) mbi Impiantin Elektrik në Hapësira të Rrezikuara nga Eksplozioni (ElexV)" dhe Direktivat e Mbrojtjes nga Shpërthimi (GUV) 19.8). Materialet për mbrojtjen nga shpërthimi duhet të jenë të përshtatshme për klasën e temperaturës T3 dhe për përdorimin në një 1.

Për përdorimin optimal të performancës së kamerës, monitori duhet të ketë të paktën 1.3 herë rezolucionin e kamerës. Diagonali i ekranit duhet të jetë së paku 14" dhe ndarja e vëzhgimit 3 herë më shumë se diagonali i ekranit.

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

Nëse inspektimi me TV regjistrohet duke përdorur një regjistruer video, rezolucioni horizontal i këtij regjistruer video duhet të korrespondojë me kamerën pasi mund të ndodhë humbje e cilësisë së riprodhimit.

Pajisjet elektronike të ndërthurjes së të dhënave duhet të jenë në gjendje të ndërthurin në figurën e monitorit të dhëna të rëndësishme karakteristike si data, koha dhe vendndodhja e ekzaminimit, përcaktimi i objektit, stacionimi, distanca dhe numri i fotografisë, teksti i gjendjes, shigjeta e drejtimit dhe njehsonin e leximit të Video Regjistruerit. Në raste individuale duhet të përcaktohet se cilat ndërthurje janë kryer në të vërtetë. Rekomandohet gjithashtu ndërthurja e teksteve të kushteve, shigjetave të drejtimit dhe leximeve të njehsorit të kamerës video.

### **3.14.6 Vëzhgime**

Të gjitha vëzhgimet dhe defektet do të dokumentohen në një bazë të dhënash dhe do të përfshijnë regjistrimin dixhital të videos dhe fotografitë dixhitale.

Secili videoklip dhe fotografi e dhënë duhet të korrespondojë me të dhënat e inspektimit në bazën e të dhënave, dhe secili grup i të dhënave të inspektimit të renditur në bazën e të dhënave do të lidhet siç duhet me videoklipin dhe fotot e duhura.

Të gjitha vëzhgimet do të zgjidhen nga një tabelë standarde e përshkrimeve të përfshira në softuerin e raportimit të inspektimit, siç kërkohet nga Kontraktori.

Çdo koment shtesë në lidhje me vëzhgimin do të tregohet në kutinë e vërejtjeve.

### **3.14.7 Video**

Kontraktori do të kryejë një regjistrim dixhital me ngjyra në format MPEG 4 për çdo segment tubi të inspektuar.

Skedat e videos do të kenë një rezulucion minimal 752x582 piksel dhe një normë shpejtësie të ndërthurur në një minimum prej 30 Hz.

Raportimi audio do të shmanget për të parandaluar subjektivitetin jokonsistent të operatorit.

Inspektimi me video nuk do të kalojë një shpejtësi përshkimi prej 10 metrash në minutë.

Kontraktori do të ndalojë regjistrimin dixhital në çdo kohë që ka vonesë në inspektim dhe do të rifillojë regjistrimin dixhital video në të njëjtën skedar dixhital. Pauza nuk do të ndikojë në asnjë mënyrë, të ngrijë ose të ndërpresë përsëritjen e videos dhe nuk do të mbyllë skedarin e videos gjatë inspektimit.

Çdo segment tubi (pusetë në pusetë) duhet të identifikohet me një ekran fillestar të tekstit dhe duhet të jetë si më poshtë:

## “NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”

---

<u>Numri I Linjës</u>	<u>Përshkrimi</u>
Linja 1:	Vëzhguar nga
Linja 2:	Qyteti
Linja 3:	Rruga
Linja 4:	Kodi I Vendit*
Linja 6:	Drejtimi I Vëzhgimit
Linja 8:	Materiali I Tubit
Linja 9:	Diametri I Tubit / Lartësia
Linja 10:	Gjatësia e Tubit (në plane)
Linja 11:	Numri I Pusetës Fillestare
Linja 12:	Numri I Pusetës së Fundit
Linja 13:	ID e tubit (identifikimi)
Linja 14:	Ora/Data e Inspektimit

Këto të dhëna duhet të përputhen plotësisht me të dhënat e futura në informacionin e trurit të bazës së të dhënave.

Ekрани fillestar i tekstit do të shfaqet jo më shumë se 15 sekonda në fillim të xhirimeve të videos dhe do të shfaqet përpara këndit 360 gradë të pusetës fillestare.

Gjatë inspektimit të CCTV, videoja tregon tekstin e mëposhtëm në çdo kohë:

<u>Numri I Linjës</u>	<u>Përshkrimi</u>
Linja 1:	Qyteti
Linja 2:	Rruga / Numri I Pusetës Fillestare / Drejtimi I Inspektimit/ Numri I Pusetës së Fundit
Linja 3:	Materiali I Tubit / Masa e Tubit
Linja 4:	Data e Inspektimit /Ora/Puna në Total

Gjatë inspektimit të CCTV, kamera do të ndalet në të gjitha defektet dhe vëzhgimet e rëndësishme për të siguruar një pamje të qartë dhe të përqendruar të gjendjes së tubit dhe do të rrotullojë kokën e kamerës tek defektet për të lejuar vlerësimin adekuat në një kohë të mëvonshme.

Të gjitha defektet dhe vëzhgimet e rëndësishme duhet të përfshijnë një ndërthurje të vëzhgimit të regjistruar në tekst.

Regjistrimi video përfshin tekstin e vëzhgimit në ekran për çdo observim të regjistruar në bazën e të dhënave, përfshirë AMH.

Emërtimi i skedarit video do të përbëhet nga "NGA NUMRI Pusetës së Stacionit", "TEK NUMRI Pusetës së Stacionit", " dhe data tetë shifrore e inspektimit, siç tregohet në shembullin vijues:

0+00\_3+45\_20050101.mp4

(Nga MH Station \_ Tek MH Station \_YYYYMMDD)

Shënim; “Numri I Pusetës së Stacionit” mund të përbëhet nga numrat e stacioneve të studimit siç tregohet në planet e hartimit.

### 3.14.8 Fotografitë



## “NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”

Fotografitë dixhitale në formatin JPEG duhet të bëhen për të gjitha vëzhgimet e regjistruara të defektit. Këto fotografi do të gjenerohen në kompjuter me përdorimin e softuerit të sistemit të raportimit të inspektimit.

Imazhet JPEG do të kapen në një rezolucion minimal prej 40x480 piksel.

Si minimum, të gjitha fotografitë do të emërtohen sipas përshkrimit të mëposhtëm: "NGA NUMRI PUSËTËS SË STACIONIT", "TEK NUMRI PUSËTËS SË STACIONIT", " dhe data tetë shifrore e inspektimit, dhe vendin e defektit të 'stacionit' përgjatë tubit. Është në gjykimin dhe lirinë e Kontraktorit për informacione shtesë të të dhënave që mund të jenë të nevojshme në emërtimin e skedarëve për ta bërë secilin skedar unik brenda kufizimeve të emërtimit të skedarëve të softuerit të tyre të inspektimit.

0+00\_3+45\_20050101\_125\_A.jpg

(Nga MH Station \_ Tek MH Station \_YYYYMMDD \_Pozicioni Difektit \_ Të dhëna unike)

Çdo informacion shtesë do të përfshihet pas informacionit të detyrueshëm të specifikuar më sipër. Pakti i emërtimit do të jetë i qëndrueshëm gjatë gjithë projektit.

Do të merren minimumi dy fotografi të secilit defekt, njëra me një pamje perspektive dhe tjetra me pamje nga afër.

Kërkohej një fotografi për secilën lidhje anësore duke parë drejtpërdrejt lidhjen dhe çdo vëzhgim nga fundi i pusëtës që shikon lart.

### 3.14.9 Procedurat Shtesë të Inspektimit

Mbulesat mbrojtëse do të hiqen përgjatë gjithë segmentit të linjës së kanalizimit nga puseta në pusetë. Përndryshe, segmenti konsiderohet i paplotë.

Kërkohej një kënd I plotë 360 gradë për të gjitha pusetat. Ky lloj regjistrimit do të kryhet në fillimin e inspektimit të vëzhgimit të cdo tubi nga poshtë këndit të pusëtës deri lart tek aksi I pusëtës. Kontraktori do të mbulojë hyrjen e pusëtës për të ndaluar hyrjen e dritës në strukturë dhe për të siguruar një pamje të qartë e të përqëndruar të brendisë së pusëtës. Në rastet kur puseta është puseta mbyllëse, atëherë këndi do të lëvizë në fund të segmentit të tubit të inspektimit.

Regjistrimet e videos do të merren në qendër të tubit me nivelin e ujit që rrjedh horizontalisht. Kamera duhet të drejtohet përgjatë pjesës së poshtme të tubit dhe jo në anën e saj, përveç nëse kalon një pikë pengese. Nëse kërkohet lëvizje e zgjatur në anën e tubit, atëherë ose tubi ka nevojë për një pastrim më të plotë ose duhet të shkruhet një vëzhgim për përshkrimin e natyrës së pengesës.

Pengesat mund të hasen gjatë inspektimit të CCTV që parandalon udhëtimin e kamerës. Në raste kur pengesat nuk janë të kalueshme, Kontraktori do të tërheqë pajisjet dhe do të fillojë një inspektim CCTV nga skaji i kundërt i kanalit të kanalizimit.

Nëse një linjë e veçantë inspektohet më shumë se një herë, atëherë Kontraktori do të përfshijë të gjitha versionet e inspektimeve në bazën e të dhënave. Kontraktori do të japë një shpjegim për inspektimet shtesë në seksionin "Vërejtje".

### 3.14.10 Dorëzimet dhe Dërgimet dhe Shqyrtimi

Dorëzimet

Dorëzimet do të konsistojnë në:

- Një hard disk ose DVD (a) që përmbajnë bazën e të dhënave, video dhe skedarë fotografikë.
- Një raport të shtypur në një kapak të fortë, që përmban informacionin e mëposhtëm:
  - a) Raporti i kalibrimit të xhirimeve për secilën kamera të përdorur.
  - b) Tabela përmbledhëse e të gjitha segmenteve të tubacionit të inspektuara me fushat e mëposhtme sipas listës së renditur:

## “NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”

---

Kolona 1: Data e inspektimit  
Kolona 2: Pusetat Fillestare  
Kolona 3: Pusetat Ndaluese  
Kolona 4: Gjatësia Totale e Tubit (sipas planit të ndërtuar, as-built)  
Kolona 5: Gjatësia në Ekran  
Kolona 6: Numri i Seksionit  
Shënim: Tabela do të renditet sipas Pusetës Fillestare.

- c) Një tabelë vëzhgimi për të gjitha segmentet e tubacionit të inspektuara me fushat e mëposhtme sipas listës së renditur:
- Kolona 1: Numri i Seksionit  
Kolona 2: Pozicioni i Defektit  
Kolona 3: Përshkrimi i Vëzhgimit  
Shënim: Tabela do të renditet sipas Numrit të Seksionit

### Dërgimet

Si pjesë e Dorëzimeve, Kontraktuesi do të dërgojë të gjitha regjistrimet video, skedarët e imazheve dhe bazat e të dhënave në maksimumi 20 DVD ose një hard disk i jashtëm në formë drejtkëndëshe me lidhje USB 2.0, ose të ngjashme. Nëse dorëzohet një hard disk, dorëzimi duhet të përfshijë kordonin e rrymës dhe kabllon e lidhjes USB.

DVD-të ose Hard Disku (disqet) i jashtëm, mbulesa e lidhësit dhe etiketa e shpinës së lidhësit duhet të përfshijnë informacionin e mëposhtëm në etiketat e krijuara nga kompjuteri:

- Emri i Përgjithshëm i Kontraktorit dhe Emri i Nënkontraktuesit
- Emri i Projektit
- Data e fillimit të inspektimit të CCTV
- Data e Përfundimit të Inspektimeve të CCTV

### Shqyrtimi

Regjistrimet video, fotografitë dhe të dhënat do të rishikohen nga klienti për fokusin, ndriçimin, qartësinë e pamjes dhe cilësinë teknike.

Videot ose fotografitë e regjistruara kur një aparat fotografik është përmbytur gjatë procesit të udhëtimit ose shikimit të pjesëve anësore, pengesat, ose defektet nga bllokimi i kabllove, shkarjet ose pajisjet e tjera nuk do të pranohen.

Do të ruhet forma, fokusi, ndriçimi i duhur dhe shikimi i qartë, pa shtrembërime gjatë funksionimit të kamerës. Dështimi i këtyre kushteve do të rezultojë në refuzimin e videos dhe / ose fotografive nga klienti.

Videot ose fotografitë e regjistruara që tregojnë avull, ndriçim joadekuat ose cilësi tjetër të dobët të imazhit do të cojnë në refuzimin nga klienti.

Çdo shtrirje e kanalizimeve ku cilësia e regjistrimit, inspektimi dhe/ose raporti nuk është e pranueshme, në përputhje me këtë Specifikim Teknik për klientin, do të ri-filmohet ose do të modifikohen të dhënat.

### **3.14.11 Përgjegjësitë Shtesë të Kontraktorit**

Në rast të ndonjë tejmbushje (përmbytje) ose ndërprerje / rezervë të shërbimit ndaj klientit që lidhen me Kontraktorin, ai do të njoftojë menjëherë klientin dhe do të përballojë dhe eliminojë tejmbushjen.

Kontraktori do të jetë përgjegjës për çdo gjobë të vendosur nga të tjerët, rimbursimin e çdo agjencie që vuan kostot, dëmtimin, pastrimin, rivendosjen e prurjes, dhe çdo ndërprerje të kostove të shërbimit për

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

klientët si rezultat i punës së Kontraktuesit. Kjo është shtesë për çdo kosto dhe të gjitha kostot e bëra nga klienti.

Kontraktori do të respektojë të drejtat e pronarëve të pronave dhe nuk do të hyjë në pronë private pa marrë leje nga pronari i pronës.

Për pusetat e vendosura në servitutet e pronës private, Kontraktori do t'i sigurojë banorit njoftim të avancuar 24 orësh për aksesin në servitut përpara hyrjes në pronë, përveç nëse banori siguron leje të menjëhershme.

### **4 Punimet në Rrugë**

#### **4.1 Nënshtrësia**

Argjinaturat dhe mbushjet do të ndërtohen vetëm nga materiali i aprovuar nga Inxhinieri dhe të marra nga shkurtimet, guroret ose gropat e huazimit.

Ndërsa materiali është përhapur dhe kompaktësuar, ai do të shtresohet në nivelin dhe trashësinë e specifikuar. Kur nevojitet të shtohet ujë, ai do të aplikohet në mënyrë të barabartë.

Nënshtrësia duhet të mbahet vazhdimisht e thatë dhe çdo dëm i shkaktuar nga akumulimi ose rrjedhja e ujit në sipërfaqe duhet të riparohet.

Nëse uji grumbullohet në cilëndo pjesë të nënshtrësës, veçanërisht në vragat e shkaktuar nga trafiku në ndërtim, Inxhinieri mund të urdhërojë Kontraktorin që të heqë çdo material që ka absorbuar ujë deri në ngopje ose që nuk mund të kompaktohet në dendësinë e kërkuar dhe ta zëvendësojnë atë.

Normat duhet të përfshijnë përdorimin e formave dhe pajisjeve të testimit, transportimin kur kërkohet dhe të gjithë punën dhe materialet në përgatitjen e kubeve, gjithashtu kurimin dhe testimin e tyre.

Kontraktori duhet të ekzaminojë dhe të bëjë analiza mekanike të agregatëve të imët dhe secilës madhësi normale të agregatit të trashë në përdorim, duke përdorur metodën e përshkruar në DIN 4226 të paktën një herë në javë kur betonimi është në proces dhe në intervale më të shpeshta nëse kërkohet prej Inxhinierit.

Gradimi i të gjithë agregatëve duhet të jetë brenda kufijve të specifikuar.

Nëse thërmijet e agregatit të mbetur në ndonjë sitë ndryshojnë nga thërmijet e agregatit në përzierjen e aprovuar për më shumë se 5% të sasisë totale të agregatit të imët dhe të trashë, Inxhinieri mund të udhëzojë Kontraktorin që të ndryshojë pjesën respektive të agregatëve në përzierje për të lejuar diferenca të tilla.

Kontraktori do të sigurojë pajisjet e nevojshme për të përcaktuar faktorin kompaktues të betonit të sapo përzier në secilin vend ku po përgatitet betoni dhe do të përcaktojë faktorin kompaktues të betonit të sapo përzier me metodën e përshkruar në DIN 1048 në secilën vendodhje ku një grup provash kubike është kryer, jo më pak se një herë në ditë ose siç udhëzohet nga Inxhinieri.

Cdo grup i kubeve (gjashtë kube për grup) duhet të përbëhet nga një mostër e vetme e një grumbull betoni e marrë rastësisht. Tre kube duhet të testohen në 7 ditë dhe tre në 28 ditë pas prodhimit. Kur kërkohet nga Inxhinieri, një grup kubesh shtesë do të testohen 3 ditë pas prodhimit. Raportet e provës do t'i dorëzohen Inxhinierit në dublikatë.

#### 5.7.2 Pajtueshmëria me Kërkesat Specifike

Betoni do të konsiderohet i kënaqshëm me kusht që:

- (a) Forca mesatare 28 ditore e përcaktuar nga çdo grup prej katër kubesh prove të njëpasnjëshëm tejkalon forcën karakteristike me jo më pak se 5 N/mm<sup>2</sup> për beton të shkallës C 15 dhe 7,5 N/mm<sup>2</sup> për ato me shkallë më të lartë se C 15;
- (b) çdo rezultat individual i testit është më i madh se 85% e forcës karakteristike të specifikuar.

Nëse një rezultat i kubit nuk përmbush kërkesën e dytë, rezultati mund të konsiderohet se përfaqëson vetëm grumbullin e veçantë të betonit nga i cili është marrë kubi, me kusht që forca mesatare e grupit të plotësojë kërkesën e parë.

Nëse më shumë se një kub i një grupi nuk arrin të përmbushë kërkesën e dytë ose nëse forca mesatare e ndonjë grupi prej katër kubesh prove të njëpasnjëshme nuk arrin të përmbushë kërkesën e parë, atëherë i gjithë betoni në të gjitha grupet e përfaqësuara nga kube të tilla do të konsiderohet i mospërputhshëm me kërkesat e forcës.

#### 5.7.3 Mos-Respektimi i Kërkesave Specifike

Kur forca mesatare e katër kubeve të njëpasnjëshme të provës nuk përmbush kërkesën e parë, asnjë pjesë tjetër nga ajo përzierje nuk do të vendoset në punë dhe Kontraktori do të përcaktojë shkakun e dështimit dhe do të zbatojë mjete të nevojshme për ndreqjen e tij. Kontraktori duhet të demonstrojë nga

## “NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”

përzierjet e provës dhe rezultate të provës së kubeve që përzierja e rishikuar është në përputhje me kërkesat e specifikuara.

Kontraktori, brenda 24 orëve nga data e testimit, do të bëjë propozime për marrëveshje me Inxhinierin për veprimet që duhet të ndërmerren në lidhje me çfarëdo betoni të përfaqësuar nga kubet e provës që dështon të plotësojë ndonjë nga kërkesat. Këto propozime mund të përfshijnë, por nuk do të kufizohen në, prerjen dhe testimin e bërthamës.

Betoni, i cili përfundimisht nuk përputhet me ndonjë nga kërkesat e Specifikimit do të priset dhe zëvendësohet ose përndryshe të trajtohet siç mund të kërkohet nga Inxhinierit me shpenzimet e Kontraktorit.

Për më tepër, Inxhinieri mund të urdhërojë që çimento shtesë të shtohet direkt në përzierje. Përzierjet e përdorura gjithashtu mund të ndryshohen sa herë që, sipas mendimit të Inxhinierit, një ndryshim i tillë është i nevojshëm ose i dëshirueshëm për të siguruar punueshmërinë e kërkuar, densitetin, përfundimin dhe forcën e sipërfaqes, dhe Kontraktori nuk do të ketë të drejtë kompensimi shtesë për shkak të ndryshimeve të tilla.

### 5.7.4 Testimi i Betonit të Freskët

Testi i Faktorit Kompaktues: Ky test do të kryhet në fazën paraprake të testimit dhe sa herë që merret një mostër konkrete për bërjen e kubeve të provave. Vlerat për faktorët e pranueshëm tregohen në tabelën në vijim "Testi i Masës së Qëndrueshmërisë".

Testi i Masës së Qëndrueshmërisë: Ky test do të kryhet rregullisht si një ndihmë për ruajtjen e qëndrueshmërisë uniforme të betonit gjatë progresit të punimeve. Vlerat e pranueshme të rënies tregohen Tabela 5-1 .

### 5.7.5 Testimi i Betonit të Ngurtësuar

Rezultatet e testit të kubit të betonit përdoren për të përcaktuar nëse betoni që do të përfshihet në punimet permanente ka arritur forcën e kërkuar. Betoni i ngurtësuar do të konsiderohet i papranueshëm për Punimet nëse rezultatet përkatëse të testit nuk përmbushin specifikimet dhe në këtë rast Kontraktori do të marrë të gjitha masat e nevojshme korrigjuese sipas udhëzimeve të Inxhinierit.

Për krijimin e kubeve testues Kontraktori do të sigurojë një numër të mjaftueshëm, jo më pak se 12 kallëpe standarte celiku 200 mm.

Për secilën klasë, një grup prej 6 kubesh do të krijohet nga secili prej 3 grupeve të grumbullimit të njëpasnjëshëm. 3 nga secili grup prej 6 do të testohen në një jetëgjatësi prej 7 ditësh dhe 3 në një jetëgjatësi prej 28 ditësh.

Kubet duhet të krijohen, kurohen, ruhen, transportohen dhe testohen në përputhje me standardet e aprovuara.

Në secilin moshë të testimit, asnjë forcë e kubit nuk duhet të bjerë nën minimumin e duhur të caktuar për testet paraprake të forcës.

Punimet e kubeve të Testimit do të krijohen nga kampione konkrete të punimeve të marra nga pika e vendosjes sic dhe kur orientohet nga Inxhinieri. Normalisht për secilën shkallë të betonit, 6 kube duhet të krijohen nga betoni i marrë në mënyrë të rastësishme, 3 kube nga secili grup duhet të testohen në një jetëgjatësi prej 7 ditësh dhe 3 në një jetëgjatësi prej 28 ditësh.

Në përgjithësi kubet do të kërkohet të jenë të paktën si më poshtë:

- Për çdo 25 m<sup>3</sup> beton të vendosur;
- Për secilën pjesë të rëndësishme strukturore; dhe
- Përndryshe sic udhëzohet nga inxhinieri.

Kubet duhet të krijohen, kurohen, ruhen, transportohen dhe testohen sipas përcaktimeve.

Një regjistrim i testeve të tilla që identifikojnë kubet e provës me pjesën e punës së kryer do të mbahet në vendin e punës nga Inxhinieri dhe do t'i vihet në dispozicion Kontraktorit.

Forca e duhur e nevojshme do të konsiderohet e peëmbushur nëse asnjëra nga forcat e të tre kubeve të testuar të çdo jetëgjatësie nuk është nën fortësinë e specifikuar të kubit, ose nëse forca mesatare e tre kubeve nuk është më e vogël se forca e specifikuar e kubit dhe ndryshimi midis forcave më të mëdha dhe atyre më të vogla nuk është më shumë se 20% e asaj mesatareje.

## “NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”

Nëse fortësia e pritshme e kubit 28-ditor w 28 vlerësohet nga fortësia e kubit 7-ditor w 7 në testet paraprake dhe testet e kontrollit të cilësisë, kjo mund të bëhet, në përgjithësi, duke aplikuar faktorët e dhënë në tabelën më poshtë, në vlerat me forcën e kubit 7-ditor (sipas DIN 1045):

Tabela 5.5: Faktorët e konvertimit për kub 7-ditor në 28-ditë

Kategoria e forcës së cimentos	Fuqia e presionit të Kubit 28-ditor w 28
Z 25	1.4 * w7
Z 35 L	1.3 * w7

Testi i ngurtësimit jep një tregues të fortësisë së betonit në strukturë për një kohë të caktuar dhe jep edhe udhëzime për kohën e heqjes së formës siç përcaktohet në tabelën vijuese të nxjerrë nga DIN 1045 7/88, Tabela 6.3.

Ngurtësimi mund të përcaktohet, në përputhje me standardet e aprovuara, në ekzemplarët e provës ose me mjete jo destruktive.

Mostrat për këto prova merren nga betoni i destinuar për përbërësit strukturorë në fjalë dhe ruhen fare afër ose mbi këta përbërës dhe kurohen në të njëjtën mënyrë (nën ndikimin e temperaturës dhe lagështisë). Të paktën tre ekzemplarë do të krijohen për provën e ngurtësimit, por këshillohet që të bëhen më shumë në mënyrë që nëse forca e përcaktuar në provë konstatohet të jetë e papërshtatshme, testi të mund të përsëritet.

Përbërësit, dimensionet e të cilëve ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga ato të ekzemplarëve të provës, mund të arrijnë një shkallë të ndryshme të fortësisë nga ai i mostrave, p.sh. për shkak të ndryshimeve të evoluimit të nxehtësisë në beton. Faktorë të tillë duhet të merren në konsideratë kur vlerësohen rezultatet e testit.

Nëse, për shkak të mungesës së rezultateve të provës së forcës kompresive, ose në rast se ekziston arsye për të dyshuar në forcën e betonit në ndonjë seksion të veçantë, mund të jetë e nevojshme të përcaktohet fortësia kompresive e betonit duke marrë ekzemplarë nga struktura ose, nëse autorizohet nga inxhinieri, duke performuar testim jo destruktiv në përbërësit e përfunduar ose me të dyja metodat. Në lidhje me teste të tilla do të merren parasysh jetëgjatësia dhe kushtet e ngurtësimit (temperatura, lagështia) të betonit në strukturë.

### 5.7.6 Prerja dhe Testimi i Mostrave të Bërthamës

Si dhe ku drejtohet nga Inxhinieri, mostrat e bërthamës cilindrike duhet të merren në sipërfaqen e betonit të ngurtësuar për ekzaminim dhe testim. Procedura e shpimit, ekzaminimit, matjes dhe testimit duhet të jetë në përputhje me DIN 1048. Para përgatitjes për testim, mostra do të vihet në dispozicion të Inxhinierit për ekzaminim. Nëse forca shtypëse e ekzemplarit e përcaktuar në përputhje me DIN 1048 është më e vogël se forca karakteristike për jetëgjatësinë 28 ditore, ai beton në atë pjesë të punimeve në të cilën është marrë si mostër do të konsiderohet si jo i përputhshëm me kërkesat e specifikuara.

### 5.8 Matja dhe Pagesa për Beton

Matja për pagimin e betonit do të bëhet vetëm në linjat e rregullta të strukturave siç tregohet në vizatime ose siç përcaktohet nga Inxhinieri.

### 5.9 Armatura për Beton

Kontraktori do të jetë përgjegjës për përcaktimin e armaturave dhe do të sigurojë dhe rregullojë të gjitha armaturat e nevojshme, së bashku me skelat shoqëruese, lëndët e drurit, mbështetjen, përforcimin, etj, të nevojshme për vendosjen e betonit.

Në varësi të kërkesave të sipërfaqes së betonit për përdorim si strukturë, Kontraktorit do ti lejohet të përdorë shkumë ndërtimi, dërrasë të fortë nga një prodhues i aprovuar, pllaka celiku, pllakë druri.

Kur përdoret pllakë drusore sipërfaqet e strukturës që vijnë në kontakt me beton të lagësht duhet të përbëhen prej druri të kalitur mire, me trashësi të mjaftueshme për t'i rezistuar presionit të betonit të lagësht, ndërsa ai vendoset dhe dridhet pa asnjë shtrembërim të çfarëdo lloji.

Format duhet të jenë të fiksuara në një linjë të përsosur dhe të mbështetura në mënyrë të sigurtë në mënyrë që të jenë në gjendje t'i rezistojnë, pa zhvendosje ose devijim, lëvizjes së njerëzve, materialeve dhe bimëve, dhe presionit të betonit të lagësht, ndërsa ai hidhet dhe shpërndahet.

Struktura do të ndërtohet në mënyrë të atillë që të mos ketë rrjedhje të llacit.

I gjithë betoni i ekspozuar duhet të ketë kënde të jashtme të plotësuar 25 mm x 25 mm ose, kur udhëzohet, në sasi më të madhe, me anë të shiritave dalluese të fiksuara në armaturë.

Unazat metalike dhe lidhjet e telit nuk do të përdoren për lidhjen e përkohshme të anëve të kundërta të armaturës për muret e betonit dhe pjesën e strukturave mbajtëse ose përcjellëse të ujit. Përdorimi i metodave të tilla të lidhjes në strukturat e tjera do t'i nënshtrohet miratimit të Inxhinierit.

Kudo që lejohen lidhjet me unaza metalike dhe me tel, skajet e unazave ose lidhjeve pas heqjes së formave duhet të priten së paku 13 mm nga faqja e betonit dhe të mbulohen me llaç çimentoje 1:2, që përmban një aditiv të aprovuar për zvogëlimin e tkurrjes. Ky operacion do të kryhet me kujdes. Vrima e formuar nga procesi i prerjes duhet të pastrohet dhe laget tërësisht përpara se të mbushet. Llaci duhet të jetë i lagësht dhe i qëndrueshem. Shtesa duhet të jetë e rregulluar si duhet, në mënyrë të lëmuar që të përputhet me sipërfaqet rrethuese të betonit dhe të kurohet plotësisht duke u mbajtur me lagështi të paktën për tre ditë. Pasi shtesa të jetë ngurtësuar, ajo dhe betoni ngjitur do të zbriten në tokë në mënyrë të kujdesshme. Këto operacione do të konsiderohen të përfshira në tarifat e betonit.

Kur shufrat ose mbështjellëset prej metali të përdorura për të mbajtur strukturën lejohen të qëndrojnë të ngulitura ato do të përfundojnë jo më pak se 25 mm nën pjesën ballore të strukturës së betonit (40 mm në sipërfaqet mbajtëse të ujit). Mbërthyeset e integruara në skajet e këtyre shufrave ose mbështjellëseve duhet të jenë të tilla që heqja e tyre të lërë vrima të një forme të rregullt. Vrimat e lëna në sipërfaqet e betonit me heqjen e mbërthyesve në shufrat mbajtëse dhe mbështjellëse, dhe aditivi i aprovuar zvogëluar i tkurrjes do të bëhet plotësisht i papërshkueshëm nga uji. Mbushja me llac duhet të përfundojë e barazuar me sipërfaqen e betonit siç përcaktohet më sipër.

Kur është e nevojshme, anët paralele ose vrimat për marrjen e bulonave mbajtëse, si dhe vrimat thelbësore, xhepat, etj., për kryerjen e punimeve metalike, tubat, shkallët dhe rakorderitë e tjera duhet të formohen në beton me kuti prej druri të thella, të fabrikuar në një mënyrë të tillë që ato të tërhiqen plotësisht ose të copëtohen dhe mënjanojnë pasi të vendoset betoni. Instalimi dhe heqja e të gjitha kutive të tilla kur betoni është ngurtësuar mjaftueshëm, konsiderohet se përfshihet në tarifat e betonit.

### **5.10 Tolerancat e Konstruksionit të Betonit**

Pas përfundimit të punës do të lejohen tolerancat e mëposhtme të konstruksionit të betonit. E gjithë puna me beton duhet të ekzekutohet në dimensionet, format, pozicionin dhe nivelin e kërkuar në projekt. Inxhinieri mund të zbatojë toleranca të tjera nëse kërkohet.

Toleranca për dimensionet e kolonave, mureve, pllakave të trarëve: - 0 mm deri në +10 mm.

Mbulesa e betonit për përforsim:

- Mbulesë prej betoni prej 30 mm: - 0 mm deri + 5 mm
- Mbulesë prej betoni prej 35 mm: - 0 mm deri në +10 mm
- Mbulesë prej betoni prej 50 mm: - 0 mm deri në +10 mm

### **5.11 Riparimi i Betonit**

Riparimi i betonit kryhet nga punëtorë të aftë dhe në prani të Inxhinierit ose Përfaqësuesit të tij në përputhje me ENV 1504.

Kontraktori do të korrigjojë të gjitha papërsosmëritë në sipërfaqet e betonit brenda 24 orëve pas heqjes së formave. Betoni që është i dëmtuar nga ndonjë shkak dhe betoni që është poroz, i thyer ose i dëmtuar hiqet dhe zëvendësohet me metoda të përshtatshme dhe të aprovuara. Heqja e betonit do të bëhet në mënyrë që përforsimi të mos dëmtohet p.sh. prerja e betonit me ujë të presionit të lartë.

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

Carjet do të rimbushen me Rrëshirë Epoksi, Poliuretani ose Gëlqere Çimentoje ose Cimento e Përkoshme në varësi të qëllimit të rimbushjes p.sh. mbyllja kundër substancave gërryese, mbyllja e plasaritjeve, lidhja e cila është e aftë të shtrihet (tërhiqet), lidhje jo pozitive. Për më tepër, do të përcaktohet lloji i aplikimit nën presion (injeksion) ose pa presion.

Zëvendësimi i betonit mund të kryhet me beton sipas EN 206, Beton Spërkatës sipas DIN 18551, dhe Llaç Çimentoje si edhe me përzierje speciale si beton ose llaç i modifikuar me polimer.

Asnjë suvatim i sipërfaqeve të lëmuara të betonit nuk lejohet.

Të gjitha materialet, procedurat dhe operacionet e përdorura për riparimin e betonit do t'i nënshtrohen miratimit të Inxhinierit.

### **5.12 Përfundimi i Sipërfaqes dhe Trajtimi**

#### **5.12.1 Të Përgjithshme**

Para fillimit të çdo betonimi, Kontraktori do të paraqesë detajet dhe llogaritjet për të gjithë armaturën e nevojshme për kryerjen e punës. Cdo dëm për shkak të forcës së pamjaftueshme të armaturës duhet të rregullohet nga Kontraktori.

Armatura duhet të jetë e dizenuar dhe konstruktuar në mënyrë të tillë që betoni të vendoset siç duhet dhe të kompaktësohet tërësisht. Betoni i ngurtësuar, ndërkohë që ende mbështetet nga armatura, duhet të përputhet saktësisht me formën, pozicionin dhe nivelin e kërkuar, duke iu nënshtuar tolerancës dhe standardeve të specifikuara.

Normat për betonim përfshijnë strukturën dhe të gjitha llojet e prerjeve dhe mbeturinave dhe formimin e kanaleve 25 mm x 25 mm në të gjitha rrjedhjet e ekspozuara ose siç tregohet ndryshe në Vizatime.

Cilësitë përfundimtare nuk do të jenë inferiore ndaj atyre të përshkruara më poshtë. Nëse një porozitet i vogël është i dukshëm përgjatë heqjes së armaturës, inxhinieri mund të aprovojë një trajtim sipërfaqësor, duke e fërkuar me çimento dhe llaç të imët të grumbulluar të së njëjtës pasuri si në beton atë pjesë të veçantë të punimeve. Ky trajtim do të kryhet menjëherë pas heqjes së armaturës.

#### **5.12.2 Sipërfaqja e Armaturës**

Të gjitha sipërfaqet e betonit, veçanërisht ato të ekspozuara, përfshirë të gjitha strukturat e paracaktuara, duhet të derdhen në çelik ose armatura të planifikuara të drurit. Të gjitha skajet e dukshme duhet të priten siç urdhërohet nga Inxhinieri. Kur është e nevojshme dhe e urdhëruar nga Inxhinieri, sipërfaqja duhet të fërkohet me një gur Carborundum ose me një gërryese të një cilësie të barabartë për të hequr shenjat e formës dhe projekcionit, duke lënë kështu një sipërfaqe të butë, të dendur, pa gropa ose parregullsi.

Secila sipërfaqe, pavarësisht nga strukturat e përdorura, të cilat shfaqin zbrazëtitë ose vrimat e ajrit, do të rregullohet sipas pëlqimeve të inxhinierit. Prerja e betonit pas përfundimit ose në atë thellësi siç kërkohet dhe/ose specifikohet nga inxhinieri, dhe çdo riparim tjetër, nuk do të fillohet pa inspektimin dhe miratimin e Inxhinierit. Mund të aplikohen finoja ose materiale të tjera të përshtatshme e të miratuara.

Të gjitha sipërfaqet e betonit duhet të mbrohen nga dëmtimet dhe deformimet, dhe Kontraktori do t'i heqë të gjitha dëmtimet dhe t'i rregullojë të gjitha dëmet sipas kërkesave të Inxhinierit.

Të gjitha kostot për bërjen e gërryerjes së duhur, dhe për betonin e dëmtuar, dhe për riparimin e sipërfaqeve të dëmtuara do të konsiderohet se përfshihen në tarifat e betonit të futura në preventiv.

#### **5.12.3 Sipërfaqe që Nuk Kërkojnë Armaturë**

E gjithë sipërfaqja e sipërme e betonit duhet të punohet plotësisht gjatë kryerjes së vendosjes për të nxjerrë një përfundim të lëmuar pa ujë, grumbullime të trashë agregatësh, xhepa ajri, ose gërryerje.

Kontraktori do t'i kërkohet të përgatisë teste ose mostra nën drejtimin e Inxhinierit, dhe metodat dhe mënyrat e përfundimit, opsionet dhe përzgjedhja e agregatit dhe karakteristika të tjera që ndikojnë në punë do të miratohen përpara se të kryhet ndonjë punë e mëtejshme.

Sipërfaqet do të formohen duke vendosur beton të tepërt brenda formave dhe duke hequr ose goditur tepërcën me një shabllon prej druri. Sipërfaqja më pas do të ngjishet në mënyrë të barabartë, me

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

ndihmën e sasisë së aprovuar të uji aty, ku do të tregohet, për të dhënë një sipërfaqe të dendur me një minimum çimentoje dhe materiale të imëta. Prerja nuk do të bëhet në atë masë sa të sjellë në sipërfaqe materiale të tepërta të imëta. Përdorimi i një shtrese llaci lejohet vetëm kur tregohet në Vizatime. Përfundimi i sipërfaqeve të betonit do të ekzekutohet në mënyrat e mëposhtme, siç tregohet në Vizatime dhe/ose në Preventiv ose siç udhëzohet nga Inxhinieri.

### Përfundim i ashpër:

Përfundimi i ashpër do të konsistojë në nivelimin dhe rrafshimin e betonit për të prodhuar një sipërfaqe uniforme dhe të thjeshtë për tiparet strukturore siç janë betoni i dobët, fazat vijuese të ndërtimit, betoni i lidhur, sipërfaqet me shtresë llaci dhe patinim.

### Përfundim i gërvishtur:

Si më lart, por sipërfaqja do të ashpërsohet para vendosjes përfundimtare për të rritur lidhjen e ardhshme midis pjesëve strukturore.

### Përfundimi lundruer:

Pasi të jetë prishur betoni, sipërfaqja duhet të limohet me një limues prej druri të hollë ose të përafërt. Mund të përdoren limuesit prej tape. Ky përfundim do të përdoret në majat e themeleve, kolonave, trarëve dhe të gjithë pjesëve normale strukturore.

### Përfundimi zbritës:

Në përputhje me sa më sipër, zbritja përfundimtare do të kryhet pas lëmimit duke përdorur një mistri çeliku për të prodhuar një sipërfaqe uniforme, të lëmuar në cilësi dhe pamje. Ky përfundim do të përdoret për sipërfaqet e depozitave dhe kanaleve, si dhe për dyshemetë, kur specifikohet dhe/ose udhëzohet nga Inxhinieri.

### Përfundimi fshesë ose rrip:

Në përputhje me sa më sipër, sipërfaqja duhet të përfundojë për të prodhuar një strukturë të trashë dhe jo të rrëshqitshme. Ky përfundim do të përdoret për pllakat e hyrjes së këmbësorëve dhe në vendet e tjera ku specifikohet dhe/ose udhëzohet nga Inxhinieri.

### **5.12.4 Trajtimi me Ngurtësues Kimik**

Kur specifikohet në preventiv, sipërfaqja e pllakave që kërkon rezistencë të lartë të veshjes duhet të trajtohet me ngurtësues kimikë. Vetëm materialet e aprovuara nga prodhues të njohur që përballojnë stresin mesatar dhe të lartë, tendosjen, si dhe që janë rezistentë ndaj kimikateve, të cilat janë miratuar nga inxhinieri, mund të përdoren. Zbatimi i ngurtësuesve kimikë duhet të jetë në përputhje të plotë me udhëzimet e prodhuesit.

Pas kurimit të pllakave të betonit me përfundimin e fshesës ose përfundim tjetër të ekzekutuar tashmë, sipërfaqet duhen larë dhe fshirë me ujë për të pastruar të gjitha papastërtitë, vajin, yndyrnat dhe pluhurin, dhe më pas të lejohen të thahen para aplikimit të ngurtësuesit kimik.

Ngurtësuesi duhet të derdhet në pllakën plotësisht të thatë dhe të përhapet në mënyrë të barabartë me një fshesë. Kur ngurtësuesi është absorbuar plotësisht, dhe përpara se pllaka të thahet, të gjitha materialet e tepërta duhet të hiqen. Në mënyrë të ngjashme do të aplikohen shtresat e dyta dhe të treta.

### **5.13 Nyje në Beton**

#### **5.13.1 Të Përgjithshme**

Kontraktori I referohet detajeve të nyjeve standard (që formon pjesë të këtij Nën-Seksioni) për ndërtimin e tipeve të kërkuara të nyjeve inë struktura të ndryshme të cilat janë treguar në Vizatime.

Kosto e nyjeve do të përfshijë të gjithë punët dhe materialet në formimin e nyjeve sic tregohen në Vizatime, duke përfshirë ndër të tjera, kur kërkohet:

## “NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”

---

- Armatura, prerje për kalimin e armaturës nëse është e nevojshme dhe prerje për kalimin e ndalimit të ujit.
- Ndalimi i ujit dhe bashkimi.
- Mbushës nyjesh zgjerimi (lëvizëse).
- Formimi i brazdave dhe izolimi me përbërësin e miratuar të izolimit.
- Shufra kunji 20 mm, e gjatë 1 m, me mbështjellëse dhe paketim, aty ku tregohet në Vizatime.
- Kontrolle adekuate të finos

### 5.13.2 Nyjet e Ndërtimit

Këto nyje duhet të jenë të tipit të treguar në detajet standarde të nyjeve.

Lidhja e betonit në të gjithë nyjet do të bëhet duke hequr shtresën sipërfaqësore dhe duke ekspozuar agregatin në pjesën ballore të nyjes, sapo betoni të jetë ngurtësuar. Sipërfaqja duhet të lahet tërësisht me ujë të pastër para fillimit të betonimit.

Pozicioni i propozuar i nyjeve të ndërtimit i paraqitet Inxhinierit dhe miratohet prej tij përpara se të fillojë ndërtimi i secilës strukturë të veçantë. Një nyje do të kryhet kurdo që përfundon betonimi për atë ditë, ose sa herë që betonimi ka ndalur për cfarëdo arsyeje.

### 5.13.3 Nyjet lëvizëse (Tkurrje-Zgjerim)

Nyjet e lëvizjes do të ndërtohen në pozicionet siç tregohen në Projekt ose siç udhëzohen ose aprovohen nga Inxhinieri.

Kur tregohet në Vizatime, shufrat do të vendosen përgjatë gjithë nyjes. Ato do të kenë skaje të sharruara dhe do të pajisen dhe sigurohen me djepa prej çeliku në secilën anë të nyjes. Ato vendosen me pikën e mesme të akseve gjatësore që kryqëzojnë rrafshin e nyjës në kënde të drejta, me gjysmën e gjatësisë së shufrave të veshur në mënyrë të përshtatshme për të parandaluar lidhjen. Vendosur mbi gjatësinë e veshur duhet të jetë një karton ose mbështjellje plastike, e mbyllur dhe e paketuar me fije qelqi në një thellësi prej 75 mm në fund të shiritit më të largët nga nyja.

Kur tregohet në Vizatime ose siç udhëzohet nga Inxhinieri, nyjet duhet të vulosen në njërin ose të dy faqet, siç kërkohet. Në faqen ose faqet të cilave u nevojitet izolim, do të formohet një brazdë me formën dhe dimensionet e paraqitura në detajet standarde të bashkimit. Jo më herët se katërmbëdhjetë ditë pas vendosjes së betonit, ose kur udhëzohet ndryshe nga Inxhinieri, brazda duhet të pastrohet, thahet nëse është e nevojshme, të përgatitet dhe të mbushet me një përbërës të përshtatshëm izolues mastik në pjesën e poshtme të kanaleve.

Izoluesi duhet të përgatitet dhe aplikohet rreptësisht në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

## 5.14 Izolimi I Nyjeve

### 5.14.1 Të Përgjithshme

Ky seksion përfshin punën që përfshin shpërndarjen dhe vendosjen e materialit bashkues dhe izolimin e nyjeve në strukturat e betonit.

### 5.14.2 Materialet e Nyjeve

Lidhjet e ekspansionit duhet të plotësohen me një material bashkimi të aprovuar, i cili do të jetë i kompresueshëm dhe i qëndrueshëm ndaj erozionit dhe ekstruzionit.

Materiali i bashkimit duhet të mbahet mbrapa pjesës ballore, siç tregohet në vizatimet e detajuara të nyjeve, prerjet e formuara duhet të shtresohen dhe izolojnë me një përbërës të aprovuar izolimi.

Kontraktori mban përgjegjësi për cilësinë e të gjitha këtyre materialeve, përfshirë aderimin e izolantit bashkues. Izoluesit e nyjeve që janë shumë të butë, shumë të brishtë, ose që nuk kanë ngjitjen dhe rezistencën e përcaktuar do të zëvendësohen nga Kontraktori pa ndonjë kosto shtesë. Miratimi i materialit nga Inxhinieri nuk e lehtëson Kontraktorin nga detyrimet e tij sipas Kontratës.



#### **5.14.3 Materiali i Nyjeve Lidhëse Izoluese Sintetike**

Të gjitha nyjet e pjesëve të betonit duhet të vulosen me mastikë siç përcaktohet dhe/ose siç udhëzohet nga Inxhinieri. Kontraktori do të zgjedhë përbërësin e përhershëm elastik, vulosja sintetike e cila ka një shkallë të lartë shtrirjeje, forcë optimale elastike dhe ngjitje të mirë me betonin. Mund të përdoren produkte të përbërë nga një ose dy përbërës, me bazë polimerit të lëngshëm, polisulfid, gomës së silikonit dhe poliuretani ose të tjerë; sidoqoftë do të përdoren vetëm materiale të përshtatshme, të krijuara nga prodhues të njohur të cilët janë rezistentë ndaj plakjes, oksigjenit, rrezatimit ultra-violet, ujit, vajit, yndyrnave, kimikateve dhe biodegradimit dhe që janë miratuar nga Inxhinieri.

Mastiku i gri i betonit duhet të përdoret për nyjet në zonat e ekspozuara të betonit. Lidhjet në zonat e betonit që nuk janë të ekspozuara mund të mbushen me mastikë me ngjyrë të errët.

Mastiku duhet të ruhet në enë të mbyllura në një vend të thatë dhe të freskët para përdorimit, në mënyrë rigorozë në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

Përbërjet e izolimit me mastikë të përdorur për nyjet e zgjerimit në rezervuarët e ujit duhet të jenë:

- fiziologjikisht absolutisht të sigurtë, d.m.th. ato nuk përmbajnë asnjë substancë që mund të konsiderohet si një substrat për bakteret e ujit;
- rezistent ndaj çdo detergjenti të përdorur në rezervuarët e ujit; dhe
- në përputhje me kërkesat shëndetësore për ujë të pijshëm.

Përbërësi izolues me mastikë i përdorur për nyjet e zgjerimit të depozitave të kanalizimeve, kanalizimeve, dhe çdo elementi tjetër strukturor të ekspozuar ndaj efektit të kimikateve (p.sh. njësia e llakut, grackat e naftës etj.), duhet të jetë rezistent ndaj kimikateve siç janë alkali, acidi dhe tretësit etj. dhe ndaj biodegradimit që vjen si rezultat i sulmit nga bakteret që në kushte normale janë të pranishëm në kanalizimet e ujërave të ndotura dhe llumrat e kanalizimeve.

#### **5.14.4 Mjeshtëria për Nyjet Lidhëse**

Nyjet duhet të përgatiten siç tregohet nga prodhuesi i përbërjes së izolimit.

Thellësia e nyjes së bashkimit duhet të jetë siç tregohet në projekt, por të paktën 25 mm ose e barabartë me gjerësinë e nyjes. Në rastin e skajeve të bashkimit, izolimi duhet të vendoset vetëm midis faqeve të bashkimit paralel.

Në përputhje me udhëzimet e prodhuesit, mastiku do të aplikohet - brenda hapësirës kohore të specifikuar pas shtresëzimit nga poshtë lart në nyjet vertikale - me një mjet (armë) izolues të pajisur me një grykë që mbush gjerësinë e nyjes. Materiali i tepërt duhet të hiqet para forcimit të mastikut.

#### **5.14.5 Ndalesat e Ujit (Shufrat e Ujit)**

Ky specifikim mbulon të gjitha punët e përfshira në furnizimin dhe vendosjen e ndalesave të parafabrikuara të ujit dhe shiritave të izolimit të përbashkët për izolimin e nyjeve në pjesët e betonit. Shufra Shtesë të Ujit duhet të konsiderohen në varësi të sekuencës së vendosjes së Betonit dhe lartësisë së Strukturës individuale.

Profili i shufrës së ujit për nyjet e shtrirjes dhe tkurrjes duhet të ketë një tub qendror me një diametër të jashtëm të barabartë me gjerësinë e bashkimit. Nyjet në pllakat bazë mund të kenë një shufër të sheshtë uji të jashtme siç tregohet në Vizatime.

Nyjet ndërtimore në strukturat mbajtëse të ujit etj., do të pajisen me shufra uji siç përcaktohet.

Shufër e veçantë uji me çelik të inkorporuar mund të përdoret për nyjet zgjeruese dhe/ose tkurrëse të depozitave të ujit.

Para fillimit të punës përkatëse, Kontraktori duhet t'i paraqesë Inxhinierit, mostra, certifikata provash dhe udhëzimet e vendosjes, të lëshuara nga prodhuesi i të gjitha shufrave të ujit të propozuara dhe shiritave të izolimit të nyjeve.

Kontraktori do të jetë përgjegjës për cilësinë e të gjitha materialeve. Aprovimi i materialeve nga Inxhinieri nuk e liron Kontraktorin nga detyrimet e tij sipas Kontratës.

Shufrat e ujit të parafabrikuara dhe shiritat izolues duhet të përbëhen nga material i përhershëm elastik rezistent ndaj plakjes, oksigjenit, rrezatimit ultra-violet, ujit, vajit, yndyrnave dhe kimikateve.

Shufrat e ujit të përdorura për zgjerimin dhe bashkimin e nyjeve të rezervuarëve të ujërave të zeza, kanalizimeve dhe elementeve të tjerë strukturorë të ekspozuar ndaj efekteve të kimikateve duhet të jenë rezistente ndaj sulmit nga acidet alkalis dhe tretësit.

Vetëm materialet që pajtohen me kërkesat e specifikimit do të dërgohen për përdorim në Punime, këto mund të jenë prej shufrave ujqorë Elastomerikë të bërë prej gome artificiale (kloroprene-neoprene). Vulkanizimi i shufrave të ujit mund të bëhet në vendin e punës. Vulkanizimi i shufrave të ujit elastomerik kërkon kujdes të madh dhe duhet të bëhet aty në fabrikë. Nuk do të lejohet një ngjitje e papërshkueshme nga uji. Të gjitha pajisjet e nevojshme për vullkanizimin do të sigurohen nga Kontraktori.

Të gjitha pajisjet e kërkuara për kryqëzimet, T-et dhe pjesët e kryqëzimeve duhet të furnizohen nga prodhuesi. Prodhimi në vendin e fabrikës së pjesëve të tilla nuk lejohet, përveç nëse sigurohen pajisjet e përshtatshme vullkanizuese dhe metodat dhe pajisjet miratohen nga Inxhinieri.

Kontraktori do të bëjë një inspektim vizual të të gjitha shufrave të ujit para vendosjes për të siguruar që ato nuk kanë defekte ose dëmtime (fluska ajri, deformime, prerje, vrima, pjesë të brishta, etj.). Të gjitha shufrat e ujit duhet të ruhen në një vend të freskët dhe nuk duhet të ekspozohen ndaj diellit.

Për nyjet izoluese, duhet të përdoren vetëm llojet e shiritave të gomës elastomerike.

#### **5.14.6 Punimi për Shufrat e Ujit**

Shufrat e ujit duhet të vendosen në atë mënyrë që të sigurohen që dy fletët e tyre janë ngulitur në mënyrë të sigurt në secilën nga pjesët anësore të betonit. Ato duhet të fiksohen siç duhet për të shmangur lëvizjen gjatë vendosjes dhe ngjeshjes së betonit. Përdorimi i gozhdave nuk lejohet; do të përdoren vetëm këmbëza (kunja metalike) speciale ose mjete të tjera të aprovuara nga Inxhinieri; dhe të gjitha kostot për mjetet shtesë nuk do të paguhën vecmas. Kujdes i madh duhet të bëhet gjatë vendosjes dhe ngjeshjes së betonit rreth shufrave të ujit për të siguruar që betoni të mbyllë plotësisht shufrat e ujit. Materiali i kompresueshëm i bashkimit për nyjet zgjeruese duhet të ngjitet në faqen e pjesës së përfunduar për të shmangur rrëshqitjen gjatë punës së betonit për pjesën e dytë. Konsideratë duhet t'i kushtohet trashësisë së duhur të mbulesës së betonit që bashkon përforcimin e pjesëve të betonit, veçanërisht atyre që janë afër materialit bashkues. Për funksionimin e përsosur të nyjeve zgjeruese, duhet të shmangjet performimi i materialit bashkues nga vibratorët e brendshëm.

Puna e vullkanizimit në shufrat e ujit duhet të mbahet në një minimum absolut. I gjithë vullkanizimi duhet t'i rezistojë një provë lakimi pa formuar çarje. Diametri i rullit të lakimit në provën e përkuljes është 50 mm.

### **5.15 Llaçi i Çimentos dhe Fino**

#### **5.15.1 Të Përgjithshme**

Llaci i cimentos dhe fino nën pllakat mbajtëse dhe për mbushjen e xhepave duhet të përbëhet nga çimento, agregat i imët (rërë natyrale) dhe ujë. Nëse kërkohet, përdoren shtesa dhe/ose aditivë. Të gjithë përbërësit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Specifikimit për beton dhe subjekt i miratim të Inxhinierit.

#### **5.15.2 Forca**

Forca kompresive e llacit dhe finos e cila në të gjitha rastet do të përcaktohet në tre ekzemplare, në testet paraprake dhe në testet e kontrollit të cilësisë duhet të përputhet me kërkesat e mëposhtme:

- Forca më e ulët kompresive për secilin ekzemplar: 25 N/mm
- Kufiri më i ulët për forcën mesatare kompresive për çdo seri ekzemplarësh: 30 N/mm

Fortësia kompresive e llacit dhe finos do të përcaktohet me testimin e ekzemplareve (diametri 100 Mm, lartësia 120 Mm) të një periudhe prej 28 ditësh.

### **5.15.3 Përzjerja**

Përzjerja e llacit dhe finos bëhet në një mikser mekanik të aprovuar, sasia e ujit të shtuar duhet të jetë e mjaftueshme aq sa për të dhënë qëndrueshmërinë dhe punueshmërinë e dëshiruar për përdorimin për të cilin do të vendosen. Përzjerja kryhet siç përcaktohet për betonin.

Përzjerja me duar do të lejohet vetëm kur kërkohen sasi shumë të vogla dhe është marrë miratimi i inxhinierit.

I gjithë llaci dhe fino duhet të jetë në vendin e tyre përfundimtar në struktura brenda 30 minutave. Llaci dhe fino do të përbëhen nga një pjesë çimento dhe dy pjesë rërë e graduar mirë ose siç është aprovuar nga Inxhinieri.

Fino rezistente ndaj tkurrjes do të përdoret nën pajisjet e makinerive të rënda, duke iu nënshtruar lëvizjeve vibruese, reciproke dhe pulsuese dhe për të vendosur celikun strukturor në të gjithë pjesët ku nuk mund të tolerohet tkurrja e natyrshme në llacin normal të çimentos. Fino rezistente ndaj tkurrjes do të merret si një përzjerje e gatshme paraprake që kërkon vetëm shtimin e ujit për të prodhuar një fino rrjedhëse e cila kur kurohet, do të mbushë plotësisht xhepat në të cilat është hedhur. Fino duhet të jetë formuluar në mënyrë të tillë që të sigurojë rezistencë të lartë ndaj përdorimit afatgjatë që operon makineria. Fino do të sigurohet nga një prodhues i aprovuar nga Inxhinieri. Fino rezistente ndaj tkurrjes duhet të jetë pa përbërës hekuri të cilët mund të sjellin shenja ndryshku, gërryerje dhe zgjerim të mëvonshëm.

### **5.15.4 Mjeshtëria për Përdorimin e Finos**

Finoja nuk do të përdoret derisa punimet e çelikut ose pajisjet të jenë niveluar dhe instaluar, e ndërkohë bazat të mbështeten nga pykat e celikut.

Menjëherë para nisjes së operimit të mbushjes, e gjithë zona e mbuluar nga kushineta, duke përfshirë xhepat për mbajtjen e bulonave dhe një zonë shtesë përreth, e mjaftueshme për të parandaluar ndotjen, do të pastrohet plotësisht duke u larë me ujë nga tubat e zorrës, ajrit të kompresuar, etj. I gjithë pluhuri dhe lënda e dëmshme e liruar do të asgjësohet. Uji i tepërt do të hiqet duke përdorur leckë të lagur në mënyrë që sipërfaqja të mbetet e lagësht.

Llaci i sapo përzier sipas udhëzimeve, i një konsistence të përshtatshme do të shtohet për të mbushur xhepat për bulonat mbajtës dhe hapësirën poshtë pllakave mbajtëse. Llaci duhet ngjeshur mirë, duke punuar në një rën anë me thasë të përshtatshëm derisa të shfaqet në anën tjetër dhe do të merret cdo masë për të siguruar që të gjitha boshllëqet janë mbushur duke i dhënë mbështetje të plotë kushinetave në të gjithë hapësirën, pa vrima ajri, etj. Për ta siguruar këtë, vargje prej druri do të futen rreth skajeve të hapësirës së finos për të përmbajtur llacin gjatë punimit. Llaci që mund të dëmtojë rrotat e bulonave ose të ndikojë në mbajtjen e tyre në rondele dhe pllaka do të hiqet me kujdes pa lëvizur llacin paraprakisht të vendosur dhe pas përfundimit të operacionit, skajet e llacit do të shkurtohen. E gjitha më pas do të mbulohet me thasë të lagur ose pelhurë, të cilët do të mbahen në lagështi të vazhdueshme për një periudhë jo më pak se 7 ditore pas së cilës do të hiqen, dhe i gjithë llaci i lëshuar dhe ngjitës që ka mundësi të zvogëlojë efikasitetin e kushinetave do të hiqet me kujdes. Pas 28 ditësh, të gjitha mbajtëset dhe bulonat e tjerë do të shtrengohen sipas udhëzimit.

### **5.15.5 Strukturat e Përkohshme dhe Format**

#### **5.15.6 Të Përgjithshme**

Nëse Kontraktori ka për qëllim të përdorë struktura të përkohshme prej druri, të gjitha lëndët drusore duhet të jenë prej druri të shëndoshë dhe të kalitur. Lloje të tjera të strukturave të përkohshme si për shembull skela prej çeliku ose tuba prej çeliku mund të përdoren.

Betoni i përforcuar nuk duhet të derdhet në mënyrë direkte mbi një faqe të gërmuar, por vetëm mbi armaturë të përshtatshme.

I gjithë betoni, vecanërisht ai i ekspozuar, duke përfshirë betonin e hedhur paraprakisht duhet të jetë i vendosur drejtë. Panelet e armaturës prej çeliku ose kompensate të miratuara për punime betoni, mund të përdoren nëse janë pa defekte që mund të dëmtojnë pamjen e përgjithshme të sipërfaqes së

përfunduar. Nyjet midis dërrasave dhe paneleve duhet të jenë horizontale dhe vertikale ose siç udhëzohet nga Inxhinieri.

#### **5.15.7 Dizajnimi i Strukturave të Përkohshme dhe Formave**

Kontraktori duhet t'i paraqesë Inxhinierit për miratim detajet e strukturave të përkohshme dhe format e menduara për tu përdorur përpara fillimit të punimeve.

Dorëzimi i detajeve të tilla nuk e heq Kontraktorin nga përgjegjësia për sigurimin e mjaftueshmërisë së strukturave të përkohshme dhe format.

Është përgjegjësi e Kontraktorit të përcaktojë dimensionet e bazës në një mënyrë të tillë që zgjidhja e nëntokës nën ngarkesat e betonit të jetë e vogël dhe simetrike.

Vendosja e strukturave të përkohshme dhe e bazave duhet të matet dhe regjistrohet gjatë betonimit. Do të merren masa për të lejuar kompensimin e rregullimeve të papritura dhe lëshimin e njëtrajtshëm të strukturave të përkohshme me anë të krikëve hidraulikë ose të paktën me pykë.

#### **5.15.8 Kërkesë për Ndërtimin e Formave**

Format duhet të jenë të një cilësie dhe forcë të tillë që të ruajnë ngurtësinë gjatë vendosjes dhe dridhjes së betonit. Brenda tolerancës së lejueshme, betoni i përfunduar duhet të përkojë në formën, pozicionin dhe nivelin e kërkuar në projekt. Për të parandaluar ngjitjen e betonit, format duhet të lyhen me vaj të aprovuar nga Inxhinieri. Vaji do të aplikohet sipas rekomandimeve të prodhuesit. Vaji i formës duhet të jetë i një cilësie të tillë që të mos cngjyrosë sipërfaqen e betonit të ekspozuar. Duhet ushtruar kujdes për të parandaluar ndotjen e përforcimit.

Format duhet të lagen plotësisht në të dy anët përpara vendosjes së betonit. Nuk do të lejohet qëndrimi i ujit në forma. Lidhjet duhet të jenë mjaftueshëm të shtrënguara për të parandaluar rrjedhjen e llacit.

E gjithë papastërtia, pluhuri, dhe materie të tjera të huaja duhet të hiqen nga forma përpara se të vendoset betoni. Kur pjesa e poshtme e formave është e paarrtshme, dërrasat e formës më të ulët do të lihen të lirshme në mënyrë që të mund të hiqen për pastrimin e materialit të jashtëm menjëherë para se të vendoset betoni.

Kur kërkohet të përdoren lidhjet e brendshme ose ankorimin brenda formave, ato do të jenë të një dizajni të tillë që pas heqjes së tyre, zgavrat që kanë mbetur të jenë të madhësisë më të vogël të lejueshme. Lidhjet e brendshme metalike duhet të vendosen në mënyrë që të lejojnë heqjen e tyre në një thellësi prej së paku 50 mm pa dëmtim të betonit.

Cdo lloj lidhjeje e brendshme, pozicioni i tyre dhe mbushja e zgavrave do të miratohet nga Inxhinieri, veçanërisht në rastin e betonit të ekspozuar. Lidhjet e zakonshme të telit nuk do të lejohen.

Specifikimi për format do të zbatohet në mënyrë të barabartë në format metalike. Metali i përdorur duhet të jetë i një trashësie të tillë që ato të ruajnë formën e tyre. Format metalike që nuk paraqesin një sipërfaqe të lëmuar ose nuk përputhen siç duhet, nuk do të përdoren. Kujdes i veçantë do të ushtrohet për të mbajtur format metalike pa ndryshk dhe graso.

#### **5.15.9 Heqja e Strukturave të Përkohshme dhe Format**

Heqja e strukturave të përkohshme dhe formave do të kryhet në përputhje me DIN 1045. Numri i caktuar i ditëve ndërmjet vendosjes së betonit dhe heqjes së strukturave të përkohshme dhe formave do të respektohet ngushtësisht. Në varësi të kurimit dhe kushteve të motit mund të jetë e nevojshme kohë më e gjatë nëse fortësia e betonit është akoma e ulët. Heqja e strukturave të përkohshme dhe formave nuk mund të kryhet në asnjë rast pa miratimin dhe drejtimin e Inxhinierit. Heqja e punimeve duhet të kryhet në atë formë që betoni të mos ndikohet ose dëmtohet në ndonjë mënyrë. Riparimet e betonit do të kryhen vetëm pas inspektimit nga Inxhinieri.

## **5.16 Përforcimi**

### **5.16.1 Çertifikatat e Përforcimit**

Të gjitha dërgesat e përforcimit të çelikut shoqërohen me certifikatën e prodhuesit që jep rezultatet e testeve të kryera në përputhje me kërkesat e standardit përkatës. Inxhinieri mund të kërkojë nga Kontraktori që të paraqesë mostra prej çeliku nga secili dorëzim tek një Autoritet i aprovuar për testim.

### **5.16.2 Materiali**

Çelik i Butë: Shufra kryesore rrethore e çelikut – Pika e rendimentit minimal 220 N/mm<sup>2</sup>, sipas DIN 488 Pjesët 1 dhe 2.

Çeliku Cilindrik: Shufra çeliku të deformuara – Pika e rendimentit minimal 420 N/mm<sup>2</sup>, sipas DIN 488 Pjesët 1 dhe 2.

Rrjeta prej Çeliku: Pëlhurë teli e ngjitur fortësisht – Pika e rendimentit minimal 500 N/mm<sup>2</sup>, sipas DIN 488 pjesa 4.

### **5.16.3 Kërkesat e Ndërtimit**

Vizatimet përforcuese dhe programet e lakimit të shufrave, përveçse nëse indikohet ndryshe, përgatiten nga Kontraktori dhe kontrollohen e aprovojnë nga Inxhinieri. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rrezeve të lakimit, gjatësive të ankorimit dhe mbulesës së betonit.

### **5.16.4 Magazinimi dhe Mbrojtja**

I gjithë çeliku përforcues duhet të ruhet në platforma të ngritura ose mbështetës të tjerë dhe nuk duhet të vendoset në tokë. Ai duhet të ruhet në mënyrë të rregullt për të lehtësuar inspektimet, duke mbajtur të ndarë secilin diametër dhe kualitet.

Çeliku përforcues duhet të mbrohet gjatë tërë kohës nga dëmtimet dhe, kur vendoset në strukturë, duhet të jetë pa papastërti, shkallë ndryshku, bojë, vaj apo substanca të tjera të huaja.

### **5.16.5 Lakimi**

Shufrat përforcuese të çelikut do të priten dhe lakohen nga punëtorë kompetentë në përputhje me dispozitat e DIN 1045. Ato do të lakohen sipas modeleve, të cilat nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga forma dhe dimensionet e paraqitura në projekt. Duhet të shmangen të gjitha lakimet e mprehta dhe në asnjë rast rrezja e lakimit nuk duhet të jetë më pak se 80 mm për diametër të shufrës përforcuese më të vogël se 20 mm, dhe 200 mm për diametrat e shufrës përforcuese të barabartë ose më të madh se 20 mm dhe më pak se 28 mm sipas DIN 1045.

I gjithë çeliku përforcues duhet të vendoset me saktësi dhe, gjatë vendosjes dhe dridhjes së betonit, të fiksohet fort në pozicionin e treguar në Vizatime.

Largësia nga format duhet të mbahet me blloqe, lidhëse, varëse ose mbështetës të tjerë të aprovuar. Blloqet për mbajtjen e armaturës larg nga kontakti me format duhet të jenë me materiale të përshtatshme dhe me formë e dimensione të aprovuara. Mbjatës të veçantë në distancë mund të përdoren për beton të papërshkueshëm nga uji të rezervuarëve të ujit etj. Mbjatëset duhet të jenë mjaftueshëm të shkurtra që të lejojnë që skajet e tyre të mbulojnë me beton. Shufrat përforcuese duhet të lidhen për siguri së bashku në mënyrë të atillë që të ruajnë pozicionin e tyre saktësisht të caktuar gjatë vendosjes së betonit. Skajet e të gjithë telave do të futen në beton larg faqes ballore.

### **5.16.6 Ndarja**

Të gjitha shufrat e çelikut për përforcim të betonit me një gjatësi totale më të vogël se 12m duhet të pajisen në gjatësinë e plotë të treguar në Vizatime. Shufrat e çelikut me ndarjet e paraqitura në Vizatime duhet të jenë të copëzuara dhe shufrat e çelikut që tejkalojnë gjatësinë 12 m mund të ndahen siç tregohet në Vizatime dhe siç urdhërohet nga Inxhinieri.

Saldimi i shufrave të çelikut kryhet vetëm nëse autorizohet nga Inxhinieri.

#### **5.16.7 Miratimi i Përforcimit**

Asnjë pjesë betoni nuk duhet të vendoset derisa përforcimi të ekzaminohet dhe aprovohet nga Inxhinieri. Kontraktori duhet të njoftojë në një periudhë minimale prej të paktën 24 orësh përpara fillimit të planifikuar të betonimit, për t'i lejuar kohë Inxhinierit të kryejë një kontroll të plotë dhe të detajuar të armaturës. Nëse sipas mendimit të Inxhinierit kërkohet përforcim shtesë, ai do të vendoset ashtu siç urdhërohet nga Inxhinieri.

#### **5.16.8 Mbulesa e Betonit**

Mbulesa e betonit për armaturën kryesore nuk duhet të jetë më e vogël se sa vijon:

- Pjesë të strukturave të ekspozuara ndaj ujit dhe/ose tokës: 50 mm
- Pjesë të strukturës të paekspozuara ndaj ujit dhe/ose tokës: 25 mm ose nëse nuk caktohet ndryshe.

## **6 Strukturat mbajtëse(parandaluese) të Ujit**

### **6.1 Të përgjithshme**

E gjithë puna që synon të largojë ujin ose që do të transportojë ose mbajë ujin, duhet të bëhet e papërshkueshme nga uji. Kontraktuesi do të shqyrtojë Dokumentet e Kontratës për të bindur veten se mund të arrijë papërshkueshmërinë e ujit, me modelin dhe materialet e specifikuar në të. Nëse ai i konsideron ato të pamjaftueshme për të arritur papërshkueshmërinë e ujit, atëherë ai do përfshijë në tenderin e tij materiale dhe punë shtesë siç e konsideron të nevojshme. Të gjitha rrjedhjet që mund të shfaqen në provë ose mund të zhvillohen gjatë Periudhës së Njoftimit të Defekteve, përmes çfarëdo shkaktari që del, do të shlyhen nga Kontraktori me shpenzimet e tij dhe nën pëlqimin e Inxhinierit.

### **6.2 Mjeshtëria**

#### **6.2.1 Vendosja e Tubave**

Për aq sa është e mundur, të gjithë tubacionet që kalojnë përmes ndonjë pjese të një strukture mbajtëse të ujit prej betoni duhet të pajisen me fllanxa dhe duhet të jenë të integruar si proces betonimi, armaturë e mbështjellë rreth tubit. Sidoqoftë kur prej mos-disponueshmërisë së tubacioneve ose për shkak të nevojës për të vendosur ose montuar me precizion tubacionet me tubacione apo pajisje të tjera, dhe në varësi të pëlqimit të Inxhinierit, Kontraktori mund të krijojë xhepa (hapje) për tubacionet. Nyjet midis këtyre fazave të betonizimit duhet të trajtohen si nje pune në strukturat mbajtëse të ujit.

Klasat e ekspozimit për lokacione të ndryshme dhe kushtet e ekspozimit sipërfaqësor së bashku me shkallën e agresivitetit janë dhënë në tabelën vijuese:

**“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

**Tabela 7.5: Ekspozimi i Sipërfaqes (Metal dhe Beton)**

Kategoria	Lokacioni	Kushtet e Sipërfaqes së Ekspozuar	Shkalla e Agresivitetit
A.1	Atmosfera	E ekspozuar në Atmosferë mbi nivelin e tokës dhe e destinuar për cikle kondesimi, Ultraviolet dhe të thatë	Mesatare
A.2	Atmosfera	Brenda ndërtesave me ajër të kondicionuar/të thatë	Shumë e Butë në E Butë
A.3	Atmosfera	Brenda por e ekspozuar ndaj Kondesimit të Lartë psh Pusetat e Inspektimit/ Valvulave	Agresive
A.4	Atmosfera	Brenda/jashtë ndërtesave por nga një anë e sipërfaqes e ekspozuar ndaj gazrave H <sub>2</sub> S/kondensimeve të acidi, brenda puseve të lagur etj.	Shumë Agresive
A.5	Toka / Rimbushja	E thatë	Shumë e Butë
A.6	Toka / Rimbushja	Me lagështirë, e lagur, e ngopur ose e kondensuar me kapilarë	Agresive
A.7	E lëngshme	Rickluar/efluente/ uji i pishëm/uji i shirave etj.	Agresive
A.8	E lëngshme	Uji i detit, zonë spërkatjeje, ujëra nëntokësorë, etj	Shumë Agresive
A.9	E lëngshme	Brenda kanalizimeve, bakteret, lëngje që përmbajnë acide organike të tretura	Shumë Agresive
A.10	E lëngshme	Shumë agresive psh. acid sulfurik, H <sub>2</sub> SO <sub>4</sub> formacione të krijuara nga kondensimi H <sub>2</sub> S, acidit organik etj.	Ekstremisht Agresive

Përgatitja dhe lyerja për sipërfaqe të ndryshme, përveç metalit, janë dhënë më poshtë:

**Tabela 7.6: Përgatitja dhe Lyerja për Sipërfaqe të Ndryshme përveç Metalit**

Sipërfaqja	Lokacioni	Fundi/Lloji	Përgatitje specifike	Praimeri	Trajtimi Final
Dru i butë	I brendshëm	Shkëlqim	Zmerilim	1 veshje praimer roze	3 veshje alkyd
	I Jashtëm	Shkëlqim	Zmerilim	1 veshje praimer roze	3 veshje alkyd
Stukim (përfshirë stukimin e dërrasës)	I Brendshëm	Sheshuar	Zmerilim	1 veshje	2 veshje emulsion
	I Jashtëm	Shkëlqim	Zmerilim	1 Praimer me veshje alkali rezistent	2 veshje alkyd
	I Brendshëm	Shumëngjyrësh	Zmerilim	1 veshje praimer	1 veshje shumëngjyrëshe për përfundimin e mureve
Veshje me cemento e betonit (faqe e drejtuar)	I Brendshëm	Sheshuar	-	1 veshje emulSIONI	2 veshje emulsion

**“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

Sipërfaqja	Lokacioni	Fundi/Lloji	Përgatitje spcifikë	Praimeri	Trajtimi Final
	I Jashtëm	Shkëlqim	-	1 Primer me veshje alkali rezistent	2 veshje alkyd
	Përzjerë	Mat (Epoxy)	Furçë teli	1 praimer me veshje speciale	2 veshje epoksi
Tulla	I Jashtëm	Sandtex (Bojë e trashë)	Furçë e fortë	1 Veshje me solucion stabilizuesi solution	2 veshje sandtex
Strukturë Druri	I Brendshëm	Shkëlqim	Praimer Kromat Zinku për të vidhosur dhe gozhduar	1 veshje emulsioni	2 veshje emulsion
	I Brendshëm	Shkëlqim	Praimer Kromat Zinku për të vidhosur dhe gozhduar	1 veshje te fortë primeri	2 veshje alkyd

## 8 Punë me Bllloqe, Suvatim dhe Pllakat e Dyshemesë dhe Mureve

### 8.1 Bllloqe Betoni

Bllloqet e betonit duhet të jenë në përputhje me DIN 18 153 ose ekuivalent. Muret dhe ndarjet e ndërtesës, kur përcaktohet, ndërtohen nga bllloqe me ullukë të trashësisë dhe forcës së kërkuar siç përcaktohet në Preventiv. Përzjerja e betonit do t'i nënshtrohet miratimit të Inxhinierit.

Bllloqet do të prodhohen nga një makinë e aprovuar ose të furnizohen nga prodhues të Certifikuar.

Të gjitha bllloqet duhet të trajtohen me kujdes; përdorimi i bllloqeve të dëmtuara nuk do të lejohet.

Bllloqet e betonit duhet të jenë në përputhje me sa vijon:

- Bllloqet nuk duhet të jenë më të trasha se 100 mm;
- Bllloqet e fondacionit duhet të mbushen me beton (C12 / 15);
- Asnjë blllok nuk duhet të pritët për të siguruar lidhje, por bllloqe speciale me gjatësi modulare 1/2 ose 1/4 do të sigurohen për të siguruar lidhje të saktë;
- Bllloqet e betonit mbahen vazhdimisht të lagura për 10 ditë pas hedhjes;
- Bllloqet duhet të jenë të rrethuar me zgavra vertikale dhe të spërkaten vazhdimisht me ujë;
- Për tre javë të tjera bllloqet duhet të ndalohen nga tharja e shpejtë dhe herë pas here spërkaten me ujë. Pirgjet e lagura nuk duhet të preken;
- Sipërfaqja e bllloqeve duhet të jetë e lëmuar për lyerje; dhe
- Të gjitha punimet me beton do të kryhen në lidhje të ngushtë.

### 8.2 Bllloqet Ranore

Bllloqet ranore do të prodhohen në vend me rërë dhe çimento nga një aparat i aprovuar. Rëra dhe çimentoja duhet të jenë në përputhje me kërkesat e mëposhtme, rëra përmban gradualizimin e mëposhtëm:

**Tabela 8.1: Vlerësimi i Rërës për Bllloqet**

<b>Madhësia e Sitës</b>	<b>Përqindja e Kalueshmërisë</b>
2.4	-100
1.2	95 – 100
0.6	25 – 85
0.3	5 – 50
0.15	0 – 10

Bllloqet duhet të jenë të forta, me faqe të mprehta të përcaktuara mirë, dhe duhet të jenë të gjata 400 mm me 200 mm të larta nga trashësia e specifikuar, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Inxhinieri.

Menjëherë pas kallëpeve, bllloqet duhet të vendosen në një paletë të pastër dhe të kurohen duke u spërkatur vazhdimisht me ujë ose mjete të tjera të aprovuara.

Për një mostër prej dymbëdhjetë bllloqesh, të zgjedhura në mënyrë të rastësishme, forca mesatare kompresive nuk duhet të jetë më e vogël se 3 N/mm<sup>2</sup>, dhe asnjë bllok prej dymbëdhjetë nuk duhet të jetë më i vogël se 2.4 N/mm<sup>2</sup>. Nëse këto kërkesa nuk përmbushen, i gjithë grumbullimi nga i cili janë zgjedhur dymbëdhjetë bllloqet do të refuzohet.

### **8.3 Puna me Bllloqet**

Puna me Bllloqet duhet të përputhet me kërkesat e forcës sipas DIN 1053.

#### **8.3.1 Dimensionet**

E gjithë puna e bllloqeve do të jetë sipas dimensioneve, trashësisë apo lartësisë, ashtu si tregohet në Vizatime.

#### **8.3.2 Trajtimi i Bllloqeve**

Të gjithë bllloqet duhet të jenë të trajtuara me kujdes për të parandaluar çdo dëmtim dhe duhet të mbrohen sipas nevojave. Asnjë plasaritje, thyerje apo bllok I thyer nuk do të përdoret për punë.

#### **8.3.3 Lagia e Bllloqeve**

Në mot të thatë, shkalla e thithjes e të gjitha bllloqeve me rërë dhe beton duhet të rregullohet duke u lagur përpara se të përdoret, dhe majat e mureve të mbetura të papërfunduara lagen para se të fillohet puna sërish.

#### **8.3.4 Shtrimi Llacit**

Të gjitha bllloqet duhet të jenë të mbushura (lyera) mirë me llaç para se të vendosen dhe të gjitha nyjet duhet të derdhen plotësisht ndërsa punimet vazhdojnë.

#### **8.3.5 Uniformiteti**

Punimet me bllloqe duhet të kryhet në mënyrë uniforme, duke mos u ngritur asnjëri më shumë se një metër mbi tjetrin për një herë. Të gjitha pingulet, kuotat etj., duhet të mbahen rreptësisht strikt dhe katrore dhe të gjitha të lidhura siç duhet së bashku dhe të niveluara për çdo kat ose lartësi të rënë dakord. Shkopinjte nuk do të përdoren përveç kur kërkohet për bashkim. Duhet të bëhet një bashkim i plotë i llaçit kur bllloqet mbartin beton ose armaturë.



### **8.3.6 Bashkimi dhe Spërkatja**

**Bashkues Llaci:** Bashkimet e faqeve të llaçit për sa kohë është jeshil, duhet të goditen me faqet e tullave ose blloqeve dhe, nëse kërkohet të fërkohen për të dhënë cilësinë e kërkuar.

**Bashkues i ambientuar:** Lidhjet e llacit, për sa kohë është jeshil, duhet të përfundojnë me një lidhës të ambientuar ndërsa puna vazhdon.

**Bashkues Inkaso:** Lidhjet e llaçit, për sa kohë është jeshil, duhet të përfundojnë me një bashkim të mprehtë katror dhe të jetë me thellësi uniforme prej afro 12 mm.

**Spërkatja:** Lidhjet e blloqeve duhet të krruhen ndërsa puna vazhdon, deri në një thellësi prej 20 mm, dhe i gjithë pluhuri të pastrohet me kujdes. Ndërsa dhe kur drejtohet nga Inxhinieri, nyjet duhet të lagen mirë dhe të spërkatën me një llaç të aprovuar ku janë zgjedhur ngjyra dhe përzjerësit, dhe të përfundohet siç përshkruhet.

Të gjitha punët me blloqe duhet të jenë të shtruara në kurse horizontale, pa asnjë pjesë të ngritur më shumë se 90 cm mbi një tjetër për një herë. Puna do të jetë e drejtë dhe uniforme në pamje.

Të gjitha blloqet duhet të lagen mirë para përdorimit dhe pjesa e sipërme e mureve të papërfunduar duhet të laget para se të fillohet puna. Të gjitha blloqet duhet të lyhen (shtrohen) mirë me llaç para shtrimit, nyjet vertikale duhet të lyhen plotësisht ndërsa puna vazhdon. Lidhjet horizontale dhe vertikale duhet të jenë me trashësi uniforme jo më të mëdha se 10 mm. Blloqet me brazdë dhe sistem gjuhe nuk do të kenë nyje vertikale të mbushura me llaç.

Mbivendosja e tullave në shtresa të ndryshme duhet të jetë minimumi 0.4 herë e lartësisë së tullave, por jo më pak se 45 mm.

Asnjë punë me blloqe nuk duhet të kryhet kur temperatura e ambientit është nën 3°C.

## **8.4 Llaci**

### **8.4.1 Përzjerësit**

Llaci duhet të ketë forcën e kërkuar sic jepet prej llojit dhe ngarkesës së punëve të blloqeve në përputhje me DIN 1053-1.

Përzjerjet e llacit dhe suvave për punët e blloqeve, stukove dhe për përdorim të jashtëm duhet të jenë sic përshkruhen në tabelën që vijon:

**Tabela 8.2: Përzjerjet e llacit**

<b>Llaçi i Çimentos</b>	<b>Çimentoja</b>	<b>Gëlqerja</b>	<b>Rëra</b>
Grada A	350 kg	-	1 m <sup>3</sup>
Grada B	300 kg	-	1 m <sup>3</sup>
Grada C	250 kg	-	1 m <sup>3</sup>
Grada D	150 kg	-	1 m <sup>3</sup>

### **8.4.2 Përzjerja**

Përbërësit për llaçin çimento maten në kuti matësin e duhur mbi një platformë të ngritur, përbërësit kthehen mbi dy herë në të thatë dhe dy herë ndërsa shtohet ujë nëpërmjet spërkatjes. Ndryshe, përzjerja mund të bëhet me anë të një mikseri mekanik të aprovuar të serisë.

### **8.4.3 Aditivët - Llaçi Stukues**

Llaçi Stukues duhet të jetë prej një prodhuesi të aprovuar dhe do të përdoret në proporcione dhe mënyrën e rekomanduar nga prodhuesi. Përqindjet e përzierjes së llaçit rregullohen nëse është e nevojshme në përputhje me rekomandimet e prodhuesit

### **8.4.4 Pigmente për Ngjyrosje të Llacit**

Kur specifikohet llaç me ngjyrosje, pigmenti duhet të jetë i një prodhimi të aprovuar dhe nuk do të dëmtojë përbërësit e tjerë të llaçit. Ai do të përzihet me kujdes për të siguruar një ngjyrosje të barabartë në të gjithë përzierjen dhe do të bëhet në një sasi e mjaftueshme për të siguruar përfundimin e një zone të dhënë.

## **8.5 Suvatimi**

### **8.5.1 Përgatitja për Suvatim**

Në qoftë se nuk përdoret një agjent lidhës, tavanet e betonit, rrezet e tavanit, kolonat dhe mbështetësit duhet të lëmohen ashtu si duhen para se të fillohet suvatimi dhe përzierja e përdorur për lëmim do të jetë e ngjashme me atë të përdorur për veshjen e parë. Sipërfaqja e betonit në vend duhet të tregohet se arrin një lidhje të mirë të përshtatshme në sipërfaqe. Sipërfaqet duhet të lagen menjëherë para fillimit të suvatimit. Këndet midis mureve dhe tavaneve, këndet vertikale dhe bashkimet midis spondeve të ngurta të ndryshme duhet të përforcohen me pëlhurë 90 mm të gjerë të vendosur në suva dhe sheshuar me mistri. Të gjitha bashkimet midis suvave duhet të trajtohen në mënyrë të ngjashme. Shinat metalike për këndet duhet të sigurohen në të gjitha qoshet e jashtme; nuk do të bëhen pagesa shtesë për përgatitjen e kërkuar të punës.

### **8.5.2 Fiksimi i pllakave të gipsit**

Pllakat e gipsit për tavanet duhet të mbërthehen që të mbajnë 150 mm në qendër me gozhda gipsi antindryshk 40 mm dhe fiksohet kështu që bashkuesit janë lidhur. Duhet të sigurohet traversa ose sipërfaqe të tjera fiksuese në gjendje për të siguruar që buzët e pllakave të gipsit të jenë siguruar në mënyrë adekuate. Fundet e pllakave duhet të ngjiten fort dhe në skaje të lihet një hapësirë jo më shumë se 5mm. Kur të priten pllakat, gozhdat nuk duhet të jenë më shumë se 18 mm nga prerja e buzës. Gozhdët duhet të vidhosen mirë me kokat pak poshtë sipërfaqes por nuk duhet të thyejnë fletën.

### **8.5.3 Suvatimi**

Të gjitha punimet do të kryhen sipas DIN 18550-1. Fortësia e shtresave të ndryshme do të ulet nga substrati në sipërfaqe.

Suvatimi normalisht do të aplikohet në dy shtresa në përputhje me udhëzimet e prodhuesit dhe do të përdoren sa më shpejt që të jetë e mundur pasi të shtohet uji. Trashësia e suvatimit për strukturat e jashtme duhet të jetë mesatarisht 20 mm dhe minimumi 15 mm dhe për strukturat brenda 15 mm/10 mm, suvatimi i aplikuar në një shtresë (llaç suvatimi i bërë nga fabrika) 10 mm/5 mm dhe nëse kërkohet suvatim rezistent ndaj ujit 15 mm/10 mm.

Sistemet e suvatimit për strukturat e jashtme duhet të bëhen sipas grupit të llaçit të suvatimit PII, llaç çimento gëlqere me një fortësi minimale kompresive prej 2.5 N/mm<sup>2</sup>. Për përgatitjen e sipërfaqes do të përdoret rërë me shkallëzim 0/4 mm ose 0/8 mm për shtresën e parë të llaçit 0/2 ose 0/4 mm dhe për shtresën e dytë duhet të përdoret 0/2 mm.

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

Suvatimi i brendshëm duhet të bëhet me të njëjtin sistem (PII) si jashtë, por përgatitja e sipërfaqes do të bëhet me rërë 0/4 mm dhe shtresa e dytë me rërë 0/1 mm.

### **8.6 Izolim Kundër Lagështirës (DPC)**

Izoluesit kundra lagështirës në muret e themelit, përveç se udhëzohet ndryshe, do të jenë të llojit të miratuar me 3 shtresa mbulimi prej shajaku, të vendosur jo më pak se 80 mm mbështjellje dhe me shtrat llaci prej cimentoje. Sistemet e tjera do t'i nënshtrohen miratimit të inxhinierit.

Nën shtresa poshtë Dyshemeve:

Mbi shtresën mbuluese të betonit do të aplikohet një membranë kundër lagështirës në dy shtresa letre (shtresa e dytë që mbulon bashkimet e shtresës së parë). Kujdes duhet të tregohet që të mos dëmtohet letra ndërtimore e hedhur gjatë derdhjes së betonit për dysheme.

### **8.7 Pllaka dyshemeje qeramike dhe Pllakëza Muri**

#### **8.7.1 Të përgjithshme**

Në përgjithësi, pllakat dhe pllakat e mëdha duhet të plotësojnë kërkesat e cilësisë së DIN 18155, DIN 18158 dhe DIN 18166. Aty ku pllakat dhe pllakat e mëdha nuk janë të standardizuara, tiparet e cilësisë duhet të plotësojnë kërkesat Standarde komerciale (sipërfaqja e sipërme, paralelizmi i skajeve, ngjyrës dhe absorbimi I ujit). Të gjitha pllakat e dyshemesë dhe murit duhet të jenë nga e njëjta koli.

Materialet e përdorura në përzierjen e llaçeve dhe stukove për kompletimin në sipërfaqet e brendshme duhet të jenë siç përcaktohet për llaçet dhe suvatimet.

#### **8.7.2 Materialet**

##### **8.7.2.1 Pllaka Xhami për Mure**

Pllakat e xhamit për mure duhet të jenë me një trashësi minimale prej 6 mm dhe me ngjyrën e treguar në Vizatime tek Preventivi. Pllakat qeramike me xham për mure duhet të jenë korrekt në formë, të sheshta, pa të meta, çarje dhe gërvishtje, me ngjyrë uniforme, të mbyllura në pjesën e pasme dhe duhet të jenë në përputhje me DIN 18155. Lidhjet duhet të jenë të një lloji, madhësie, ngjyre të përshtatshme dhe rezistente ndaj acidit.

##### **8.7.2.2 Pllaka Qeramike Dyshemeje (Anti Acid)**

Pllakat e dyshemesë do të kenë një minimum trashësie prej 8 mm dhe me ngjyrë dhe model sic tregohet në Vizatimet tek Preventivi. Pllakat qeramike të dyshemesë do të jenë të rezistente ndaj acidit dhe yndyrnave, korrekte në formë, të sheshta, pa të meta, çarje dhe gërvishtje, me ngjyrë uniforme, dhe të parrëshqitshme lloji i aprovuar dhe me ngjyrë. Përmasat dhe tolerancat do të përmbushin DIN 18158 dhe DIN18166.

##### **8.7.2.3 Pllaka Tarrace**

Pllaka tarrace duhet të jenë 200 mm x 200 mm me trashësi minimale 25 mm. Ngjyra dhe modeli do të jenë siç tregohet në Vizatime tek Preventivi, ose siç udhëzohet nga Inxhinieri.

#### **8.7.2.4 Pllaka PVC**

Pllakat fleksibël PVC do të jenë 250mm x 250mm. trashësia minimale 3 mm. Ngjyra dhe modeli do të jetë sipas udhëzimeve të Inxhinierit.

#### **8.7.2.5 Ngjitës me bazë Cimentoje**

Ngjitësit me bazë Cimentoje duhet të përmbushin kërkesat e DIN 18156. Ngjitësit e tjerë duhet t'i nënshtrohen miratimit të Inxhinierit dhe të përzihen dhe përdoren korrektësisht në përputhje me udhëzimet e shtypura të prodhuesit. Materialet e cimentos dhe ngjitësit nuk duhet të ndikojnë në sipërfaqen e sipërme të pllakave.

#### **8.7.3 Mjeshtëria**

Shtrimi i pllakave nuk do të fillojë derisa puna dhe blerjet e tjera të kenë përfunduar. Pllakat do të shtrohen rrafshët me sipërfaqet pranë.

Për sipërfaqet ku pllakat e shtruara duhet të nivelohen, rrafshohen apo duhet të mbushen krisjet, vrimat dhe njollat do të përdoret cimento që nuk tkurret.

##### **8.7.3.1 Pllaka Xhami për Mure**

Pllakat duhet të përputhen në ngjyrë para se të fiksohen. Ato duhet të sigurohen në sipërfaqen e përgatitur me një ngjitës të miratuar. Lidhjet duhet të jenë të rregullta dhe në fund të mbushen (finohen) me çimento të bardhë. Këndet e jashtme duhet të rrumbullakosen duke përdorur pllaka posaçërisht të rrumbullakosura.

Pllakat e murit duhet të fiksohen në bashkime të vazhdueshme horizontale dhe vertikale në lartësitë e treguara. Fiksimi duhet të bëhet prej ngjitësve mastikë dhe të shtrihen sipas udhëzimeve të prodhuesve të ngjitësit. Lidhjet duhet të kenë minimumi 2 mm dhe sipërfaqja e pllakave të përfunduara nuk duhet të ndryshojë nga rrafshi i përgjithshëm me më shumë se 2 mm në çdo distancë prej 3 m. Sprucimi i lidhjeve do të bëhet me fino.

Kur është e nevojshme duhet të përfshihen rakorderitë e pllakave dhe skajet e jastëkut. Skajet e rrumbullakosura duhet të përshtaten mjeshtërisht me suvanë ngjitur.

##### **8.7.3.2 Pllaka Qeramike për Dysheme**

Në qoftë se nuk thuhet ndryshe, të gjitha pllakat e dyshemesë duhet të lagen mirë para shtrimit, të vendosen në një model të miratuar në një trashësi shtrati prej 40-45 mm të llaçit të shkallës "C" dhe më në fund të bashkohen dhe të sprucohen me fino çimento të përshtatshëm në ngjyrë.

Pllakat e bordurës duhet të kenë një bazë të lakueshme dhe buzë të sipërme të rrumbullakosur si dhe në madhësinë e treguar në Vizatime ose në Preventiv. Pllakat e bordurës duhet të përputhen me pllakat e dyshemesë si në ngjyrë ashtu edhe në strukturë dhe duhet të sigurohen me suvatim nga një ngjitës i miratuar.

Menjëherë pas shtrimit të pllakave dyshemeja duhet të pastrohet dhe një shtresë mbrojtëse tallash me trashësi 25 mm, me ndërrim herë pas here sipas nevojës, nëpër të gjithë sipërfaqen. Pas përfundimit tallashi do të pastrohet dhe pllakave do tu jepet një shtresë përfundimtare me një lustër të miratuar.

##### **8.7.3.3 Pllaka Tarrace**

Shtrimi, bashkimi dhe përfundimi duhet të bëhet sic përshkruhet për Pllakat e Qeramikës për Dysheme.

#### **8.7.3.4 PVC Tiles**

Pllakat PVC do të shtrohen me ngjitës në shtrat të sheshuar.

#### **8.7.4 Pastrimi dhe Mbrojtja**

E gjithë dyshemeja dhe përfundimet duhet të lihen në një gjendje të pastër dhe perfekte, dhe të gjitha papastërititë, yndyrat, daljet e materialeve ngjitëse duhet të hiqen me kujdes pa dëmtuar përfundimin e dyshemesë. Kontraktori do të mbrojë gjithashtu dyshemetë dhe bordurat nga dëmtimi pas vendosjes, duke përdorur mjetet më të përshtatshme dhe të aprovuara për llojin e dyshemesë në fjalë. Çdo seksion i gabuar, pllaka të krisura, të thyera ose të copëtuara, etj., do të zëvendësohen dhe do të përmirësohen, si dhe çdo dëmtim tjetër që rezulton nga dyshemetë e pambrojtura siç duhet.

### **9 Instalimet e Furnizimit me Ujë dhe Shkarkimit të Ujërave të Ndotura në Ndërtesa**

Kontraktori do të bëjë të gjitha marrëveshjet me Punëdhënësin për të siguruar që çdo lidhje të vendoset dhe të matet me standardet e Autoritetit.

Shkurtime dhe specifikime të katalogut për të gjitha pajisjet hidraulike duhet t'i paraqiten Inxhinierit për miratim. Çdo artikull i dërguar pa miratim paraprak mund të jetë subjekt i refuzimit dhe zëvendësimit.

#### **9.1 Të përgjithshme**

Instalimet e ujit dhe sanitare, pajisja dhe instalimi i ujëmatësve dhe valvulave ndaluese dhe pajisja dhe instalimi i tubave të shërbimit.

#### **9.2 Pajisjet Sanitare**

Furnizimi me Pajisjet sanitare dhe vendosja e tyre duhet të aprovohet nga Inxhinieri. Ato duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Lavaman përafërsisht. 55cm x 40cm
- Lavaman kuzhine përafërsisht. 60cm x 45cm x 25cm i bërë nga çelik inoks.

WC-të duhet të jenë të llojit syfonik prej qeramike të bardhë, me ndenjësë plastike me mbrojtës gome dhe depozitë shpëlarjeje dhe të jenë të montuara në dysheme.

Dushet duhet të kenë kokë dushi rezistent ndaj korrozionit, të montuar sipër, me vaskë 80cm x 80cm x 10cm, një valvul përzierëse plus një rubinet shtesë për të mbushur me ujë kovat.

Një tualet ose një dush me një piletë dyshemeje në çdo dhomë duhet të jetë i pajisur me një pritë (pengesë) aromash e lidhur me sistemin e kanalizimit.

#### **9.3 Rakorderitë e Tubave**

Do të përdoren tuba dhe rakorderi prej hekuri xingato ose PVC.

Instalimi i tubave të furnizimit me ujë do të kryhet në përputhje me standartet e miratuara ndërkombëtare. Tubat do të shtrihen brenda mureve ose poshtë dyshemesë.

#### **9.4 Pritat**

Çdo pajisje dhe pjesë e pajisjes që ka një pritë ose izolim integral, që kërkon lidhje me sistemin e kullimit sanitar duhet të jetë e pajisur me një pritë. Çdo pritë (pengesë) duhet të vendoset sa më afër

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

fiksimit, dhe asnjë pajisjeje nuk duhet t'i vihet pritë dyfish. Pritat e instaluara në tubin PVC duhet të jenë prej PVC. Pritat e instaluara në mbetjet e tualeteve duhet të jenë model zhytës- kullimi prej bronzi, ose e tipit tub-bronzi të kromuara.

### **9.5 Tubat e çative dhe ulluqet**

Tubat për kullimin e cative duhet të kenë një diametër jo më të vogël se 100 mm dhe do të prodhohen prej celiku xingato të lehtë ose PVC. Të gjitha bërnylat dhe kthimet duhet të bëhen me përkulje 45° dhe nuk do të lejohen bashkime të pjerrëta ose hundëza të përkulura poshtë. Tubat shkarkues duhet të mbështeten me rripa celiku xingato ose rripa PVC. Ulluqet duhet të kenë profile gjysmë të rrumbullakëta ose drejtkëndore, materiali duhet të jetë PVC ose hekur xingato. Gjerësia ose diametri i ulluqeve duhet të jetë 150 mm.

## **10 Xhamat dhe Pllakat**

### **10.1 Materialet**

#### **10.1.1 Xhamat**

Pllakat e xhamit të tejdukshme dhe të errëta duhet të jenë të cilësisë së disponueshme në vend dhe ashtu sic urdhërohet nga Inxhinieri.

#### **10.1.2 Pllakat**

Pllakat qeramike me lustër me trashësi 200 mm x 200 mm do të jenë të cilësisë së disponueshme në vend dhe ashtu sic miratohet nga Inxhinieri. Pllakat e përdorura në mure duhet të jenë të llojit dhe përmasave të përshtatshme për përdorim pllakash muri. Pllakat e përdorura në dysheme duhet të jenë të llojit dhe përmasave të përshtatshme për përdorim pllakash dyshemeje. Të gjitha pllakat e dyshemesë do të jenë të llojit të pa-rrëshqitshëm.

### **10.2 Mjeshtëria**

#### **10.2.1 Xhamat**

Qelqi do të pritet në madhësi me hapësirë të vogël dhe duhet të instalohet në përputhje me vizatimet e prodhuesit dhe rekomandimet e aprovuara nga Inxhinieri.

Xhami duhet të jetë i pastër brenda dhe jashtë dhe të gjithë xhamat e krisur apo të thyer duhet të zëvendësohen para mbarimit të Punimeve.

#### **10.2.2 Pllakat**

Pllakat do të ngjiten në mur me një ngjitës pllakash në përputhje me udhëzimet e prodhuesit dhe rekomandimet e aprovuara nga Inxhinieri. Pllakat dhe bashkimet do të shtrihen si duhet, me hapësirë uniforme midis pllakave, sipërfaqja e përfunduar duhet të jetë e lëmuar dhe hapësirat midis pllakave duhet të mbushen me fino pllakash. Ngjitësit dhe mbushësit duhet të përzihen dhe përgatiten në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

Pllakat e Murit me Xham - Pllakat para se të vendosen do të përshtaten në ngjyrë. Sipërfaqja që do vishet fillimisht duhet të suvatohet me një nënveshje 10 mm të trashë. Pllakat do të vendosen në llacin e cimentos afërsisht 5 mm të trashë. Bashkimet do të jenë të rregullat dhe të përfundohen me cemento të bardhë. Qoshet e jashtme do të rrumbullakosen duke përdorur pllaka të vecanta të rrumbullakosura.

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

Pllakat Qeramike të Dyshemesë - nëse nuk përcaktohet ndryshe të gjitha pllakat e dyshemesë duhet të jenë lagura para shtrimit, dhe të vihen në një shtresë llaci të aprovuar 40-45mm të trashë dhe sprucuar me një fino cimentoje në ngjyrë të përshtatshme.

Pllakat do të pastrohen dhe të gjithë ngjitësit dhe mbushësit e tepërt dhe pllakat e krisura apo të thyera do të zëvendësohen para mbarimit të Punimeve.

### **10.3 Muratura prej Qelqi (Puna me Qelq)**

Muratura prej qelqi duhet të ndërtohet nga tulla qelqi boshe 190/190/89 mm në përputhje me DIN 4242 dhe DIN 18175 të derdhura në panele. Ngjyra do të jetë qelqi i zakonshëm për rreth 80% të sasisë totale të tullave të qelqit dhe sasia e mbetur duhet të ngjyroset sipas gjykimit të Inxhinierit.

Çdo bashkim i tretë horizontal duhet të përforcohet me një shufër me përforcues në tërheqje 4 mm të salduar në profilet e çelikut që rrethojnë panelet.

Kornizat e paneleve do të prodhohen nga profile të rëndë alumini të anodizuar për punë të rëndë në BS 1474 (gradë 6063) si profilet standard U dhe Z dhe profile të tjera standard të paraqitura në vizatime. Ngjyra do të jetë sipas gjykimit të Inxhinierit.

Bullonat, dadot, rondelet duhet të bëhen prej çeliku inox, grada A4.

Kornizat do të vendosen në mënyrë të sigurtë në kolonat dhe trarët e betonit dhe do të kenë një pamje të pastër.

Bashkimet zgjatuese, të gjëra 20 mm, të mbushura me filler ngjeshës rezistent ndaj kalbjes do të instalohen në majë dhe anash panelit.

Bashkimet midis kornizave të çelikut dhe muratura ose betoni do të mbulojnë nga profile të sheshtë alumini të anodizuar ose çelik inox grad 316, të fiksuara me vida në beton.

Shtyllat e çelikut rezistente ndaj goditjeve në dizenjimet e zbulimit dhe heqja e tyre do të sigurohen nga jashtë paneleve me tulla xhami.

## **11 Punimet me Metal**

### **11.1 Të Përgjithshme**

Të gjitha punimet e çelikut (përveç strukturave të çatisë) kur instalohen duhet të galvanizohen (në banja të nxehta ose me spërkatje zinku). Saldimi në punimet me çelik të galvanizuar duhet të shmanget dhe montimi duhet të bëhet me bulona dhe lidhje.

Marzhet e lejuara të projektimit për materialet, bulonat, thumba, etj., janë dhënë në DIN 18800, për saldimit në DIN 4100.

Seksionet e mbështjellë strukturore të çelikut duhet të jenë prej çeliku të butë, konform DIN 17100. Dimensionet, tolerancat dhe vetitë e seksioneve strukturore duhet të jenë në përputhje me DIN 18201 deri në 18203 dhe me DIN 18800. Kur propozohet përdorimi i modeleve të parafabrikuara, Standardet me të cilat ato prodhohen nuk duhet të jenë më pak rigorozë sesa specifikohen këtu.

Për bashkimin e strukturave prej çeliku, bulonat e çelikut, dadot dhe rondelet duhet të jenë me forcë të lartë fërkimi, konform DIN 6914 deri DIN 6916 ose bulona të zinj, duke përfshirë dado dhe rondele që përputhen me DIN 7989 dhe DIN 7990.

Të gjitha materialet që do të konsumohen gjatë saldimit (elektroda, teli, shufra mbushëse, gazi mbrojtës dhe të ngjashme) duhet të jenë në përputhje me kërkesat e standardit të duhur DIN dhe me kërkesat e procedurës së duhur të saldimit.

(a) Të gjitha punimet metalike do të ndërtohen dhe instalohen në linjat dhe pozicionet e sakta të paraqitura në Vizatime ose të përcaktuara nga Inxhinieri. Ato duhet të jenë të ankoruara mirë në themelet ose strukturat e betonit.

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

Në qoftë se nuk është miratuar instalimi me mbushje në bulonat e ankorimit ose përdorimi i ankorimeve të zgjerimit në prerjet e përgatitura më parë, atëherë bulonat e ankorimit dhe pjesët metalike që duhet të futen në beton duhet të vendosen në pozicion para hedhjes së betonit dhe duhet të mbahen fort dhe saktë në vend ndërkohë që betoni vendoset.

Vetëm çeliku inox (materiali 1.457 sipas DIN) mund të përdoret për çdo përpunim metalik që do të ketë në kontakt me ujërat e zeza.

(c) Aty ku do të instalohen elementë prej gize, kutitë në sipërfaqe, ose kutitë e gypave dhe pusetat e valvulave, shkallët prej hekuri për pusetat, duhet të jenë me prodhim standard dhe do të furnizohen me tuba dhe pajisje shtesë në përputhje me klauzolat përkatëse të Specifikimit.

Të gjitha punimet e tjera metalike të bëra prej çeliku siç janë mbështetëset e tubave, kapëset e ankorimit të tubit, etj., do të fabrikohen nga Kontraktori.

Vrimat e bulonave duhet të bëhen vetëm me shpime dhe do të pozicionohen me saktësi në mënyrë që bulonat të futen lehtësisht.

Nëse nuk tregohet ndryshe në Vizatime, bulonat duhet të zgjaten nga dadot jo më pak se dy filetime.

### **11.2 Materialet**

#### **11.2.1 Punime Celiku**

Punimet strukturore të çelikut duhet të jenë sipas standarteve për përdorimin e vendosjes strukturore.

Bullonat, rondele etj. për përdorim me çelik strukturor duhet të jenë bulona të zinj. Mbërthimet, duke përfshirë bulonat që përdoren me materiale të galvanizuara do të sherardizohen (vishen me zink) ose do të aplikohet një veshje e aprovuar protektive metali.

Para porosisë apo prodhimit të cdo artikulli metalik, Kontraktori duhet të paraqesë për aprovim tek Inxhinieri të gjitha detajet dhe dimensionet e kërkuara për prodhim. Vetëm pasi të merret miratimi i Inxhinierit do të fillojë prodhimi.

#### **11.2.2 Seksionet Standarte**

Këndet, kanalet dhe rrafshet dhe të gjitha seksionet standarde të çelikut duhet të jenë në madhësitë e dhëna në Vizatime.

Këndet ose kanalet e përdorura për kornizim të hapjeve në strukturat e betonit ose për udhëzuesit duhet të pajisen me fiksues çeliku të salduar mirë në kornizë ose udhëzues para galvanizimit.

Mbrojtja nga korrozioni do të jetë ashtu sic detajohet në Vizatimet ose në Preventiv në cilësinë dhe standardin e specifikuar.

### **11.3 Saldimi**

Të gjitha saldimet gjatë prodhimit në fabrikë dhe ngritjes në Vendin e Punës (kantier) do të kryhen në përputhje me kërkesat siç tregohen në vizatimet e detajuara të miratuara. Detajet e procedurave të propozuara të saldimit do t'i paraqiten Inxhinierit për miratim në të njëjtën kohë me vizatimet e detajeve. Të gjitha lidhjet duhet të saldohen në atë mënyrë që lidhjet e përfunduara të duken të këndshme dhe të lëmuara, dhe të përshtatshme për lyerje. Të gjitha skorjet do të hiqen, dhe çdo dalje e mprehtë do të sheshohet. Të gjitha saldimet e bëra gjatë prodhimit dhe ngritjes në vend do të kryhen në përputhje me kërkesat e DIN 4100 dhe siç tregohet në vizatimet e detajuara të miratuara. Para se të fillojë saldimi, qoftë në dyqanin e fabrikimit ose në kantier, testet e procedurës së saldimit do të kryhen kur urdhërohen nga Inxhinieri.

Të gjithë saldatorët e punësuar në dyqanin e prodhimit ose në kantier duhet të kenë kaluar teste të kualifikimit, të rëndësishme për procedurat e saldimit, në përputhje me Standardin e duhur DIN. Saldatorët duhet të kenë prova të kënaqshme se kanë qenë të angazhuar në saldimit për të paktën 9 muaj në periudhën e mëparshme. Nëse puna e ndonjë saldatori të punësuar në Kontratë është e pakënaqshme,



## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

Kontraktori do të kryejë teste të mëtejshme të kualifikimit të saldatorit të nevojshme për të treguar se saldatorët janë të aftë.

Kur nuk specifikohet ndryshe, saldimit do t'i nënshtrohen testimit jo-destruktiv nga proceset të cilat mund të përfshijnë, por jo domosdoshmërisht të kufizuara, në metoda radiografike, ultrazanore, grimca magnetike ose të depërtimit të ngjyrave, në varësi të llojit të saldimit dhe pozicionit të tij në strukturë. Rreth 50% e të gjithë saldimit duhet të testohet. Nëse ndonjë punë tregon defekte ose nuk i përmbush kërkesat sipas Vizatimeve të miratuara ose specifikimeve për ndonjë arsye, ajo do të riparohet ose refuzohet, edhe pse mund të jetë kryer nga saldatorë të kualifikuar duke përdorur procedurat e aprovuara. Procedura e saldimit për veshjet e nikelit duhet të shmangë porozitetin në saldim dhe çdo hollim të pakontrolluar të saldimit prej hekuri të marrë nga çeliku. Duhet të merren masa paraprake speciale për të shmangur grisjen e fletës (lamelar) kur përdoren pllaka të trasha saldimi dhe elektroda me përmbajtje të ulët hidrogjeni. Saldimet e klasës 1 duhet të radiografohen plotësisht, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

Në mot të keq, duhet të merren masa të përshtatshme për të mbajtur standardin e cilësisë së saldimeve. Në rast të motit me shi, do të merren masa që vendet e saldimit të jenë të thata. Në mot me temperatura nën 5°C, një brez prej 100 mm duhet të ngrohet paraprakisht në 50 C°, në të dy anët e bashkimit të saldimit si në rastet e saldimeve me qepje dhe tub.

Gjatë saldimit janë të palejueshme spërkatja, nxehja nga brenda, zona të pabarabarta, skajet e tepërta në qoshe të bashkive, qepje e pakënaqshme ose ndonjë çarje. Sipërfaqet duhet të jenë të pastra nga çdo shenjë e ndikimit, dhëmbëzimit dhe deformimit.

Nuk do të lejohet asnjë saldim në punimet e çelikut të galvanizuar dhe mbi praimerat e zinkut apo bojëra.

### **11.4 Galvanizimi**

Kur çeliku ose hekuri i farkëtuar do të galvanizohet, galvanizimi do të kryhet pasi të kenë përfunduar të gjitha prodhimet. Artikujt duhet të pastrohen dhe lihen në acid të holluar sulfurik ose klorhidrik, të ndjekur nga shpëlarja në ujë dhe lënia në acidin fosforik. Ata duhet të lahen, të stivohen dhe zhyten në zink të shkrirë dhe lyhen me furcë në mënyrë që i tërë metali të mbulohet në mënyrë të barabartë dhe pesha shtesë e tij pas zhytjes të jetë jo më pak se 0.6 kg / m<sup>2</sup> sipërfaqe e galvanizuar, përveç në rastin e tubave kur nuk duhet të jenë më pak se 0,46 kg / m<sup>2</sup>. Skajet duhet të jenë të pastra dhe sipërfaqe të ndritshme.

### **11.5 Dadot dhe Bullonat**

Bulonat e jashtëm dhe fiksimi i bulonave, dadove dhe rondeleve duhet të jenë prej çeliku të veshur me zink. dadot, bulonat dhe rondelet montuese në rakorderitë ose pajisjet e galvanizuar do të galvanizohen ose sherardizohen (vishen me zink).

Dadot dhe bulonat e përdorura në prodhimin e strukturave të aluminit duhet të jenë të lëmuara me kadmium dhe të kenë rondele të galvanizuara. Rondelet ndahen nga struktura e aluminit nga rondele me fibër të të njëjtit diametër të barabartë.

### **11.6 Kallëpi i Hekurit**

Kallëpat prej hekuri duhet të bëhen nga modele dhe kallëpe të përgatitura siç duhet. Të gjitha kallëpet për skajet qorre, kornizat dhe kapakët e pusëve duhet të jenë prej hekuri të ashpër gri, pa prishje, çarje, vrima, fryrje dhe tkurrje dhe duhet të kenë mbaruar si punim. Para largimit nga fonderia, të gjitha kallëpet pastrohen plotësisht dhe i nënshtrohen inspektimit të çekiçit, pas së cilës ato zhyten dy herë në një përgatitje me asfalt të nxehtë ose katran qymyri në mënyrë që të formojnë një shtresë të fortë plotësisht të lidhur.

### **11.7 Montimi dhe Ndërtimi në Brendi**

Hapjet (vrmat) e lëna në beton për montimin dhe betonimin e mëpasshëm të tubave duhet të kenë arkitraun e hapjes të pjerrët në jo më pak se 1/4 në horizontale. Periferia e hapjes do të formohet siç përcaktohet për nyjet ndërtimore. Pas vendosjes së tubit ose montimit, boshllëku i mbetur duhet të mbushet me kujdes me beton të klasës së duhur për të prodhuar një bashkim të papërshkueshëm nga uji. Betoni duhet të mbahet nga një grilë (kanat), e cila do të ngrihet gjatë mbushjes së betonit. Kontraktori do të konstatojë nga furnitorët e mallrave të parafabrikuara ose të prodhuara cdo udhëzim të veçantë montimi dhe do i referojë ato tek Inxhinieri.

Kur bulonat e montimit janë pozicionuar me anë të një shablloni, ato duhet të mbështeten dhe vendosen ekzakt që të ruajnë një shtrirje perfekte gjatë vendosjes së betonit. Kur është e nevojshme të shpohet për montim, vrmat duhet të jenë me madhësinë e duhur dhe të mbuloohen me llaç çimentoje.

Kornizat dhe fllanxhat që duhet të fiksohen në faqen e muraturës së betonit ose tullave duhet të mbështeten tek faqja dhe të ndahen prej saj me paketime. Menjëherë para montimit të kornizave ose fllanxhave, faqja duhet të pastrohet me kujdes dhe të ashpërsohet në të gjithë zonën që duhet të mbulohet. Dadot që sigurojnë secilën pikë duhet të shtrëngohen lehtë për të mbajtur kornizat ose fllanxhat në pozicionin e saj të saktë pa shtrembërime.

Hapësira midis faqes dhe kornizave ose fllanxhave duhet të mbushet me llaç çimentoje ose mastikë butile me vendosje të fortë. Pasi të jetë ngurtësuar mbushja, dadot duhet të shtrëngohen përfundimisht me kujdes për të parandaluar shtrembërimin dhe për të siguruar lidhjen e barabartë. Llaçi i çimentos nuk duhet të përdoret kur korniza ose fllanxha janë prej alumini. Paketimi duhet të mbajë një boshllëk minimal prej 10 mm për t'u mbushur me llaç çimentoje. Materiali i paketimit do të miratohet prej Inxhinierit; do të jetë i papërshkueshëm nga uji, i qëndrueshëm dhe i përputhshëm me materialet me të cilët bie në kontakt. Duhet të jetë i fortë, por mjaftueshëm fleksibël në mënyrë që çdo tkurrje e mbushësit gjatë forcimit të bëhet në procesin e shtrëngimit përfundimtar.

Kur montohen shina dhe gjëra të ngjashme, portat ose dyert duhet të jenë në pozicion të mbyllur.

Duhet treguar kujdes për mbrojtjen e faqeve dhe pjesëve të tjera të punës nga llaçi dhe mbeturinat e tjera. Përveç kur përcaktohet ndryshe, kur një metal montohet në mënyrë të përhershme në metal ose ndonjë sipërfaqe tjetër, sipërfaqet metalike në kontakt do të lyhen në Kantier (vendin e punës) me dy shtresa të bojës bituminoze direkt para fiksimit.

Në asnjë rrethanë alumini nuk mund të ndërtohet në beton të lagësht ose të fiksohet në beton jeshil.

Kur është e nevojshme të bashkohet alumini në çelik ose gize, të dy sipërfaqet duhet të ndahen prej një izolimi të aprovuar jo më pak se 1.5 mm i trashë.

Kur ndërtime të strukturës prej alumini ose me strukturë hekuri janë ndërtuar në tulla, muraturë ose beton, së pari sipërfaqet e kontaktit duhet të lyhen me dy shtresa të bojës bituminoze.

Kur sipërfaqet e aluminit janë në kontakt, elementët bashkues duhet të jetë të veshur me zink të kromuar.

Aparatet elektrike që duhet të montohen në mure dhe poshtë strukturave nëntokë, dhe kur ka të ngjarë t'i nënshtrohen kushteve të lagështa, do të montohen 10 mm larg nga sipërfaqja me cilindër ose pajisje të tjera të përshtatshme për ndarje.

### **11.8 Lyerja**

Lyerja do të kryhet sipas standardeve të pranuar ndërkombëtare.

Të gjithë artikujt e impiantit të destinuar për t'u lyer duhet të pastrohen deri në metalin e zhveshur dhe do t'i jepet një trajtim i plotë i përgatitjes së sipërfaqes, praimerave dhe veshjeve të mbarimit për të dhënë një sistem të qëndrueshëm, mbrojtës, në përputhje me kushtet në të cilat impianti do të përdoret në Kantier (Vendin e Punës). Përgatitja sipërfaqësore dhe të paktën një praimer do të aplikohen në ambientet e Kontraktorit ose NënKontraktorit.

Të gjitha pjesët që synojnë të lihen të ndritshme do të kenë një përzierje plumbi të bardhë dhe graso pa acid.

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

Të gjitha bojërat dhe materialet do të miratohen nga Inxhinieri dhe do të përdoren në përputhje me udhëzimet e prodhuesit. Kontraktori, në kohën e tenderimit, do të sigurojë të gjithë elementët për materialet e praimerve, si dhe për veshjet përfundimtare që ai propozon të përdorë.

Nënshtresat duhet të jenë me ngjyra të ndryshme dhe ngjyra përfundimtare e aprovuar nga Inxhinieri.

Në asnjë rast nuk duhet të aplikohet bojë gjatë motit me shi, të lagësht ose në sipërfaqet mbi të cilat ka kondensim.

Duhet të kalojnë të paktën 24 orë midis aplikimeve të veshjeve të njëpasnjëshme, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga prodhuesi.

Të gjitha sipërfaqet prej çeliku ose punët e hekurit që duhet të lyhen, duhet të fshihen mirë për të siguruar që ato janë pa ndryshk ose smërç.

Të gjitha punimet prej hekuri dhe çeliku mbi nivelin e dyshemesë brenda ndërtesave dhe që janë të ekspozuara për t'u parë, përfshirë pompat, matësit, rregullatorët, vinçët, valvulat dhe tubat duhet të kenë praimer ose veshje që janë aplikuar si dora e fundit (zbukurim) në ambientet e Kontraktorit ose Nën-Kontraktorit të tij. Pjesa e mbetur e procesit të lyerjes do të aplikohet për të dhënë një shkëlqim të butë me ngjyrat e aprovuara. Sipërfaqet duhet të fshihen mirë dhe pastrohen midis shtresave.

Punimet e hekurta, siç janë tubat dhe valvulat të cilat fshihen nga pamja poshtë nivelit të dyshemesë, në kanale ose që janë groposur do të pastrohen dhe jepet dora e fundit siç përcaktohet për punimet e çelikut, dhe më pas do të jepen dy shtresa me bojë bituminoze të rëndë me bazë katran - qymyri.

### **11.9 Shkallë, Shkallare dhe Parmakë**

#### **11.9.1 Shkallët dhe Shkallaret**

##### **11.9.1.1 Të përgjithshme**

Shkallaret do të kenë një pjerrësi afërsisht 30°.

Ato do të kompletohen me parmakë, minimum 100 cm lartësi vertikale.

Të gjitha shkallët duhet të jenë me gjerësi 750 mm kur është e mundur. Shkallët vertikale do të instalohen me alternim në të majtë/djathë të platformës horizontale e vendosur afërsisht cdo 6 m lartësi vertikale. Shkallët vertikale me lartësi më shumë se 3 m do të sigurohen me rrathë sigurie në intervale që nuk i kalojnë 900mm, me rrethin më të ulët 2.0 m mbi shkallë. Ngarkesa e supozuar për platformat e zakonshme do të jetë për platformat e përdorura nga personeli dhe për mbajtjen e pajisjeve të lehta me peshë secila më pak se 50 kg 2.5 kN/m<sup>2</sup> për të gjitha platformat e tjera 7.4 kN/m<sup>2</sup> përveç kur specifikohet ose përcaktohet ndryshe në Standardet e aplikuara.

##### **11.9.1.2 Shkallët**

Me përjashtim të shkallëve të brendshme hyrëse në depozitat e ujit, rezervuarët dhe pusetat e mbushura, shkallët do të jenë celiku (plotësisht të galvanizuara me zhytje në të nxehtë). Shkallët për hyrjet e brendshme do të jenë prej celiku inox. Në përgjithësi të gjitha shkallët do të jenë në përputhje me DIN 3620.

Traversat e shkallëve duhet të jenë me madhësi që i përshtaten lartësisë së shkallës dhe intervalit të mbështetësve të tyre. Traversa duhet të jetë me rreze mbi pjesën e sipërme dhe e shpuar për të futur shkallët të cilat do të saldohen në varg në secilën anë të secilës traversë shkalle. Skajet e poshtme të traversave nuk duhet të projektohen për montim në dysheme, por duhet të përfundojnë në mbështetëset e fiksimit të murit të paktën 150 mm mbi dysheme. Të gjitha skajet e traversave duhet të jenë të lëmuara pa gërvishje dhe skaje të mprehta.

Kur nuk është i mundur ose i papërshtatshëm instalimi i rrathëve, me miratimin e Inxhinierit, do të sigurohen pika ankorimi për të vënë rripat e sigurimit.

## **“NDËRTIM I RRJETIT KANALIZIMEVE NGA LUNGOMARE DERI NË HYRJE TË RADHIMËS”**

---

Do të sigurohen mbështetëse të përshtatshme për fiksimin e shkallës në strukturën mbështetëse në mënyrë që të ketë një hapësirë minimale prej 200 mm pas shkallëve. Këto lidhje duhet të jenë të llojit që shtrëngohen në strukturën mbështetëse.

Hapësira e vendeve mbështetëse nuk duhet të kalojë 2.4 m. Në rastet kur nuk është e praktikueshme, traversat duhet të forcohen në mënyrë të përshtatshme.

### **11.9.1.3 Shkallaret e Celikut**

Shkallët duhet të projektohen për një ngarkesë prej 7.5 kN / m<sup>2</sup> të sipërfaqes së shkallës. Shkallët prej çeliku duhet të pajisen me kangjella dore me tuba, shirita me prerje tërthore të përshtatshme për hapësirën dhe ngarkesën, dhe këmbëz shkalle me rrjetë të hapur ose fletë me kuadrate. Me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe, ngritja midis këmbëzve të shkallëve duhet të jetë uniforme dhe midis 150 mm dhe 175 mm. Shkallët në të njëjtën zonë të punimeve dhe në vende të ngjashme duhet të kenë të njëjtin kënd dhe lartësi të ngritjes midis këmbëzve.

### **11.9.2 Parmakët dhe Kangjellat**

Parmakët dhe Kangjellat duhet të jenë të sigurtë, qëndrueshëm dhe të montuar si duhet në beton.

Të gjitha shkallët, shkallaret dhe hapje të tjera do të sigurohen nga të tre anët me parmakë (kangjella). Hyrja tek shkallët ose tek hapjet do të sigurohet prej dy zinxhirësh të varur prej celik-nikeli, e cila do të sigurohet në njërin skaj dhe të shkëputet në anën tjetër.

Parmakët do të dorëzohen dhe instalohen dyfish me të gjithë kunjat e nevojshme, vidat M12 dhe pllakat bashkuese në përputhje me DIN 31003 (Pjesa 4.1.2.5).

Parmakët duhet të prodhohen nga shufra solide celik-nikeli me diametër 48.3 mm (trashësia 2.9 mm), me sferë çeliku të farkëtuar me diametër minimal 50 mm në pikat e lokalizimit të parmakëve në përputhje me kërkesat përkatëse të BS 4, BS 1387, BS 4848: Pjesa 2, BS 6323 dhe BS 4360. Të gjithë elementët duhet të zhyten në nxehtësi në BS ISO 1461.

Kontraktuesi do të sigurojë që përveç rasteve kur specifikohet e kundërta, të gjitha parmakët duhet të kenë pamje dhe prodhim uniform.

Parmakët duhet të jenë prej aliazhi të aluminit dhe mbajtësit duhet të përbëhen nga aliazh i tubëzuar alumini me shkëlqim. Standardet duhet të përshtaten me baza të miratuara.

Parmakët duhet të sigurohen përgjatë çdo skaji të të gjitha vendkalimeve të punimeve me metale dhe çimento, shkallëve ose zonave të hapura të arritshme ku rënia përtej buzës tejkalon 700 mm. Kangjella duhet të përbëhet nga mbajtës në intervale të rregullta që nuk i kalojnë 1.5 m, dhe dy shina. Shina e sipërme duhet të jetë 1.0 m mbi nivelin e dyshemesë ngjitur, dhe 900 mm mbi vijën e hundës tek shkallët. Shina më e ulët do të jetë pak a shumë midis dyshemesë dhe shinës së sipërme. Montimi i parmakut dhe ankorimet duhet të projektohen që t'i bëjnë ballë një ngarkese horizontale të vazhdueshme në shinën e sipërme prej 750 N/m.

Devijimi i shinave nuk duhet të kalojë 0.8 përqind të hapësirës së tyre midis kangjellave dhe devijimi i kangjellave nuk duhet të kalojë 0.8% të lartësisë së tyre.

Për parmakët brenda ndërtesave, përveç kur kërkohet ndryshe në standardet e specifikimit, të gjitha shinat duhet të jenë të fabrikuara nga tub çeliku i galvanizuar të peshës mesatare me kalibër 32 mm.

